

HEJZA

Stavri J. DAJO, studiues dhe përkthyes

**LETËRSIA E PERIUDHËS KOMUNISTE DUHET
TË RIVLERËSOHET ME GJAKFTOHTËSI**

Nën thjerrë

IDENTITETI KULTUROR NË KRIZË

Një nga sfidat më të mëdha që gjithnjë e më shumë po e prekin kulturën shqiptare është shtimi i dukurive që përfaqësojnë antivlera. Siç duket, një lloj stimulimi apo provokimi i qëllimshëm i këtyre antivlerave është në zhvillim, duke krijuar një ambient të pafavorshëm për vlerat e mirëfillta kulturore



Nga Avni HALIMI

Në kohën kur media, televizioni dhe interneti janë bërë kanalet kryesore të informimit dhe ndikimit, fare lehtë po vërehet se si antivlerat kulturore po marrin jetë të pavarur. Shundi dhe kici, apo, siç është bërë mode t’i quajmë “tallava”, po stimulohen e po promovohen dhe po shndërrohen në elemente dominues në shumë forma të artit dhe kulturës popullore shqiptare. Më e keqja, këto dukuri shpesh po serviren si diçka që po e ha pazari dhe që po e kërkon populli! Në këtë pike shtrohen disa pyetje thelbësore është: Cili është qëllimi i atyre që promovojnë këto antivlera? E bëjnë nga injoranca apo me strategji të përgatitura nga qarqe të ndryshme antishqiptare? A është kjo një mënyrë për të çmontuar dhe keqformuar identitetin tonë kulturor mbi atë kod që na ka ruajtur, që na ka dalluar dhe që na ka shquar si popull i fisëm?

Heshtja armiqësore para degradimit kulturor

Nëse edhe më tej vendosim të heshtim para kësaj situatë, nëse kjo situatë vazhdon pa u adresuar, pasojat do të jenë të rënda. Aktualisht kjo dukuri është në shtim e sipër dhe, shumë shpejt do të vie faza e shtresimit mbi një trashëgimi me vlera të padiskutueshme kulturore që do të ngelë pa nam e nishan! Të mos harrojmë: kulturat që kanë kaluar përmes momenteve të krizës kanë parë se, kur antivlerat bëhen dominante ato krijojnë një shoqëri pa identitet të fortë. Shqiptarët janë një popull që ka kaluar përmes shumë periudhash të vështira, dhe për më tepër, ka shpëtuar nga shumë periudha pushtimesh dhe dominimesh kulturore

dhe, nëse heshtim para këtyre anomalive kulturore, do të rrezikojmë të humbasim pjesë të rëndësishme të identitetit tonë, të trashëguar përmes shekujve. Shpërndarja masive e këtyre dukurive do të krijojë një popull që nuk është në dijeni të pasurisë kulturore që i përket, dhe më keq akoma, do të rrisë ngatërresat mes brezave, duke nxitur humbjen e lidhjeve të thella me traditat dhe vlerat themelore. Mjafton një orë letrare, një manifestim letrar, një film limonadë, një ekspozitë të përkrahur nga do qarqe të dyshimta e që vdesin pas “kulturave eksperimentale” te popujt me identitet kulturor të plagosur, mjafton një dasëm që të bindesh se po rrokullisemi tatëpjetë kodrës së antivlerave. Janë të paktë nga gjeneratat e reja që dinë për figurat dhe vlerat kulturore që deri në përjetësi e bëjnë krenar popullin tonë. Madje tashmë as syri e as veshi nuk ua pranon atë vlerë që dinjitetshëm mund të konkurrojnë me çdo vlerë botërore. Kulturologët dhe intelektualët shqiptarë, që janë më të ftuarit për të udhëhequr një analizë të thellë dhe të sinqertë për këto fenomene, po heshtin. Për fat të keq, kjo heshtje po shoqërohet edhe me një mungesë të kritikës të cilën e kërkon një shoqëri që përpiqet të mbajë integritetin kulturor. Kritika e mirëfilltë, ajo që thekson dhe promovon vlerat e artit dhe kulturës të ruajtura për breza, po vdes dhe, assesi të kuptojmë se pa këtë kritikë, ne jemi të ekspozuar ndaj një gjuhe dhe një estetike që janë larg vlerave të cilat shqiptarët i kanë mbrojtur për shekuj me radhë. Të gjendur para një situatë të tillë tashmë emergjente, nuk është turp që të kthejmë kokën kah përvojat dhe praktikat e popujve të civilizuar dhe të shohim se si ata i kanë tejkaluar dukuritë e tilla të shëmtuara duke investuar në edukimin

dhe formimin e një elite intelektuale dhe kulturore, të cilën e kanë angazhuar dhe përkrahur në ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave autentike. Nuk është e turpshme t’i kopjojmë në krijimin e strukturave për reflektim të vazhdueshëm mbi trashëgiminë kulturore dhe ruajtjen e identitetit kombëtar përmes institucioneve të shenjta kulturore si muze, shoqata, qendra kërkimore, festival, manifestime etj. Kultura shqiptare e ka shumë të vështirë të mbijetojë dhe të zhvillohet nëse sa më parë nuk del nga ky cikël negativ i promovimit të antivlerave dhe të kthejmë vëmendjen te vlerat e vërteta që përbëjnë esencën e identitetit tonë. A është intelektualitet publikimi dhe shpërndarja e informatës se akcili avdall këtë vit do të publikojë njëzet vepra shkencore-letrare dhe me këtë të mburret pseudo-elita shqiptare? Pa një përpjekje të bashkërenduar nga intelektualët, artistët dhe të gjithë ata që kujdesen për kulturën, nuk ka asnjë mundësi të mbrohet dhe zhvillohet ajo që kemi trashëguar. Heshtja është një armik i fuqishëm. Rreziku është real, dhe asnjëherë nuk ka qenë më e nevojshme se tani një angazhim i përbashkët për ta shpëtuar kulturën dhe identitetin tonë kulturor nga këto rreziqe që po i kanosen.

Kultura është shpirti i një populli

Disa ditë më parë, në disa institucione kulturore të Maqedonisë së Veriut, u bënë dhjetëra punësime artistësh, dhe, ky detyrim shtetëror u “shit” si “angazhim i fuqishëm në promovimin e kulturës shqiptare dhe ndalimin e abuzimit të deritanishëm me artistët që është bërë nga BDI vite me radhë...” Ky qëndrim partiak i rishtakëve qeveritarë meriton

një kritikë thelbësore sa për t’ua bërë me dije se punësimi i artistëve nuk duhet të ngatërrohet me promovimin e kulturës, për shkak se ai mbetet një detyrë administrative që shteti e ka ndaj institucioneve kulturore. Nëse qeveria mendon se me punësimin e disa aktorëve, këngëtarëve, ose valltarëve, ka përmbushur obligimin e saj ndaj kulturës shqiptare në RMV, ky është një mendim i gabuar që pasqyron jo vetëm një amatorizëm por edhe një përpjekje për ikje nga obligimet kombëtare për sa i përket identitetit kultruro dhe zhvillimit të kulturës institucionale. Pa dyshim, pa artistë nuk ka institucione kulturore dhe, për pasojë, nuk ka kulturë institucionale. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se punësimi i disa individëve në pozita artistike është e mjaftueshme për të krijuar një zhvillim të qëndrueshëm kulturor. Nëse kjo është e kuptuar si një “përmbushje detyrimi”, atëherë kemi të bëjmë me një nonsens për ata që e kuptojnë thelbin e kulturës dhe proceset që lidhen me të. Vlerat kulturore kërkojnë një angazhim të qëndrueshëm, një strategji të qartë dhe një investim në infrastrukturën dhe programet që mundësojnë zhvillimin e një kulture të pasur dhe të diversifikuar. Deri më sot, asnjë subjekt politik shqiptar në RMV nuk na e ka publikuar qoftë në disa faqe programin partiak për kulturë institucionale e aq më pak strategjinë nacionale për kulturë kombëtare. Të akuzosh BDI-në apo PDSH-në se na paskan manipuluar me kulturën nacionale, kjo nuk është korrekte! Edhe këto parti kulturrë kombëtare i janë qasur pa kurrfarë dokumenti programor, megjithatë, ia kanë dalë që shqiptarëve të vendit t’u lënë diçka që mund të llogaritet si themele të kulturës institucionale për

shqiptarët e Maqedonisë së Veriut. Nëse shohim pas, do të vërejmë se këto parti, pavarësisht kufizimeve të tyre ideologjike, kanë pasur një rol të rëndësishëm në themelimin e institucioneve kulturore, si Ansambli i Këngëve dhe Valleve, Teatri Profesional Shqiptar i Gostivarit, Teatri shqiptar i Tetovës, Galeria e arteve në Tetovë, Qendra për Konservim në Gostivar, Instituti për trashëgimi kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve të RMV-së, Njësia teatrale shqiptare pranë Shtëpisë së Kulturës në Kumanovë. Themeli i këtyre institucioneve përbën një hap të rëndësishëm për zhvillimin e kulturës, dhe vetëm themelimi i institucioneve nacionale mund të konsiderohet një angazhim konkret për kulturën kombëtare. Gjithsesi, themelimi i institucioneve kulturore nuk është i mjaftueshëm për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm kulturor. Ky angazhim duhet të vazhdojë me një mbështetje të përhershme dhe me planifikimin e burimeve të nevojshme për funksionimin e tyre. Ky është detyrim i shtetit, i dikastereve që merren me administratën në përgjithësi. Shteti, natyrisht, duhet të ketë një strategji të qartë për ngritjen e institucioneve dhe për mbushjen e vendeve të punës brenda tyre, si dhe për sigurinë e mbështetjes për artistët dhe kulturën në tërësi. Kjo përfshin mbështetje financiare si dhe mundësi për zhvillim profesional për artistët dhe individët që punojnë në këtë sektor.

Një subjekt politik serioz duhet të kuptojë se, thjesht, punësimi i artistëve nuk është një zgjidhje për sfidat që ndodhin në sektorin kulturor. Nëse një parti politike mendon se kjo është mënyra për të realizuar detyrimet e saj ndaj kulturës kombëtare, atëherë jemi dëshmitarë të një shmangieje nga angazhimi real. Kultura nuk është një çështje e thjeshtë menaxhimi, por një proces i ndërlikuar

që kërkon vëmendje të vazhdueshme dhe investime të thella për të siguruar që ajo të ruhet dhe zhvillohet për brezat që vijnë. Pra, fokusimi tek aktorët, këngëtarët dhe valltarët sugjeron se thjesht punësimi i këtyre individëve nuk është mjaftueshëm për të krijuar ose mbajtur një kulturë të gjallë dhe të qëndrueshme. Pa një strategji të mirëfilltë kombëtare për zhvillimin dhe promovimin e kulturës institucionale, ky lloj punësimi, siç u tha, mund të shihet si një “përmbushje e detyrës” nga qeveria, e cila nuk reflekton një angazhim të thellë dhe të qëndrueshëm ndaj kulturës shqiptare dhe zhvillimit të saj. Kultura, sipas këtij mendimi provincial na qenka thjesht një çështje menaxhimi të burimeve njerëzore, dhe jo një pjesë e një strategjie të gjithanshme që përfshin financim, edukim, ruajtje dhe zhvillim të arteve, traditave kombëtare dhe zhvillimin e infrastrukturës kulturore?! Kultura është shpirti i një populli.

Pronarët maqedonas të “përkthyesve” shqiptar

Një ndër risitë më të rëndësishme që është miratuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) në vitet e fundit është i ashtuquajturi Ligji për Gjuhët, i cili e detyron përdorimin e gjuhëve (sidomos të shqipes) në të gjitha nivelet dhe institucionet shtetërore e publike, për aq kohë sa popullsia jo-maqedonase e flet atë në përqindje jo më të vogël se 20%. Ky ndryshim i rëndësishëm ligjor është hap i duhur për integrimin e shqiptarëve dhe njohjen e të drejtave të tyre gjuhësore. Megjithatë, pas miratimit të këtij ligji, një tjetër realitet i hidhur ka filluar të shfaqet, ku në vend të një zbatimi korrekt dhe të denjë të përkthimeve, po ndodh një situatë eksploatimi të përkthyesve shqiptarë, dhe kjo duhet të ngrejë shqetësime të mëdha. Në një kohë kur kërkesa për përkthyes

shqipëror nga maqedonishtja është rritur ndjeshëm, ashtu sikundër edhe numri i “agjencive përkthimore” të egra, ka rënë ndjeshëm cilësia e përkthimeve dhe respekti ndaj gjuhës shqipe. Pikërisht këtu, na del një dukuri e papranueshme: përkthyesit shqiptarë, të cilët janë “të detyruar” (më tepër nga injoranca) të pranojnë kontrata me çmime që shpesh nuk e mbulojnë asnjë shpenzim bazik, shfrytëzohen nga agjencitë që janë të drejtuara nga individë të cilët nuk kanë asnjë interes të sigurojnë kushte të mira pune, përveç përfitimit personal. Ata paguhen 2-3 euro për faqe, ndërkohë që buxhetet për përkthimet janë të siguruara dhe mund të lejojnë një pagesë shumë më të lartë për shërbimet e ofruara. Në këtë situatë, pa asnjë dyshim, ekziston një parregullsi e theksuar që krijon mundësi për shfrytëzim dhe jo për zhvillim të mundësive të barabarta për shqiptarët në tregun e punës. Përkthyesit shqiptarë nuk janë të punësuar në pozita të qëndrueshme dhe profesionale në shumë nga institucionet shtetërore, kulturore, dhe mediatike. Nga ana tjetër, sa më shumë që po shtohet kërkesa për përkthyes, aq më shumë po shtohen mundësitë për shfrytëzim të këtij grupi! Ky shfrytëzim është i thelluar dhe i përhapur në mënyrë të tillë që po krijon një logjikë të gabuar, që po përhapet si një epidemi: “më mirë të angazhojmë përkthyes me çmime simbolike se sa të angazhojmë profesionistë shqiptarë që mund “ta kontaminojnë” kolektivin etnik maqedonas”. Ky është një qëndrim jo vetëm i papranueshëm, por dhe shumë i dëmshëm për bashkëjetesën dhe integrimin ndërkombëtar të RMV-së, sepse nënvlerëson dhe injoron vlerën që ka fuqia punëtore e shqiptarëve dhe ndihmon për të ruajtur një ndarje të thellë në shoqëri.

Një tjetër aspekt shqetësues është mungesa

e mundësive për punësim të përkthyesve shqiptarë në sektorët shtetërorë dhe privat, pavarësisht se Ligji për Gjuhët e detyron përdorimin e gjuhës shqipe. Në asnjë redaksi maqedonase, në asnjë institucion maqedonas të kulturës, nuk ka përkthyes shqiptarë të punësuar me kontrata të qëndrueshme, të cilët të kenë mundësi për zhvillim profesional dhe të jenë të mbrojtur nga një kontratë pune e denjë. Ndaj dhe faqet zyrtare të tyre janë vetëm në gjuhën maqedonase ose, aty-këtu me ndonjë shqipe të çoroditur që ua ofron google translate! Përkthimi është një profesion i rëndësishëm, që kërkon aftësi dhe njohuri të thella të gjuhës dhe kulturës përkatëse. Çdo gjë që është botuar në formën e përkthimeve të mangëta dhe të pasakta e dëmton imazhin e kulturës dhe përfaqësimin e shqiptarëve në shoqërinë maqedonase. Në vend që të krijohen mundësi që shqiptarët të punësohen dhe të zhvillohen si profesionistë të vërtetë në këtë fushë, ata shfrytëzohen si resurse të lira pune, duke u nxitur kështu një situatë të padrejtë dhe të ndërlikuar.

Zbatimi i Ligjit për Gjuhët duhet të jetë më shumë se sa një detyrim teknik. Duhet të sigurohet që shqiptarët të kenë mundësi të barabarta për punësim dhe zhvillim, si dhe t’u sigurohen kushte të mira pune. Pa dyshim, duhet një rishikim i politikave të punësimit dhe mbrojtjes sociale për përkthyesit shqiptarë, që ata të kenë mundësi të angazhohen në pozita të qëndrueshme dhe me kushte të mira. Po ashtu, duhet të formohen mekanizma të qartë dhe të rreptë kontrolli që të sigurojnë që ligji të zbatohet siç duhet dhe të ndalojë shfrytëzimin dhe padrejtësinë ndaj këtij grupi të rëndësishëm. Ky qëndrim institucional do t’i harr edhe “ata përkthyes” të cilët po na shkaktojnë “ndotjen gjuhësore” dhe këtë profesion do ta ngriste në nivelin e profesionalizmit që është gjithë respekt për gjuhën shqipe.

Letër nga diaspora

TA NJOHIM VETEN EDHE PËRMES EMRAVE TË RRUGËVE

Brezat e rinj, pavarësisht se mësojnë edhe historinë shqiptare, është fare pak e besueshme se dinë se kush kanë qenë shumë figura, emrat e të cilëve i mbajnë rrugët tona. Sidomos, fëmijët e bashkatdhetarët tanë që janë lindur dhe shkolluar jashtë atdheut të prindërve të tyre

Neviana SHEHI/ ITALI

Emrat e rrugëve kanë një rëndësi të veçantë, jo vetëm për orientimin dhe funksionalitetin e jetës së përditshme, por edhe për ruajtjen e historisë, ruajtjen identitetit kulturor dhe përforcimin e lidhjeve shoqërore. Janë një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës urbane. Shumë shtete, kur bëhet fjalë për emrat e rrugëve, kanë krijuar dhe zhvilluar forma të ndryshme dhe interesante të karakterit informues e sqarues. Në Itali, për shembull, ka edhe tabela, në të cilat krahas emrit dhe mbiemrit të personalitetit që emërton një rrugë të caktuar, kalimtarët kanë rastin të lexojnë edhe sqarime të shkurtra, përkatësisht me dy – tri fjalë tregohet se kush ka qenë ai personalitet. Për shembull, të paktë janë ata italianë që e dinë se kush ka qenë, bie fjala, Michele Novaro (1818 – 1885). Por, kur e lexojnë sqarimin plotësues nën emrin e tij, atëherë kuptojnë se personaliteti me emrin e të cilit është emërtuar rruga, pra Michele Novaro, është kompozitori i himnit të Italisë. Tek ne, brezat e rinj, pavarësisht se mësojnë edhe historinë shqiptare, është fare pak e besueshme se dinë se kush kanë qenë shumë figura, emrat e të cilëve i mbajnë rrugët tona. Sidomos, fëmijët e bashkatdhetarët tanë që janë lindur dhe shkolluar jashtë atdheut të prindërve të tyre. Është shumë normale që ata të mos e dinë se kush ka qenë Pashko Vasa, Shtjefën Gjeçovi, Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi, Gjerasim Qiriazî, Jeronim De



Rada, Jusuf Gërvalla, e shumë e shumë të tjerë. Prandaj, që të bëhet një lëvizje e vogël, është mirë që në tabelat e rrugëve tona, aty ku figurojnë emrat e shquar të historisë e kulturës shqiptare, të shënohen edhe dy-tri fjalë që japin një sqarim më të plotë rreth atyre figurave. Në këtë mënyrë, para se gjithash, shqiptarët do të mësonin më shumë për galerinë e madhe të personaliteteve të shquar të kombit, por edhe të figurave tjera që i kanë kontribuar mbarë njerëzimit.

Emrat e rrugëve, siç dihet, janë të domosdoshëm për udhëtimin dhe lëvizjen në qytete dhe zona të ndryshme.

Ata ndihmojnë në identifikimin e vendndodhjeve dhe ndihmojnë njerëzit të orientohen, goftë për të shkuar në një vend të caktuar, goftë për t'u njohur me një qytet të ri. Emrat e rrugëve, në fakt pasqyrojnë ngjarje historike, personalitete të rëndësishme, apo elemente të kulturës lokale. Ata mund të jenë të lidhur me periudha të ndryshme të zhvillimit të qytetit, si dhe me ngjarje që kanë formuar identitetin e një kombi ose një zone.

Në qytetet që kanë popullatë të përzier, në shumë raste emrat e rrugëve shfaqen në disa gjuhë, duke u siguruar që ata që nuk flasin gjuhën lokale, të mund të kuptojnë

dhe të orientohen. Kjo është një gjë e mirë dhe dëshmi qytetërimi.

Emrat e rrugëve në një mënyrë sikur japin një ndjesi të lidhjes dhe përkatësisë me një komunitet apo komb. Përdorimi i emrave të figurave historike, heronjve kombëtarë, apo ngjarjeve të rëndësishme kontribuon në forcimin e identitetit kolektiv. Disa emra mund të jenë të lidhur me legjenda, ngjarje mitologjike ose tradita të lashta që kanë një rëndësi të madhe për kulturën dhe historinë e një vendi. Emrat e rrugëve gjithashtu mund të ndihmojnë në krijimin e një identiteti të përbashkët për banorët e një zone. Kur një rrugë merr emrin e një ngjarjeje, një vendi apo një simboli të njohur, banorët ndihen më të lidhur me historinë dhe kulturën e tyre.

Nevoja për ta njohur vetveten është një çështje e përhershme dhe kjo mbase reflektohet edhe në emërtimin e rrugëve me personalitete të njohura, ngjarje historike apo me vendndodhje gjeografike. Ndër breza është ndjerë, ndjehet dhe do të ndjehet kjo nevojë e njohjes së indit kombëtar. Këtë, për të mos u harruar kurrë, sot duhet ta bëjmë ne, kurse nesër ata që vijnë pas nesh. Pra, edhe përmes emërtimeit të rrugëve, ta bëjmë atë që na takon ta bëjmë për të mirë e të gjithëve, sidomos për ata që nesër do të krenohen për rrënjët e prindërve e gjyshërve të tyre. Viktor Hygo me një rast pati thënë: “E çfarë është historia? Një jehonë e së kaluarës në të ardhmen; një pasqyrim i së ardhmes në të shkuarën”.

Stavri J. DAJO, studiues dhe përkthyes

LETËRSIA E PERIUDHËS KOMUNISTE DUHET TË RIVLERËSOHET ME GJAKFTOHTËSI

Romani i parë i letërsisë shqipe botohet një vit pas lidhjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Greqisë (maj 1971). Në vitin 1972, pra, botohet në Greqi “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i Ismail Kadaresë, përkthyer nga frëngjishtja. Respektivisht, po në atë kohë, në Shqipëri botohet po i përkthyer nga frëngjishtja *Kapedan Mihali* i Nikos Kazantzakis-t



Shkëlzen HALIMI

Stavri J. Dajo u lind në Gjirokastrë më 1958. Studioi në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë (1978-1982). Punoi në Shtëpinë botuese “Naim Frashëri” redaktor i poezisë, i dramës dhe i kritikës letrare (1982-1989) dhe në vijim bibliograf në BKSH (1989-1991). Në vitin 1991 emigron në Greqi ku mbaron Master-in dhe gradën PhD në Universitetin e Thesalonikës Arostoteli. Është pedagog i gjuhës shqipe në Institutin e Studimeve Ballkanologjike Selanik dhe pedagog i teknikave bashkëkohore të përkthimit në Kolegjin Universitare Logos në Tiranë. Ka botuar disa monografi për marrëdhëniet e Greqisë me tre fqinjët e saj të Veriut, serinë me tri vëllime “Shqipja për greqishtfolësit” si dhe njihet si përkthyes i letërsisë shqipe në greqisht dhe e kundërta.

HEJZA: I nderuari Stavri, prej vitesh Ju jeni ligjërues i shqipes në Departamentin e Gjuhëve të Huaja të Institutit të Studimeve Ballkanologjike në Selanik. Në ç’nivel është interesimi i qytetarëve grekë për ta mësuar shqipen dhe në këtë drejtim sa janë të dukshme rezultatet?

S. DAJO: Interesi për gjuhën shqipe në Greqi nis shumë herët. Madje, interesi për albanologjinë dhe për studimet e kulturës shqiptare nisin shumë më herët se sa gjuhësia krahasuese indo-evropiane dhe studiuesit gjermanë apo austriakë të studiojnë gjuhën shqipe. Kështu, në ag të shekullit të 19-të, Marko Boçari harton fjalorin e parë të gjuhës shqipe (1809), i cili nuk arrin të botohet për nevoja

utilitare, dhe që është monumenti i parë i leksikografisë shqiptare. Më vonë, dy pararendës dhe protagonistë të studimeve albanologjike me prejardhje arvanitase, Anastasios Kulluriotis dhe Panajotis Kupitoris, themelojnë shtypshkronjën e parë në Athinë nën titullin “I foni të Albanias” - Zëri i Shqipërisë” (1879) ku botohen veprat e para në gjuhën shqipe, një abetare e gjuhës shqipe e hartuar nga Anastasios Kulluriotis ndërsa Panajotis Kupitoris harton një fjalor greqisht-shqip. Në vitin 1903, me financimin e qeverisë greke, Konstantin Kristoforidhi boton fjalorin e famshëm të gjuhës shqipe, i cili në fakt është fjalor dygjuhësh shqip-greqisht. Fjalori u ripunua dhe u transkriptua në alfabetin e shqipes së sotme prej A. Xhuvanit dhe u ribotua më 1961 me titullin Fjalor shqip-greqisht. Është vepra e parë dhe ndër më të rëndësishmet e leksikografisë shqiptare, përpjekja e parë pas fjalorit shpjegues të shqipes, i botuar vetëm 7 vjet pas botimit fjalorit të gjuhës shqipe nga Akademia Shqiptare në vitin 1954. Gjithashtu, edhe letërsia shqipe, megjithëse e re dhe me pak traditë, hyn në sferën e interesave të lexuesit grek. Tregimi i parë i letërsisë artistike shqiptare i takon Ernest Koliqit, “Ändërr e nji mbasditje vere”, i cili botohet në revistën më dinjitoze të kohës “Bëa Estia”, në vitin 1931. Në kohën e Luftës së Ftohtë marrëdhëniet kulturore mes dy vendeve ngrinë, pasi Greqia dhe Shqipëria u takonin kampeve të kundërta (armiqësore) politike, ideologjike dhe ushtarake. Përkthimi dhe botimi i letërsive të ndërsjella duhet të merrte miratimin e metropoleve: të Beogradit, Moskës dhe Pekinit për Shqipërinë, të Londrës,

Uashingtonit dhe Parisit për Greqinë, edhe pse dy vendet i ndante një vijë e hollë kufiri. Në vitin 1953, themelohet Instituti i Studimeve të Gadishullit Ballkanik në Selanik dhe dhjetë vjet më vonë themelohet Departamenti i Gjuhëve të Ballkanit, ku që në vitin 1964 dhe deri tani, gjuha shqipe është ndër gjuhët e studiuar dhe me interes të veçantë për shkencëtarët grekë të gjuhësisë. Në vitin 1980, u botua për herë të parë nga Akademia Greke Fjalori i Marko Boçarit nga Titos Giohallas, akademik i shquar dhe albanolog grek, i cili në një intervistë dhe në atë kohë shpjegonte rëndësinë e madhe që ka gjuha shqipe për studimin krahasues të gjuhëve të tjera evropiane për të vërtetuar prejardhjen e tyre nga substrati i përbashkët indo-evropian. Instituti i studimeve Ballkanologjike ka shumë studentë grekë, shqiptarë të brezit të dytë që studiojnë gjuhën shqipe. Është i vetmi departament në Evropë, diplomat e të cilit i njeh shteti, sikundërse njeh dhe diplomat e anglishtes, frëngjishtes etj. Prej këtij rezervuari kanë dalë studiues të shquar, albanologë, diplomatë, njerëz që u intereson studimi i gjuhës shqipe, po dhe përkthyes të letërsisë shqipe. Një studente e këtij departamenti përktheu nga origjinali “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur” (2009) që deri atëherë lexohej i përkthyer nga frëngjishtja.

HEJZA: Meqë prekëm çështjen e shqipes, vetvetiu na imponohet edhe pyetja: sa grekët e njohin letërsinë shqipe, përkatësisht sa është përkthyer në gjuhën greke?

S. DAJO: Siç thashë dhe më parë, botimi i

parë i letërsisë së mirëfillte shqipe datohet në vitin 1931 dhe vazhdon përgjatë kohëve. Por, pas vitit 1945, marrëdhëniet midis dy vendeve ngrinë dhe përkthimi e botimi i letërsive të ndërsjella bëhet pas miratimit të metropoleve përkatëse. Megjithatë, romani i parë i letërsisë shqipe botohet një vit pas lidhjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Greqisë (maj 1971). Në vitin 1972, pra, botohet në Greqi “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i Ismail Kadaresë, përkthyer nga frëngjishtja. Respektivisht, po në atë kohë, në Shqipëri botohet po i përkthyer nga frëngjishtja Kapedan Mihali i Nikos Kazantzakis-t. Ismail Kadareja është shkrimtari më i njohur shqiptar në Greqi me 28 vepra të botuara, ndërsa numri i përgjithshëm e botimeve nga letërsia shqipe arrin 91, 46 autorë, 36 shtëpi botuese. Nga Kosova dhe letërsia shqiptare e diasporës është botuar romani i Rexhep Qoses “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, botimi poetik i Yllka Imerit “Enigmë” dhe ndonjë tjetër. Në botimin antologjik “Proza e shkurtër e Ballkanit” (2020) janë përfshirë 7 autorë shqiptarë, 4 kosovarë, 3 nga Maqedonia e Veriut, 1 rumun me origjinë shqiptare dhe 1 turk me origjinë shqiptare.

HEJZA: Në fakt, si e përkufizoni Ju përkthimin, sepse jeni njohës i shkëlqyer i disa gjuhëve dhe cili është trajtimi i përkthyesve sot?

S. DAJO: Besoj e keni fjalën për përkthimin e letërsisë artistike. Përkthimi i letërsisë artistike është edhe teknikë edhe art. Ekuilibri “teknikë” apo “art” besoj që anon nga ana e artit. Përkthimi i letërsisë nuk ka lidhje me teknikat e të ligjërimeve të



tjera, publicistik, ose i letërsisë shkencore. Shqipëria ka një traditë shumë të mirë në përkthimin e letërsive të huaja, kemi pasur një plejadë përkthyesish shumë të mirë, të cilët, me bindje e them, që ka lënë një kontribut shumë më të madh, ndoshta dhe më të madh se vetë shkrimtarët shqiptarë në pasurimin e thesarit leksikor të gjuhës shqipe. Më kujtohet kur isha redaktor në Shtëpinë botuese “Naim Frashëri”, ndarë redaktorët në dy grupe, “grindeshim” se kush ka kryet e vendit, përkthimi apo letërsia e mirëfilltë në pasurimin e shqipes, Ne, mbrojtësit e përkthimit i referoheshim Dhimitër Paskos, ata Jakov Xoxes. Por, të dy palët kanë meritat e tyre. Sot përkthyesit nuk trajtohen mirë, paguhën pak në të gjitha vendet e botës, në shumë raste botuesit ua besojnë përkthimeve amatorëve ose Google translation. Niveli artistik i përkthimeve ka rënë dukshëm.

HEJZA: Keni shqipëruar me sukses veprën “Jeta e Aleksis Zorba” të [Nikos Kazantzakis](#), një vepër kjo monumentale. Me çfarë peripeci u përballët gjatë procesit të përkthimit. Na tregoni diçka më tepër për profilin krijues të Kazantzakisit?

S. DAJO: Po, ju keni dhe drejtë. Romani Zorba i Nikos Kazantzakis-it u botua për herë të parë në Shqipëri në vitin 1995, por përkthimi i tij zgjati disa vjet. Ishte botuar më parë (1977) në Kosovë me përkthim nga serbokroatishtja (në serbokroatisht ishte përkthyer nga frëngjishtja!) nga një përkthyes shumë i talentuar, shkrimtar dhe studiues, nga Nazmi Rrahmani. Po, Nazmi Rrahmani, i cili është miku im, guxoi një sfidë të tillë dhe, më kujtohet, ne e lexonim përkthimin e tij në Tiranë dorë më dorë se libri ishte i ndaluar. Përkthimi i Zorbas nga unë u vlerësua në kohën kur u botua, si një nga romanët më të mira të përkthyer të atij viti, ishte bestseller, dhe, sipas mendimit të kritikëve dhe studiuesve të ndryshëm, cilësohet ndër përkthimet më të mira nga letërsia greke. Madje, ka dhe nga ata që mendojnë që romani Zorba futet në përkthimet më të mira të letërsisë së huaj në shqipe. Në fillim, kur vendosa të përkthej Zorbën, u tremba, sepse Kazantzaki-si është një nga shkrimtarët me një arsenal shumë të pasur gjuhësor dhe me veçanti në përdorimin e gjuhës greke, me një pasuri shumë të madhe frazeologjike, por duke u konsultuar me fjalorë të ndryshëm, duke biseduar me njerëz që e njohin shqipen, po dhe me ata të cilat i njohin të folmet e krahinave të ndryshme, ka mundur që të përballoj dhe t’i dalë me sukses kësaj sfide. Natyrisht, kur përkthejmë nga letërsia greke, e cila mbështetet nga një gjuhë me histori të vazhdueshme tremijëvjeçare, ndeshim vështirësi të shumta, por në qoftë se i qëndrojmë shqipes me respekt, e njohim në themel dhe jemi të disiplinuar në punën tonë, mund t’ia dalim me sukses. Shqipja është ndër gjuhët e pasura në botë në njësi frazeologjike, të cilat

kanë kuptime metaforike intriguese dhe kjo të jep dorë në përkthimin letrar. Kujtoj se kur Petro Zheji përkthente Gogolin dhe letërsinë ruse, dinte përmendesh ciklin e kreshnikëve të veriut që ka një pasuri të pafund kuptimesh metaforike.

HEJZA: Cili ishte motivi që Ju, përkatësisht Literatus (2022), të botoni antologjinë “Proza tregimtare e Ballkanit”?

S. DAJO: Selaniku tradicionalisht ka qenë “kryeqyteti” i Ballkanit. Në Selanik janë përqendruar institutet më të njohura për studimin e ballkanologjisë, të letërsisë dhe të kulturës gojore të popujve të Ballkanit. Por, unë si studiues i historisë së Ballkanit, i letërsisë dhe i folklorit, gjithmonë kam pasur vëmendje dhe gjithmonë kam menduar se letërsia që prodhohet në Gadishullin ballkanik nuk është aspak inferiore ndaj letërsive të vendeve të tjera të Evropës. Por, e keqja e vendeve të Ballkanit është se këtë letërsi nuk kanë mundur ta promovojnë dhe të bëhet e njohur në metropolet e Evropës: në Paris, Londër, Uashington etj. Në Tiranë presin që një shkrimtar ballkanas të përkthehet në Francë dhe pastaj në Tiranë. Po kështu në Athinë, apo në Shkup. Kësaj i thonë “mercenarizëm i letërsisë” së Ballkanit. Nga letërsitë e vendeve të Ballkanit kanë dalë fituesit e çmimit Nobel, IvoAndriç, Jorgos Seferis, Odhiseas

ndërsa marrin pjesë 34 përkthyes të njohur grekë. Në këtë vëllim, ku dalin në pah disa vlera estetike bashkëgadishullore. Vëllimi është pritur me ngrohtësi dhe, si nënshënim, studiohet si lëndë didaktike në disa katedra të gjuhëve ballkanike në universitetet greke.

HEJZA: Pas përgatitjes së kësaj antologjie, besoj se tani keni në pasqyrë për prozën e Ballkanit. Si e vlerësoni Ju këtë prozë dhe sa këto hapësira të Ballkanit i kanë dhënë letërsisë botërore?

S. DAJO: Siç thashë dhe më lart, letërsia e Ballkanit nuk është aspak inferiore kundrejt letërsive të tjera në botë. Përveç autorëve ballkanas që kanë marrë çmimin Nobel, ka një brez të rinj shkrimtarësh pak ose aspak të njohur në vendet e tjera. Detyra jonë është që këta të promovohen. P.sh nga vendet e ish-Jugosllavisë ka disa shkrimtarë që kanë spikatur kohët e fundit dhe mund të përkthehen. Pak e njohur është dhe letërsia shqipe e Kosovës dhe aspak ajo e shkrimtarëve shqiptarë të Maqedonisë së Veriut.

HEJZA: Ballkani, në të kaluarën, por edhe tani, për shkak të rrethanave të njohura, gjithmonë është konsideruar si “fuçi baroti”. Sa mund të kontribuojë letërsia, përkatësisht përkthimi i saj, në zbehjen e paragjykimëve dhe shmangies së flakës



Elitis, Orhan Pamuk; Ismail Kadareja ka qenë shumë herë kandidat për ta fituar këtë çmim, që është një nga shkrimtarët më të njohur të shekullit të njëzet. Nisur nga kjo, siç ju thashë, jam redaktor i një botimi antologjik në gjuhën greke – dhe pjesërisht përkthyes i tij–i “Prozës tregimtare të Ballkanit” ku përfshihej 68 shkrimtarë të njohur nga 12 vende (tashmë) të gadishullit, me 70 tregime,

që mund ta ndezë fitilin e kësaj “fuçie baroti”?

S. DAJO: Për Ballkanin gjithmonë është thënë se është një “fuçi baroti”, një “fole grerëzash”, është një hapësirë që “prodhon më shumë histori se sa është në gjendje të konsumojë” dhe shumë cilësime të tjerët zhvleftësuese . Këto cilësime e karakterizime vijnë në të shumtën e

herës nga studiues evropianë, por jo gjithmonë ata janë fajtorë për gjendjen e kulturave të vendeve të Ballkanit dhe sidomos për historinë e tyre. Kjo është më shumë një alibi që na pëlqen vetë neve ballkanasve, për të hequr nga vetja përgjegjësinë vetjake dhe kompleksin e fajit. Në arealin mbarëgadishullor – mbushur me shamatarë, grindavecë e sherrxhinj, kinse bartës idesh origjinale e radikale, me gjykime të anshme dhe trajtime keqprirëse, predikues shterpë të arketitipit të tyre kombëtar dhe cilësues të të tjerëve si kopjacë të pasurisë shpirtërore të të tjerëve (nyjtuar shpesh me stil agresiv e me ide të përcudnuara), letërsia është ajo fushë e ndërgjegjes shoqërore e infektuar më pak nga pasionet nacionaliste, shoviniste, irredentiste dhe raciste. Ajo, historikisht, ka predikuar më shumë dashuri dhe më pak urrejtje. Atje ku politika dhe diplomacia zihen ngërc dhe nuk kanë zgjidhje, shkrimtarët e letërsisë gjejnë gjithmonë një kumt tolerance dhe mirëkuptimi. Po ju sjell dy raste nga dy vendet tona: Në vitet ‘30 lëvizja mbarëballkanike për kualifikimin e shkrimtarit grek Kostis Palamas për të fituar çmimin Nobel, nxiti Palamas-in e Shqipërisë, Gjergj Fishtë, të niset nga Shkodra dhe të mbërrijë enkas në Athinë në mbështetje të kandidaturës greke. Respektivisht, në vitin 1980 kur në Shqipëri nuk guxonte kush të ngrinte zërin për kandidaturën e Ismail Kadaresë për këtë çmim, një shkrimtar i mirënjohur grek, Kristoforos Milionis, iu drejtua solemnisht dhe me guxim intelektual autoriteteve evropiane dhe argumentoi që Ismail Kadare nuk është më inferior se Ivo Andriç-i dhe se shkrimtari shqiptar e meriton plotësisht çmimin Nobel. Pra Ballkani nuk është një krahinë që e meriton stigmatizimin provincial. Konfliktet, madje të agravuara ndodhin dhe në Lindjen e Mesme, në Ukrainë e gjetiu. E vërteta është se vendet e Ballkanit dolën nga “prehri i hekurt” i Perandorisë Otomane dhe u themeluan mbi baza irredentiste. Dhe periudha njëqindvjeçare e formimit të tyre nuk është një periudhë historike e mjaftueshme për të shëruar plagët e se kaluarës. Unë mendojse vendet e Ballkanit kanë një emancipim të mjaft shpirtëror dhe një pjekuri politike dhe kombëtare sa të zgjedhin mosmarrëveshjet e tyre larg shereve, konflikteve dhe përleshjeve të armatosura, të cilat vetëm dhimbje dhe shkatërrime do të sjellin në rajon. Letërsia mund të luajë rolin e një amplifikatori në evidentimin e vlerave më të mira, e vlerave të përbashkëta të vendeve të Ballkanit.

HEJZA: Hapësira ballkanike konsiderohet si djepe i kulturës evropiane, mbase i tërë njerëzimit. Në këto hapësira, në antikë, shpërtheu një art i jashtëzakonshëm, shpërtheu filozofia. Në këtë pjesë të Europës lëvizën Platoni, Aristoteli, Sokrati dhe shumë figura tjera mbresëlënëse.

Atëbotë u fol shumë për të bukurën, të përkryerën, harmoninë! Sot, sipas Jush, cila është qasja ndaj këtyre kategorive filozofike! I pëlqejmë, bëjmë pas tyre? Nëse po, atëherë si sillemi me to?

S. DAJO: Kultura bashkëkohore greke pati fatin të trashëgojë nga Bizanti qytetërimin e lashtë grek. Bizanti ishte ai që i përcolli epokës së re vlerat e patjetërsueshëm të antikitetit të lashtë. Në qoftë se nuk do të ishte Bizanti, atëherë grekët e sotëm nuk do ndryshonit nga popujt e tjerë të Ballkanit dhe të Evropës, sepse kultura e tyre do të ishte harruar. Sot greket bashkëkohorë mburren dhe mburren me të drejtë, sepse janë trashëgimtarë të vlerave të antikitetit grek. Por, duhet të them se Homeri, tragjedianët e lashtë, Aristofani, Aristoteli, Platoni, Sokrati, dhe gjithë qytetërimi i lashtë grek, i takon Greqisë së sotme po kaq sa i takon gjithë rruzullit botëror. Pra, mbi qytetërimin e lashtë grek u ndërtua gjithë mendësia bashkëkohore e Evropës. Greqia e vjetër ka meritën madhe se i dha botës një organizim shoqëror mbi baza demokratike për herë të parë në ag të shoqërisë njerëzore, duke e nxjerrë nga barbaria e mëparshme.

HEJZA: Periudha komuniste, nëpër të cilën kaloi edhe populli shqiptar, prodhoi “artin zyrtar” që e luftonte dekadencën, hermetizmin, “artin për art”. Me rënien e kësaj “ideologjie të kuqe” u përmbysën shumë vlera ideologjike, koncepte e mentalitete, por jo edhe krijimtaria e përgjithshme kulturore e kësaj periudhe! Ndodhi kjo, sepse ne shquhemi si harrestarë të së kaluarës, sado e afërt qoftë ajo, apo, sepse, patëm nevojë për një “mutacion gjenetik” që do të na rikthejë drejt evropianizimit të qenësisë sonë?

S. DAJO: E kam thënë shpesh se periudha komuniste ka qenë periudha më shterpë në prodhimin e vlerave shpirtërore të popujve. Pra, kjo nuk ndodhi vetëm në Shqipëri, por në të gjithë kampin socialist. Në qoftë se do të shikojmë kultura të tilla, siç është kultura ruse, ose kultura e vendeve të ndryshme sllave, e cila në fillim prodhoi vlera të konsiderueshme shpirtërore, në kohën e komunizmit këto vlera u politizuan, u dogmatizuan me pasojë të sajohet një figurë fiktive e njeriut, e cila nuk kishte asgjë të përbashkët me qenien njerëzore. Në Shqipëri kjo u çua në ekstrem, sepse varianti komunist shqiptar është varianti më brutal që iu imponua botës shqiptare. Shqipëria u izolua nga vlerat shpirtërore evropiane, pjesë e të cilave ka qenë që në krye të herë, madje u paragjykua dhe trashëgimia e vet gojore. I vetmi burim ushqyes i kulturës shqiptare ishte fillimisht kultura jugosllave, pastaj ruse dhe ajo kineze, dhe kjo në kundërshtim me traditën e lashtë të vlerave shpirtërore të botës shqiptare e cila kishte orientim evropiane. Megjithatë, jo e gjithë kultura që u prodhua gjatë të ashtuquajturit“realizmit socialist” duhet zhbërë. Shumë vepra të letërsisë së asaj kohe mund të lexohen dhe sot e gjithë ditën dhe të shkaktojnë kënaqësi estetike. P.sh. veprat e Ismail Kadaresë, Rexhep Qoses, veprat e një pjese të mirë të shkrimtarëve kosovarë dhe të Maqedonisë së Veriut. I gjithë mendimi krijues i asaj periudhe ishte shumë më i emancipuar në krahasim me kritiken letrare ose me studimin e letërsisë, sidomos mendim kritik dhe studimor kosovar, i cili qëlloi më i liberalizuar se ai i Tiranës. Merita ka shumë dhe shkenca e gjuhësisë. Këto vlera duhet të evidentohen, letërsia e periudhës komuniste duhet të rivlerësohet objektivisht dhe me gjakftohtësi tashmë, sepse pas rënies së komunizmit kaluan tri dekada dhe shoqëria shqiptare ka fituar pjekurinë e duhur politike dhe ideologjike që ta kryejë këtë mision.

HEJZA: Para viteve 90-ta (1982 -1989) keni qenë redaktor në Shtëpinë botuese “Naim Frashëri”. Çfarë mund të na thonë për vitet e kaluara në këtë Shtëpi botuese. Me kë keni punuar, veprat e të cilëve autorë kanë kaluar, të themi kushtimisht, në duart Tuaja, si trajtohej atëbotë letërsia shqipe që krijohet në ish Jugosllavi, përkatësisht në hapësirat shqiptare jashtë Shqipërisë?

S. DAJO: Jam emëruar në Shtëpinë



botuese “Naim Frashëri” (ent që botonte vetëm letërsi artistike, në kundërvënie me Shtëpinë botuese “8 Nëntori” që botonte literaturë politiko-shkencore) në shtator të vitit 1982 (deri më 1989), sapo kisha mbaruar studimet për gjuhë-letërsi shqipe në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, ku pata fatin të mësoj nga emra të nderuar të gjuhësisë shqiptare, të tillë si Shaban Demiraj, Mahir Domi, Rami Memushaj, Ethem Likaj, Thoma Rrushi e më së pari nga Eqrem Çabej që ishte ndarë nga jeta në vitin 1980, dhe u bashkova në redaksinë e poezisë, të dramës dhe kritikës letrare –në vëmendjen time ishte dhe një seksion i gjuhës greke për botime letrare të shkrimtarëve të minoritetit etnik grek–redaksia më delikate për shkak të natyrës së letërsisë që botonte. Ndiheshin ende vibracionet e plenumit të katërt famëkeq, disa vjet më parë ishte “zbuluar” atje një “grup armiqësor” dhe ishin dënuar redaktorë të zotë për agjitacion dhe propagandë me vite të rënda burgimi. Administrata e institucionit na tërhiqte përditë vëmendjen që të mprehnim “vigjilencën ideologjike”. Për këtë, më vonë, institucioni –si të gjitha institucionet e agjitacionit dhe të propagandës – u thirr, dhe jo pa të drejtë, dhe “institucion i policisë ideologjike”. Nga librat e redaksisë ku isha emëruar, pak kohë më parë (viti 1979), ishte “hedhur në karton” vëllimi poetik “Zgjimi i thellësive” i poetit tim të dashur Xhevahir Spahiu, akuzuar për ekuivokë ndaj Enver Hoxhës dhe redaktori i tij, i ndieri Perikli Jorgoni, rrinte si në gjemba në pritje të dënimit (për shkak të uljes së ndjenjës së “vigjilencës ideologjike”). Në redaksi qarkullonte fjala e Dhimitër Fullanit (një redaktor i vjetër dhe emblematik) se të gjithë ishim viktima potenciale të mërisë së shefave noproanë të Komitetit Qendror dhe jetonim në një “zonë të minuar”. Po kështu, redaksia e tregimit dhe e novelës, drejtuar nga Sami Çabej, për shkak të qëndrimit të butë dhe jokritik ndaj një dorëshkrimi të Ismail Kadaresë, u gjend në objektiv të drejtuesve të lartë. Sundonte, si kudo, një regjim terrori psikologjik dhe shantazhi të pashpallur. Kështu që ngazëllimi fillestar u shua dhe u shndërrua në frikë; punonim në një mjedis skepticizmi dhe heshtjeje në atë “zonë të minuar”. Si i ri, mua m’u besuan kryesisht vëllimet poetike të talenteve të reja atëherë: Ilirian Zhupa, Besnik Mustafaj, Mimoza Ahmeti etj. me të cilët pata një bashkëpunim pjellor dhe konstruktiv. Ata u afirmuan shumë shpejt, dhe me të drejtë, falë talentit të tyre. Përndryshe, për shkak të njohjes së gjuhëve të huaja, më lidhte puna dhe me redaksinë e botimit të letërsisë së huaj që e drejtonte Donika Omari. Ky komunikim ishte për mua një shkollë e madhe dhe përvojë e paçmuar; bashkekzistenca me emra të tillë si Petro Zheji (kur përkthente tregimet e hershme të Gorkit kishte mësuar përmendesh eposin e kreshnikëve se, thoshte, ishte i vetmi leksik që i përshtatej natyrës dhe

stilit të veprës), Bujar Doko (i dënuar në vitet e para të pasqllirimit si “armik i popullit” që punonte i tërëvetmuar), Klio Evangjeli, Afrim Koçi, Shpëtim Çuçka, PiroMisha, por edhe Brikena Çabej, e cila mbulonte letërsinë e huaj për fëmijë, më pasuroi dijen dhe urtësinë e profesionit. Këta punëtorë të palodhur të gjuhës kishin vetëm një laps dhe një gomë (dhe shumë pak fjalorë ose bazë të dhënash), por i dhanë letërsisë vepra madhore nga fondi i letërsisë botërore me një shqipe të pasur dhe tejet të kultivuar. Ndiej nderim të veçantë për ta.

HEJZA: Dhe, një ditë vendosët të largoheni nga Shqipëria e të kaloni në Selanik, ku filluat një jetë të re, përkatësisht një sfidë të re. Por, edhe përkundër kësaj, Ju kurrë nuk i shkëputet lidhjet me Shqipërinë, përkundrazi. Çfarë ju dha dhe çfarë ju mori lëvizja nga Tirana në Selanik?

S. DAJO: Nga viti 1989 deri në vitin 1991, kam punuar në sektorin e bibliografisë së Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Kjo ishte e një nga periudhat më të mira të jetës sime, sepse kisha privilegjin të kisha akses në fondin publicistik të gazetave shqiptare të paraqlirimit dhe të shtypit të huaj, që nuk e kishin pjesa më e madhe e lexuesit të kohës. Kjo periudhë dyvjeçare pasuroi dhe emancipoi shumë ndërgjegjen time ideologjike dhe estetike. Në vitin 1991, në mars, erdha në Selanik dhe që atëherë fillon periudha më e vështirë e jetës sime, sepse duhet t’u përshtatesha kushteve të reja të jetës dhe të mbijetesës. Provova 19 profesione të ndryshme, disa prej të cilave i njoh mirë edhe sot e kësaj dite. Por, dora dorës, njoha diplomën e shkollës së lartë të Universitetit të Tiranës, si ekuivalente me diplomat e universiteteve greke, bëra master-in dhe pastaj tezën e doktoraturës. Pastaj, kam punuar në vende të ndryshme, por, si e thatë dhe ju, asnjëherë nuk i kam shkëputur lidhjet e mia shpirtërore me kolegët e mi shqiptarë, me universitetet e Tiranës, me entet botuese të Shqipërisë dhe bëj ç’ është e mundur që dy kulturat tona, kultura greke dhe kultura shqiptare të njihen reciprokisht nga lexuesit tanë, sepse e ndjej si detyrë morale të brezit tim për brezat që do të vinë, se kjo kulturë do ndihmojë popujt tanë të njohin më mirë vetveten dhe njeri tjetrin.

HEJZA: Si pasojë e shpejtësisë së modernizimit të përgjithshëm, a mund të themi se njerëzimi anekënd botës është edhe në një proces të motorëzimit të kulturës! Këtij procesi, a do t’i shpëtojë krijimtaria letrare, nëse jo, si do të dukej një letërsi e tillë, si për nga forma ashtu edhe për nga përmbajtja. Ç’mendim keni për digjitalizimin e letërsisë? Libri elektronik – a është ky fundi i Bibliotekës klasike?

S. DAJO: Kjo është një bisedë e gjatë që shpesh bëhet me hipoteza dhe pandehma, sepse askush nuk mund të parashikojë

të ardhmen pas arritjeve të fundit të shkencës dhe zbatimeve të IA-së. Por, rreziku më i madh është që brezi B (fëmijët që lindin sot) të shkëputet tërësisht nga realiteti jetësor dhe të jetojë në një realitet virtual, të pagënë. Kjo do të jetë e tmerrshme. Ky konstatim vlen jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjitha vendet kudo në botë. Mjetet e rrjetëzimit social dhe gjithfarë platformash të çdo lloji kanë shpallur “demokracinë e tribunës”, duke krijuar “gazetarinë popullore” ose thënë ndryshe “vulg-gazetarinë”. Paralelisht është krijuar “vulg-gjuhësia”, “vulg-historia” (dhe në këtë lëmë të dijes debati është fort i acaruar dhe shpesh armiqësor ndaj kolegëve). Dhe kjo – në respekt të analogjive– nuk është, detyrimisht, e keqe. Çdokush duhet të ketë zë publik, të drejtën për të thënë solemnisht fjalën dhe bindjet e veta. Por, si pasojë e këtij vërshimi të pakontrolluar, të papërmbajtur dhe shpesh agresiv, janë mbyllur shumë mjete të informacionit masiv (media). Por, sipas gjasave, gazetaria tradicionale (respektivisht, dhe shkenca e historisë, e gjuhësisë, etj.) do të bashkëjetojë me këto forma të shprehuri; ky është një realitet i pakthyeshëm tashmë dhe një evoluim i paprapësueshëm. Në shumë vende, në kryeherë, u tha se shkenca e mirëfilltë dhe gazetaria profesionale duhet të injorojë “specialistët diletantë” të facebook-ut, por me kalimin e kohës u pa se kjo ishte e pamundur. Pala tjetër krijonte “shkollën” e vet, duke sajuar mite të reja, të cilat duheshin shpërbërë si të pavërteta ose të pabazuara shkencërisht se fitonin audiencë, (“audiencën e turmës”) që nuk kishte dijen e duhur të konfirmonte vërtetësinë e informacionit të servirur. Pas kësaj u joshën dhe shumë gazeta, duke përshkallëzuar rrezikshëm publicistikën e verdhë dhe populizmin. Gazetaria e ka më të vështirë, ngase çdokush me një telefon celular që di shkrim e këndim, mund të hiqet si gazetar, paçka se nuk njeh shkencën dhe teknikën e profesionit dhe nuk respekton kodin e tij moral. Por, unë jam i bindur, se mjetet e informacionit me integritet profesional, sikundërse revista juaj, dhe bartësit e informacionit real (dhe jo e fake-news-ve) do të mbijetojnë, dhe lexuesi që rreket të mësojë të vërtetën do të grumbullohet rreth shtypit të përditshëm dhe periodikut serioz dhe jo sensacional që del e ikën si flaka e kashtës. Para disa muajsh një gazetar i Financial Times-it,Tony Barber, mbështetës fanatik i shtypit të printuar, u shpreh tejet pesimist për të ardhmen e tij dhe theksoi se në një horizont afatgjatë, media e printuar do të tkurret vazhdimisht, ndërsa do të fitojë terren media elektronike. Por, kjo është një bindje e shprehur në panik. Kështu u tha dhe për librin elektronik (e book) para shumë vjetësh, por këtu e disa dhjetëvjeçarë, ai nuk tejkalon 5% të tregut, madje është në tërheqje.

Në fokus

HEGJEMONIA KULTURORE DHE STEREOTIPAT BALLKANASE

Është krejt evident rreziku kryesor i destabilizimit që në Ballkan vjen nga Serbia, si shtet me mentalitet autokrat të ngulitur thellë në jetën sociokulturore, duke ndikuar kështu edhe në privimin e integritit sistematik ballkanik drejt hapjes së portave evropiane



Nga Bujar MEHOLLI

Stereotipat për shqiptarët vazhdojnë të ushqehen nga substrati i mendësisë fashistoideserbo-sllave.Eashtuquajtura “Patologji akulturative e shqiptarëve” që mendësia e mykur sllave e ushqen, përmes një propagande psikopatike, mbi popullin tonë, vazhdon të prodhojë pamje të shëmtuara, si skenat antisportive në ndeshjen futbollistike Rumani-Kosovë mes koreve raciste dhe fyerjeve mbi bazë kombëtare, derisa paradoksalisht perëndimi, si rëndom, duket se e sheh me rezervë “çështjen” shqiptare. Në terrin e mosnjohjes së kulturës sonë, siç shkruan Gani Bobi, çdo gjë shqiptare iu duket si “e zezë”. Ndaj, konstaton Bobi, “shqiptarët mbesin gjithnjë “arnautë të egjër”, “barbarë që s’lidhen”, “popull parakulturore”, “masë e ngjashme me kafshët”, mu pse kultura e tyre ishte e ndryshme nga ajo e atyre që e “vlerësonin”. (Gani Bobi, Paradoks kulturore, Rilindja, Prishtinë, 1986)

Në njërën nga esetë e tij, Krleža, përshkruan stereotipet mbi shqiptarët, që vlonin në kazanët e llumit fashisto-serb, nga kabinete ministrash te opinionioni publik radikal, duke tentuar krijimin e prototipit të njeriut të egër, tribal, shqiptar. Populli shqiptar konsiderohet si “i pa rrënjë, i pa emër, pa histori, pa kulturë, pa gjuhë dhe pa letërsi, pa histori, pa poezi, pa atributet që e bëjnë individin dhe fisin njerëzor; këta Gegë dhe këta Toskë, këta melezë të tipave të ndryshëm antropologjikë...” (Mirsolav Krleža, Ese, përkthyer nga Vehap Shita, Rilindja, Prishtinë) Mania psikopatike sllave për ta paraqitur shqiptarin inferior e të predestinuar për të çuar jetë tribale përherë është e po e njëjta, edhe në shekullin e ri, ajo ushqehet vazhdimisht; e kanë zor ta pranojnë se këta “shpellarë” shqiptarë s’kanë gjë mangut krahas popujve tjerë, kanë shtetet e tyre, himnet, sportin, kulturën, e janë pjesë organike e qytetërimit. Këtë vandalizëm, psikopatinë fashiste sllave, Evropa e

njeh qëmoti, ndaj s’duhet ta bëj veshin shurdh përjetësisht, përkundrazi, është imanente lufta frontale deri në zhdukjen përfundimtare të kësaj mendësie arkaike, primitive, që e karakterizon, veçan, meskinitetin sllavo-jugor. Prosperiteti nuk arrihet ndryshe veçse duke krijuar ambient diversant ku konceptonet mbi tjetrin nuk marrin përmasa asfiksuese; binomi bardh-zi që gjeneron mendësinë prapanike të ngulitur thellë se tjetri duhet eliminuar, duhet zhdukur e asgjësuar në mënyrë që unë të ekzistoj, të mbijetoj - kjo maskaradë ballkanase, sllave, ka, siç dihet, substratin nga obskurantizmi alla mesjetar; obskurantizëm që ushqen njëtrajtshmërinë në mendim dhe ju jep hov trilleve nacionaliste-folklorike pa kurrfarë substance, sall propagandës së trumbetuar që përherë nxit sentimentin sllav, de facto pseudopatriotizëm e pseudonacionalizëm, siç mund të shihet shpesh, fjala vjen në Kosovë - kur kryeministri Albin Kurti dhe qeveria e tij flasin për integritet të veriut të vendit, Mitrovicës, në mënyrë që të krijohet normalizimi nën ligjet dhe kufijtë administrativë të Republikës së Kosovës - nga viktimizimi dhe hipokrizia e prosperitetit euro-perëndimor që fshehin pas tyre ende deliret e sëmura të zgjerimit territorial, veç tjerash. dhe patologjisë urrejtëse ndaj gjithçkaje që ka të bëjë me neve, shqiptarët.

Është krejt evident rreziku kryesor i destabilizimit që në Ballkan vjen nga Serbia, si shtet me mentalitet autokrat të ngulitur thellë në jetën sociokulturore, duke ndikuar kështu edhe në privimin e integritit sistematik ballkanik drejt hapjes së portave evropiane. Shqiptarët (veçan në Kosovë) i kanë problemet e tyre, reale, qoftë politike, qoftë socio-ekonomike, përballjet me atë që e quaj anarko-demokraci dhe që prek sferat kyçe shoqërore, nga eksploatimi i kulturës masive, masmedias, te mentaliteti arkai, provincial; dorën në zemër kjo është situata faktike e cila dhemb, pikërisht pse rrezikon

krijimin e shqiptarit pasiv, jo ai të cilit Andon Zako Çajupi i thërret: mos rri, po dukul, shqiptarin i cili është impulsiv sall në konglomerat patriotizmash e nacionalizmash folklorik, jo substancial. Substrati i nacionalizmit shqiptar duhet të vazhdojë pragmaticitetin e rilindësve, të çlirohet në plotni nga folklorizmat dhe fermentet patritotiko-patetike, e të ndërtohet mbi bazat e iluminizmit francez, ide të cilat i absorboi Rilindja jonë e lavdishme Kombëtare. Rilindja Kombëtare letërsinë e shihte si mjet tejet efikas për të ushtruar ndikim në masë, kështu për t’i ndriçuar mendjet e një mase njerëzish që në përgjithësi kishin telashe me shkrim-lexim. “Historia dhe folklori ishin jo vetëm tipar specifik por edhe mjet lufte kundër paragjyqimeve fetare nga njëra anë dhe si mjet i përshtatshëm konstituimi i entitetit kombëtar dhe kulturore, mjet mësimi racional me anën e të cilit u kumtohej bashkëkombësve në gjuhën kombëtare se cilët ishin, nga vinin dhe ku shkonin, nga ana tjetër. Baza tematike dhe ideore e letërsisë së kësaj epoke, synonte ndiqimin e mendjes së lexuesve, të cilëve u flitej dhe emancipimin e njeriut si individ dhe atë të kombit si kolektiv.” (Masar Stavileci, Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Rilindja, Prishtinë, 1990) Ky është një dimension tejet i rëndësishëm i edukimit patriotik të shqiptarëve të rij, jo me trumbetimin e nacionalizmit folklorik e patetik, përkundrazi, me forcimin dhe stampimin thellë-thellë të nacionalizmit shqiptar të ndërtuar mbi themele të forta kulturore-edukative, ruajtje të gjuhës shqipe e të zakoneve që dëshmojnë për etablimin e një vjetërsie të admirueshme të shtrirjes në këto troje. Paradoksalisht duket sikur sot kemi bërë regres dhe jemi kthyer në pikën zero - leximi si refleksion është në nivel tejet të ulët te një individ i cili mandej lehtë bëhet pre e kombinacioneve nacionalisto-patetike. Vetëm prosperiteti përbrenda entitetit shqiptar dhe rritja e një nacionalizmi

racional mund të bëhen faktorë në rrugën e vështirë drejt integritit të plotë dhe shuarjes së stereotipave e qasjes së rezervuar që perëndimi ende e aplikon në relacion me shqiptarët.

Është me interes përkëtë temë një pasazh i eseistit austriak Karl-Markus Gauß që shkruan për Evropën kontroverse e ultranacionaliste, ndërtuar mbi popujt antemural “jashtë evropian”. “Evropa ultranacionaliste e të pushtetshmëve, të cilët për me përmbushë synimet e tyre nuk munden me u paraqitë ma si nacionalistët e dikurshëm - edhe pse të tillë kanë mbetë - kërkon me e përkufizue veten rishtazi dhe me e rishkrue historinë e saj si një biografi shenjtoreësh. Të gjitha aktet barbare që kanë zanë fill në Europë janë servirë si ngatërresa me rranjë jashtëeuropiane; e pastrueme nga ndërgjegjja kriminale, Europa mashton tue u ba sinonim i demokracisë, i tolerancës dhe i dinjitetit njerëzor...” (Nga esejat Dy Evropa, e përktheu G. Bakalli, ARS) Hegjemoni kulturore euro-perëndimore duket sikur është ndërtuar, siç thotë Krleža, nga kockat e popujve të vogël e të përvuajtur, godinat baroke, glamuroziteti evropian shërben, mesa shihet, sall si fasadë e stereotipave që ende si të thuash e ruajnë statukuonë e tyre. Kjo Evropë e qytetëruar që ngrihet krenare e shoqëruar nga simfonitë e Beethovenit nuk denjon t’i jap një zgjidhje përfundimtare moçalit ballkanas - ende s’është e zonja tëvendosë rregull e t’i sanksionojë ashpër fashistët serbë, si fjala vjen rokerin Bora Đorđević i cili shkruan vargje të tilla denigruese “Šiptari se kote, *** te živote”, apo kur elementë të ultranacionalizmit serb e shndërrojnë arenën sportive në podium shpërfaqjesh urrejtëse, fyese, denigruese, krejtësisht antipod i asaj që perëndimi mëton, por në këto raste kanë mëdysheje, presin ende, siç duket “evropianizimi” i Serbisë do t’ju marrë goxha kohë...

Filozofia si çlirim

E VETMJA FORMË E DISKURSIT RACIONAL QË NUK KORRUPTOHET

Filozofia nuk ka nevojë për një subjekt si autoritet për të vendosur një argument. Është më tepër argumenti që pohon autoritetin e vet mbi subjektet e tij



Sead ZIMERI

Pyetjes se cili është thelbi i filozofisë ose, më saktë, cili është një element që e ka shoqëruar filozofinë që nga fillimi i saj e deri më sot, mendoj se përgjigja është: liria. Dhe është një formë shumë specifike e lirisë. Është liria si çlirim, ose për të përdorur një zhargon më modern, liria si dekolonizim. Njeriu kurrë nuk është plotësisht i lirë, dhe ndoshta do të ishte e paarsyeshme të mendosh për veten si plotësisht të lirë.

Këtë e shohim në alegorinë e shpellës së Platonit. Në Republikën e tij, Platoni përshkruan një grup njerëzish që jetojnë të lidhur me zinxhirë në murin e një shpelle, përballë një muri të zbrazët. Ata shikojnë hijet e projektuara në mur nga objektet që kalojnë para zjarrit pas tyre dhe u japin emra këtyre hijeve. Këta njerëz mund të mendojnë se janë të lirë, por liria e tyre është iluzore, dhe detyra e filozofisë është pikërisht t’i bëjë të vetëdijshëm për dominimin e tyre. Filozofia gjithmonë ka parë lirinë si çlirim, si një përpjekje për t’u çliruar nga zinxhirët të imponuar nga vetvetja ose nga të tjerët. Gjendja jonë shoqërore nuk është ajo e lirisë, por ajo e prangave dhe shumë nga ne kalojmë gjithë jetën tonë duke u përpjekur të çlirohemi prej tyre. Liria nuk konsiston në një esencë, por në luftën për të arritur çlirimin nga dominimi. Liria është çlirim. Dhe çlirimi mund të jetë gradual: dikush mund të çlirohet nga një zinxhir për të kuptuar se ai ende nuk e ka çliruar veten nga zinxhirët e tjerë. Për më tepër, ne nuk jemi të gjithë të çliruar njëlloj: disa janë më të lirë se të tjerët, dhe disa janë ende të kolonizuar, mendërisht, politikisht dhe ekonomikisht. Dikush mund të çlirohet nga një dogmë për të kuptuar se ajo duhet të çlirohet edhe nga dogmat e tjera.

Liria është pra një proces i vazhdueshëm çlirimi dhe në këtë kuptim liria utopike, sepse ka zinxhirë që nuk i kemi parë ende dhe zinxhirë që ne i shohim, por përmes asaj që Sartri e quajti keqbesim (mauvaise foi) ne i racionalizojmë ato dhe i pranojmë

si të pashmangshme, siç janë gjërat: “nuk është aq keq”, “mund të jetë edhe më keq”, “duhet të jemi mirënjohës që kemi edhe këtë pak liri”, etj. Kjo është veçanërisht e dukshme në “esenciizimet” gjinore ku gruaja burgoset brenda një esence dhe dominimin i saj arsyetohet përmes racionalizimeve që në fakt mbrojnë shtypjen dhe diskriminimin gjinor.

Racizmi, seksizmi, antisemitizmi dhe të gjitha format e shtypjes mbyllin disa njerëz në një “esencë” imagjinare, reduktuese dhe mohojnë ose nënvlerësojnë se ata, si qenie njerëzore, janë thelbësisht subjekte të lira. Të gjitha këto janë akte të keqbesimit, të frikës nga liria. Sepse vetëm një person i dominuar do të zgjedhë të justifikojë atë që nuk mund të pranohet përmes lirisë. Aftësia e qenies njerëzore për të racionalizuar dominimin e saj, për të justifikuar zinxhirët e saj është me të vërtetë e pafundme. Por nuk ka dinjitet në zinxhirë, ose më saktë nuk ka dinjitet në pranimin e zinxhirëve si fatin tonë, si të pashmangshëm. Filozofia sigurisht është një ligjërim i veçantë çlirimi. Është një ligjërim mjaft abstrakt dhe shumë teorik dhe bazohet jo shumë, si shkenca, në vëzhgim, megjithëse mbështetet në vëzhgim, por në argument. Filozofia çliron përmes argumenteve dhe e ushtron autoritetin e saj jo përmes ndonjë institucioni shoqëror, si kisha, xhamia apo organizata politike, por përmes argumentimit. Filozofia është në vetvete një sistem anarkik në atë që nuk njih asnjë shef tjetër mbi vetveten. Në fakt, filozofia është i vetmi ligjërim që e heq çështjen e autoritetit krejtësisht nga duart e shoqërisë, të cilin ajo e ushtron nëpërmjet institucioneve të saj. Filozofia largohet nga kjo formë e kontrollit shoqëror dhe kërkon të investojë me autoritet jo individin por procesin e shkëmbimit të argumenteve dhe arsyeve. Në këtë kuptim, filozofia është rrënjësisht një ndërmarrje egalitare. Nuk ka hierarki, nuk ka zotërinj dhe skllëvër, nuk ka autoritete dhe fjala e askujt nuk ka ndonjë peshë për shkak të autoritetit të

tyre shoqëror. Filozofia është rrënjësisht egalitare, rrënjësisht komuniste në kuptimin altuserian se “komunizmi është një mjet prodhimi në të cilin nuk ka marrëdhënie ekonomike shfrytëzimi, asnjë marrëdhënie politike dominimi apo nënshtrimi, asnjë marrëdhënie ideologjike frikësimi apo shtypjeje dhe asnjë skllavërim ideologjik.... Komunizmi është respekt për qeniet njerëzore”

Filozofia është rrënjësisht egalitare, ose komuniste nëse nuk të tremb kjo fjalë, sepse ajo njih barazinë themelore të të gjithë qenieve njerëzore, Barazia është premisa e saj e domosdoshme dhe e pashmangshme. Nuk mund të bëhet filozofi nën asnjë premisë apo supozim tjetër, sepse në atë rast do të thotë se ajo nuk mbështetet në forcën e argumentit, por në ndonjë autoritet të pazbuluar. Filozofia nuk mund të pranojë asnjë formë autoriteti jashtë argumentit pa pushuar së qeni filozofi. Meqenëse filozofia nuk njih asnjë formë të autoritetit shoqëror, ajo është rrënjësisht joautoritare në natyrën e saj dhe mund t’i ndjekë argumentet e saj vetëm në një mënyrë joautoritare. Prandaj kërkon përdorimin e lirë të arsyes dhe lirinë e fjalës. Filozofia mbështetet në argumente, por argumentet farkëtohen në kolektivë, në komunikime me të tjerët. Në këtë drejtim, filozofia ka një afinitet mjaft të madh me fenë. Në mënyrë ideale feja është gjithashtu një hapësirë e barazisë së plotë. Besimtarët janë të gjithë të barabartë para Zotit. Dallimi i vetëm, një dallim mjaft i madh, është se Zoti është shumë më i prirur të përdoret dhe keqpërdoret nga përfituesit, nga demagogët dhe nga autoritetet politike. Ne e dimë se kjo është një e vërtetë historike. Për më tepër feja nuk ka qenë e imunizuar ndaj ngritjes së hierarkive të brendshme dhe të ngurta që kanë qenë problem për të që nga fillimi i tyre.

Në këtë kuptim, filozofia është jashtëzakonisht unike. Askush nuk ka qenë ndonjëherë në gjendje ta përdorë për të justifikuar ndonjë regjim që shenjtëron shtypjen. Filozofia ka qenë gjithmonë

në anën e atyre që luftojnë shtypjen, jo për arsye ideologjike si ato të ofruara nga marksizmi apo lëvizjet e tjera revolucionare. Filozofia është në thelb kundër shtypjes për shkak të eksternalizimit të autoritetit të saj në argument si një formë marrëdhënieje që kërkon njohjen e barazisë dhe lirisë. Ky është edhe ndryshimi midis filozofisë dhe ideologjisë, madje edhe ideologjisë egalitare. Ideologjitë janë mbështetur gjithmonë në një subjekt që do të na emancipojë, që do të heqë zgjedhën e shtypjes dhe që do të na çojë në tokën e premtuar të lirisë. Është e vështirë të imagjinohet një lëvizje shoqërore politike, qoftë edhe një lëvizje shoqërore anarkike, që nuk mbështetet apo presupozon ndonjë formë të subjektivitetit politik dhe e investon atë subjektivitet me një autoritet të caktuar të vetëvendosjes. Kjo është ndoshta e pashmangshme në çdo kontekst politik. Ne duhet t’i imagjinojmë qeniet njerëzore sikur kanë njëfarë autoriteti mbi jetën e tyre, dhe kjo është praktikisht e nevojshme nëse duam të jetojmë së bashku në shoqëri. Ne duhet të jemi në gjendje të marrim vendime për jetën tonë. Në këtë kuptim, ideologjia është subjekt-centrike: duhet të presupozohet minimalisht një autoritet subjektiv që ushtron pushtet mbi veten dhe të tjerët.

Filozofia është plotësisht e desubjektivizuar. Filozofia nuk ka nevojë për një subjekt si autoritet për të vendosur një argument. Është më tepër argumenti që pohon autoritetin e vet mbi subjektet e tij. Në këtë kuptim, një filozof është vetëm një kanal i artikulimit të argumentit, por argumenti nuk mbështetet për autoritetin e tij në autoritetin e filozofit. Një filozof nuk ka autoritet mbi autoritetin e argumentit. Ai nuk mund të vendosë një argument duke pohuar autoritetin e tij, sepse autoriteti i tij nuk ka peshë mbi autoritetin e argumentit; ai nuk mund të vendosë një argument me forcë edhe nëse ka mundësi të tillë; ai nuk mund të vendosë një argument me manipulim edhe nëse është mjaft i zoti në të; ai nuk mund të vendosë një argument me dinakëri, me bindje, me kompromis, apo duke treguar shthurjen

morale të kundërshtarit apo duke treguar kredencialet e tij akademike. Asnjëra prej tyre nuk ka rëndësi, sepse të gjitha këto forma keqkuptojnë dhe keqinterpretojnë natyrën dhe veprimtarinë e hetimit filozofik. Për shkak se filozofia bazohet në argument dhe jo në autoritet, ajo është e vetmja formë e diskursit racional që nuk mund të korruptohet duke korruptuar

praktikuesit e saj. Një filozof mund të jetë një politikan dominues, një mohues i barazisë themelore të njerëzve, një shtypës dhe kolonizator, por sigurisht që ai nuk mund të gjejë justifikim për këto praktika në filozofi siç përkufizohen këtu. Filozofia është pra lufta për liri intelektuale dhe shoqërore nga të gjitha format e autoritarizmit intelektual dhe tiranisë shoqërore. Megjithatë, filozofia

do të mbështesë natyrshëm të gjitha llojet e betejave për çlirim, sepse ajo pranon se format e strukturimit politik që bazohen në hierarki, veçanërisht hierarkia shtypëse, janë të dëmshme për diskursin e saj. Natyrisht, filozofia është gjithashtu e vetëdijshme për faktin se disa forma të hierarkisë janë të pashmangshme në shoqëri, por ajo do të mbështesë vetëm ato hierarki që nuk janë autoritare, por të

ngritura mbi bazat e njohjes së barazisë themelore dhe për të kryer detyra specifike në shërbim të atyre që kanë pranuar si zgjidhje praktike hierarkinë. Nuk ka hierarki natyrore: të gjitha hierarkitë janë të natyrës sociale dhe si të tilla ato duhet të jenë vetëm funksionale dhe të hapura për shqyrtim dhe ndryshim.


Ndahet nga jeta shkrimtari Astrit Bishqemi

LETËRSI E MADHE PËR LEXUESIT E VEGJËL

Astrit Bishqemi ishte dhe do të mbetet modeli i shkrimtarit qytetar, që merrej vesh me sy me lexuesit e veprave të tij, që fliste dhe sillej si fëmijë me fëmijët, duke u munduar që me artin e tij t’iu ushqente sa më shumë fantazinë

Agim BAJRAMI

Nuk doja t’iu besoja syve, kur në orët e vona të natës se ftohtë të këtij janari, lexova njoftimin mortor, për ndarjen nga jeta të njërit prej personaliteteve më të spikatura të letërsisë sonë për fëmijë, prof As Dr Astrit Bishqemi, shkrimtarit të «Gjoks Shkëmbi”, Përtej oborrit diellor”, “Çelësi i depos”, Kronikë me tank”, i bibliografisë enciklopedike, Elbasani ndër vite, i librit të njohur studimor, Teoria dhe historia e letërsisë për fëmijë e të rinj, si dhe i një numri të madh librash të tjerë, përralla, novela, tregime dhe romane, me të cilat, ashtu siç thoshte një tjetër pene e artë elbasanase, Musa Vyshka, mund te krijohet fare mirë një bibliotekë për fëmijë. Ndonëse në distancë, isha munduar ta ndiqja sa të mundja veprimtarinë krijuese të këtij njeriu të lindur dhe të krijuar enkas për librin për fëmijë, të cilit ai iu fal dhe i qëndroi besnik gjer në frymën e fundit, me botimet dhe kontributet e tij letrare unike për nga vlerat. Shumë vite të shkuar, kur unë trokisja me droje në redaksinë e gazetës lokale të asaj kohe, Shkumbini, me ca fletë të zhubrosura poezish në duar, ishte ai që me sjelljen e tij të ngrohtë dhe të përzemërt, më orientoi drejt shinave të duhura të shkrimit, duke më inkurajuar dhe ndenjur pranë me vite te tëra. I pa përkëdhelur asnjë herë nga fati, larg mbështetjes së politikës zyrtare të kohës, talenti i tij i madh, ia doli të triumfonte përballë çdo pengesë dhe kufizimi që i dilte përpara, duke e radhitur veten në radhët e krijuesve më në zë të gjeneratës së tij, si Adelina Mamaqi, Tahsim Gjokutaj, Odhise Grillo, Xhevat Beqaraj, Agim Deva etj, duke tërhequr kështu vëmendjen e kritikës së kohës, sa për mënyrën interesante të trajtimit të subjekteve, aq dhe për lirshmërinë me të cilët ata sinkronizoheshin me shijet e lexuesit. Ishte ky grup shkrimtaresh dhe ndonjë tjetër, që me talentin dhe përkushtimin e tyre të madh, arritën të shkruajnë një letërsi të madhe, edhe nën sytë vëzhgues të një censure të rreptë. Duke qenë edhe unë një nga lexuesit e tij të zellshëm, s’mund të lë pa përmendur stilin e tij dinamik të rrëfimit, karakteret e gjallë dhe atmosferën artistike që krijoi ky autor në romanin “Kronikë me tank”,me temë nga trazirat e vitit 1997, ose Çelësi i depos e ngjarje nga lufta Nacionalçlirimtare, pa folur këtu për grupin e librave të karakterit fantastik – shkencor. Në shumicën e këtyre veprave lexuesi i vogël gjente të vizatuar veten në çaste dhe gjendje të ndryshme, botën e tij të brendshme të pastër dhe të dëlirë. Ndaj nuk është rastësi që takimet e tij të herëpashershme me lexuesit e vegjël dhe mësuesit nëpër shkollat tetëvjeçare të Elbasanit, Cërrikut dhe rrethinave, të shndërroheshin në festa të vogla dhe të paharruara letrare. E them pa më të voglin ngurrim, se Astrit Bishqemi ishte dhe do të mbetet modeli i shkrimtarit qytetar, që merrej vesh me sy me lexuesit e veprave të tij, që fliste dhe sillej si fëmijë me fëmijët, duke u munduar që me artin e



tij t’iu ushqente sa më shumë fantazinë. Duke njohur mirë sekretet e botës së tyre, arrinte të futej, siç dinte ai, në sirtarët e fshehtë të ëndrrave të tyre, të rrëmihë brenda tyre, duke zgjidhur atë çka i duhej, për t’ua kthyer ato më pas të transformuar në vepra letrare. Si studiues i palodhur, ai ndiqte me interes vijimësinë e letërsisë për fëmijë brenda dhe jashtë vendit, gëzohej për arritjet, por edhe trishtohej shumë për problemet e shumta që haste kjo letërsi në rrugëtimin e saj. Në shumë shkrime dhe studime, ai nuk e fshihte shqetësimin dhe dhimbjen, për harresën dhe lënien e qëllimshme pas dore të saj. Kritikat e tij në adresë të institucioneve shtetërore për indifferencën e hapur të tyre ndaj kësaj letërsie mbetur në stanjacion, në kushtet e tranzicionit të tejzgjatur shqiptar, janë ende të freskëta. Si studiues ai nuk dinte të mbyllte sytë dhe të behej palë me dukuritë e shëmtuara, që solli me vete ky tranzicion dhe bëri gjithçka për t’i luftuar ato, jo vetëm duke u prononcuar, por duke vendosur përballë tyre, modele të gjallë të letërsisë së vërtetë, me heronj dhe botëkuptime krejt të ndryshëm nga e

ashtuquajtura letërsi - soc – realiste. Edhe në Universitetin Aleksandër Xhuvani, ai krijoi figurën e pedagogut të përkushtuar që komunikonte me studentët e tij me metoda të përparuara bashkëkohore. Të flisje me Astritin kishe ndjesinë se nuk po flisje me një njeri të zakonshëm, por me një autoritet që rrezatonte kulturë dhe mirësi të pafund. Thjeshtësia e komunikimit me lexuesit dhe me kolegët e tij, e bënëin atë kaq të afërt dhe te adhuruar nga të gjithë. Ata që kanë pasur fatin të punojnë me të, thonë se metoda e tij komunikuese, ishte për t’u marrë shembull. Në çdo fjalë të tij, ai rrezatonte vetëm kulturë dhe mjaltë diturie. Astriti ishte miku i të gjithë atyre, që donin ta identifikonin veten me letërsinë dhe misionin e saj të shenjtë humanitar. E nderonte misionin e tij të shkrimtarit dhe nuk kënaqej asnjëherë me atë çka realizonte. Përpara procesit shkrimor tavolina e tij e punës mbushej me shënime dhe fakte, që do t’i shërbenin atij hap mbas hapi për veprën e ardhshme. Mjeshtër i narracionit dhe ndërtimit të frazës, shumica e veprave të tij shquhen

për ngjyra të gjalla jetësore dhe karaktere me botë të gjerë. Heronjtë e tij ishin fëmijët me gjithë kompleksitetin e jetës dhe rritjes së tyre. Ashtu siç është në karakterin e shkrimtarëve më të mirë të kësaj fushe, ai nuk i shikonte karakteret e tij që nga larg, por shkrihej e bëhej njësh me ta gjatë gjithë procesit shkrimor, pa pasur aspak droje nga kjo gjë. Është kjo arsyeja që në veprat e tij gëlojnë gjithë kohës tipa dhe karaktere nga më interesantet, subjekte dhe ndodhi që ta mbajnë frymën pezull. Nga ana tjetër, ai s’lodhej duke shkruar pareshtur me orë të tëra volume të pafundme me vëzhgime dhe studime të thelluara letrare, që i shërbyen jo vetëm kohës kur u shkruan, por edhe brezave te ardhshëm te krijuesve dhe studiuesve të letërsisë sonë kombëtare.

Bir i një familje të vjetër elbasanase dhe një qyteti ku u lind Kostandin Kristoforidhi, Dhimiter Shuteriqi, Musa Vyshka etj, ai mori shumë nga përvoja e tyre dhe i dha një dimension më të gjerë talentit të tij të madh. Edhe pse shumicën e subjekteve dhe ngjarjeve te veprave te tij ai i mori pikërisht nga historia dhe e sotmja e këtij qyteti, ai iu dha atyre një shtrirje dhe rrezatim shumë më të gjerë, duke futur në to problematikat dhe shqetësimet e fëmijëve të të gjithë kombit. Jo më kot shumë nga veprat e tij janë nderuar me çmime të ndryshme nëpër ngjarje dhe konkurset e mëdha kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe janë rekomanduar për t’u bërë pjesë e lëndës së leximit letrar nëpër shkollat tona. Figura e tij prej shkrimtari në kohë, u bë model frymëzimi dhe adhurimi për shumë letrarë, ndërsa kolegët e niveleve të tij, ngurronin t’i dërgonin krijimet e tyre në shtëpitë botuese, pa marrë më parë mendimin dhe sugjerimet e tij te vjera. Astriti ndiqte me interes dhe kishte një dobësi të dukshme edhe për letërsinë që shkruhej dhe vazhdon të shkruhet me sukses edhe përtej kufirit tonë shtetëror, si në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Shumica e vëzhgimeve dhe studimeve të tij nuk mund të konceptohen pa veprat dhe emrat e autorëve të atyre viseve. Ai dëshpërohej dhe ndihej keq kur ndeshje me përcaktimet letërsi shqiptare, letërsi kosovare, Për një shkrimtar atdhetar si ai, përcaktime të tilla ishin aspak normale, tendencioze dhe antikombëtare.

Prof Astrit Bishqemi nga tash e tutje do të jetë një mungesë e madhe për ne, që e deshëm, që e lexonim dhe e adhuronim artin e tij shkrimor. Ai u ngut te ikte para kohe nga jeta tokësore jo vetëm nga shkaku i sëmundjes, nga e cila vuante prej kohësh, por edhe nga fakti që njerëz si ai, nguten për t’u takuar shumë më shpejt se të tjerët me qiellin dhe enigmat që fsheh ai. Iku duke lënë pas një krijimtari të pasur dhe të vyer, që sado të kalojnë kohët, vlerat e saj nuk do të zbehen asnjëherë. Unë i besoj postulatit se kur një shkrimtar ia mbërrin të identifikohet me vepra të tilla, ai mbetet gjithmonë i pranishëm mes nesh...

Reportazh letrar

MEGJITHKËTË E LARGËT

- Pse hiqesh si trim? A mendon se të frikohem, më pyeti Mendimi. Unë s’dua të frikohet njeriu prej meje, sepse ai frikohet vetëm prej egërsirës së tërbuar, i thash.

Teki DERVISHI

Stacioni i vockël hekurudhor i Xërxës qe fundosur në terrin e thellë dhe të errët të natës së tetë nëntorit. Në peronin e zbrazur e të përbaltur derdhej si me rrëshekë xhuvama e shiut, që s’pushoi që kur ja nisi të bijerë aty kah mesdita. Në sallën e pritjes ndizej një stufë e madhe, në të cilën kishin hedhur thëngjill-guri të lagur, që digjej vështirë dhe bënte të të zihej fryma nga duhma e tij e rëndë, që lëshonte herë pas here. Punëtori i hekurudhës, pas pak, solli një fener të madh, e salla u mbush me dritë të zbehtë e pak të verdhë. Vetëm atëherë pash se ajo ishte përgjysmë e zbrazur, kurse njerëzit që prisnin trenin, ishin ca fshatarë të lodhur e shumë të përloqur nga balta që kishin shkelur rrugës, e cila do t’i ketë shpënë gjer këtu.

- Pse nuk e keni sjellë rrymën elektrike këtu në stacion, e pyeta unë punëtorin e hekurudhës.

Zotëri, a do të vonohet edhe ca treni?, u përzie dikush tjetër, kështu që punëtori ju përgjigj shpejt atij tjetrit, duke harruar kështu t’i përgjigjej edhe pyetjes sime. Bënte ftohtë. Fshatarët kishin rrethuar stufën e madhe dhe, herë pas here, shprushnin thëngjillin me një hekur të gjatë e të hollë, kështu që hiri derdhej në dyshemenë e çimentuar, kurse tymi e mbushte krejt lokalin. Një grua, e mbushur plot rrudha, por e cila dukej qartë se nuk kishte shkelur akoma të tridhjetë e pestat a të dyzetat, me gishta në hi, shpruhte gacat e derdhura në dysheme, dhe vetëm pasi i hiqte ato, i vente aty, në hirin e pastruar, po të nxehtë, shputat e zbatthura të fëmijës, që e mbante ngrykë.

Meqë s’kisha ku të ulem, kishte orë që shëtisja nëpër sallë, gjithnjë duke ruajtur durimin dhe duke përballuar lodhjen, e cila gati m’i kishte këputur gjymtyrët. Buzët më ishin mbushur plot shkru mb, goja hidhëruar fare, kurse në pakon e cigareve, kur e ndeza të fundit, pashë se kishin mbetur vetëm edhe disa. E ndrydha plot pezëm letrën prej celofani, që kishte mbetur e zbrazur dhe, si të pavlerë që ishte, e hodha me nervozitet në dysheme. Këtë gjë e pa fshatari i veshur me tirq të nxirë e me ca cukla të tjera qytetare, i cili, venerova, ishte kapur fort pas duqeve, që i mbante në shpinë, pa i lëshuar asnjëherë në dyshemenë e lagur, gjatë krejt kohës sa prisnim aty.

-A di ta pshtjellish, më pyeti, duke ma ofruar kutinë e madhe e të bardhë të duhanit, të cilën e nxori nga xhepi i jelekut, në parzmë që e kishte, me njërën dorë duke e mbajtur, thuajse do t’i ikte, kurse me tjetrën gjithnjë duke i shtrënguar duqet e mbushur me diçka që nuk mund ta lëshonte në dyshemenë e lagur.

-Di, iu përgjigja shpejt, e pastaj më ra ndërmend se duhet ta falënderoj për bujarinë e rëndomtë njerëzore, të vesit që kanë duhanxhinjtë, t’i ofrojnë njëri tjetrit helmin e nikotinës, me të cilën hutohen. E shikova këtë burrë të vogël dhe hallë-lig, të cilit i kishin dalë eshtrat e mëdhenj në fytyrë. Dukej si një siluetë e lenë aty, në gjysmëterrin e ftohtë të asaj nate të ftohtë nëntori, pa pasur si të lodhet, ose pa ditur ta çmojë skutën e vet të mundimit Prej nga vjen? - më pyeti.

- Nga qyteti, - i thash.

- Po për kah je nisur kaq vonë, vazhdoi ta shfaqë kërshtërinë e tij të rëndomtë fshatare, duke menduar se përgjigja ime do t’i takojë si e merituar, për shkak të asaj fije duhani që ma ofroi ta ndez.

-Nuk u nisa vonë natën, i thash, duke dashur ta fsheh atë që kërkonte ai prej meje. Por ja, më zuri nata këtu, duke pritur. Dimrit nata ja beh shpejt dhe pa e pritur fare.

Te ne thonë pleqtë, natën nuk është mirë të



shëtisish, - tha dhe më shikoi dhelpërisht, sikur mu përgjigj me dredhi të pasherr dhe të pakeqe. Kush shetit natën, e ha komatën...

-Po. pëshpërita unë mërzitshëm, duke dashur kështu ta shporr qafe njeriun, që dendur nisi ta zëvendësojë kërshtërinë e tij me dyshimin, që sa vinte i rritej.

-Po e zë, nganjëherë, njeriun, kështu... - vazhdoi ai të flasë, ndonëse mirë e diktonte hutesën time dhe mirë ja qëllonte se nuk më bisedohej. Po ti më the se nuk qenke nisur natën... të zuri këtu. E sigurisht ke nevojë të udhëtosh, ke ndonjë punë me rëndësi.

- Shkoj në vizitë, i thash. Asgjë më të rëndësishme se kjo. Një mik i imi ka kryer shërbimin ushtarak. Sonte kthehet. Kam telegram, i thash, që t’ia zbeh kërshtërinë dhe ta hjek qafe.

- Aha, e di ku shkoke. Në Denjë. Te Berishajt.

-Po.

-Unë jam nga Ratkovci. S’është shumë larg prej Denje, e dini ndoshta. Në Ratkovc ndalet treni, e prej aty të duhet, këmbë gjer në Dejnë, nja një orë e fiuuuuu...

-E di. E di, - i thash.

Fishkëllima e trenit prishi pashinë e natës së ftohtë të nëntorit. Dola në peronin e përbaltur, duke u munduar, me sa mundja, t’i ik pllोकave të baltës dhe të mos i ndyej këpucët. Si duket, fshatari më vinte prapa në hap dhe, duke u zgërdhirë pa të keqe, më tha: »Si i zhyte tash, si më vonë...«

U ulëm në një nga vagonët e klasit së dytë, ai, vetëm pasi zuri vend kundruall meje, në ulëset e vjetra dhe të drunjta të një treni kaherë të vjetruar, i lëshoi duqet e tija para këmbëve dhe u çlirua, sikur të kishte zënë vend buzë oxhaku në odën e tij. E nxori përsëri kutinë e madhe të duhanit dhe, para se ta pshtjellë një për vete, ma ofroi edhe mua.

-Pshtjelle edhe një, më tha.

Më soditi pastaj një copë herë, duke vënë buzën në gaz të çiltërt, duke më soditur se si përpiqesha, me vështirësi, ta pshtjell duhanin.

-Je mësuar me aso të fabrikës, më tha, duke ma ndezur cigaren e posa lidhur me një fije shkrepse.

-Prej nga e njeh Dautin, ti? më pyeti pastaj. -Ishim shokë shkolle, i thashë.

-Mirë besa. Tani i shkoke në vizitë. Do të gëzohet kur të të gjejë, duke e pritur në odë të burrave. Ai do të vijë me trenin e mesnatës, sigurisht.

Po prej nga e di ti, e pyeta.

Hë, prej nga e di unë, po thua. Paj, që e di. Po të gjithë e dinë. Sonte atë e presin edhe miqtë e edhe armiqtë. E di se e di që ai ka shumë armiq. Është në gjak me një familje të madhe në Denjë.

Pastaj zuri të më tregojë se si fëmijë kur ishte, paska ruajtur bashkë me Dautin

dhentë dhe paskan qenë shokë të mirë. E dëgjoja me një vëmendje të cemtë, sepse më kishin rrëmbyer mendime të tjera. Më furfuronin mendime të kobshme mbi këtë pritje, që i bëhej atij prej miqve dhe prej armi qve.

-Rimë sonte, më tha fshatari, te unë, në Ratkovc. Kam blerë çaj të mirë sot në sherr, e do t’ja krisim muhabetit.

-Faleminderit, thash, por unë qeshë nisur për në Dejnë.

-Shkon nesër. E di ai se e presin... tha. Nëpër dritën e të lumes dritë. dhe e la mendimin përgjysmë të pathënë, por unë mirë e kuptova se ku e rrahte thumbin.

- S’është mirë, tha, të udhëtosh natën. I lëshojnë këta fshatarët tonë qentë. Ku të dihet se ç’fsheh gardhi, ku të dihet se ç’të zbulon brryli i rrugës. Bie shi, madje, ftohtë është, e...

-Jo, i thash. S’mund ta pranoj ftesën tënde. Faleminderit shumë për bujarinë që tregon, por më duhet sonte t’i vizitoj në Dejnë, sepse nesër, me agim më duhet të kthehem, kam shumë punë...

-Po... desh të më bindë ai përsëri për rrezikun, që më kanosej, por unë e ndërpreva:

-S’frikohem unë, jo. Shqiptari nuk vret pas shpine.

-Hë, bëri. I paske blerë mendimet e mia. E sa për atë se shqiptari nuk vret pas shpinës, mund të llafosemi edhe pak...

Treni lokal ecte me shumë vështirësi, sikur ta ngrehnin ca qe të lodhur, kurse njerëzit, që hynin duke rraplluar dyert e vagonit, dukeshin të lodhur, të nxirë dhe të përloqur. E shikojta fshatarin, që më rrinte kundruall, duke lidhur një pas një cigaret, të cilat i ndezte edhe për vete, e pastaj edhe për mua, sepse pa që vështirë ia dilja t’i pshtjell vetë. Rrinte disi si i ngrysur, pak i pavendosur në bindjet e tij, që donte të mi ofrojë edhe mua, ashtu të çiltërta siç i ndjente, ashtu të ngrohta siç i ishin dhënë, të rrëmbyera nga shpirt-kthjelltësia e tij prej njeriut të mirë e të çiltërt, që do t’i ndihmojë tjetrit edhe kur nuk e ka këtë gjë me borxh. E pashë se i dukej vështirë të bisedojë me mua mbi atë, për të cilën ishte i bindur se gaboja, por kësaj here nuk donte të flasë, ose i bindur se kuptoja vështirë, ose duke menduar se unë jam i bindur edhe vetë për rrezikun që më kanosej, por e pranoja atë me një vendosmëri te pashoqe, ose, do t’i jetë dukur se kam pasur arsye të fortë që mos t’i shkoj për mysafir.

-Kam dëgjuar prej ju shkollarëve, më tha papritur se Kurani nuk është një libër, që duhet qitur në baltë - dhe pushoi pak, e pastaj sërish më pyeti: A është kështu?

-Po, i thash. Por mos u mundo tani, me ndonjë izme të tij, të më tregosh ndonjë mençuri, sepse... ... sepse, më ndërpreu ai mua, e nisi vetë ta vazhdojë mendimin

tim, sepse hoxhallarët na kanë mësuar aq mbrapsht izmat e tij, sa ato duhen hedhur në baltë.

- Mirë e ke, - i thash.

-Po Kanuni?

- Çka »Kanuni«?, e pyeta unë.

A duhet hedhur në baltë?

-Po, i thash.

Po si ta hedhësh në baltë, kur nuk e ke në dorë, më tha me dredhi. Në kokën e burralecave, vazhdoi, rri, sikur Kurani në kokat e hoxhallarëve. Ta hedhësh në baltë Kanunin, s’mundesh ndryshe, po si hodhe në baltë kokat e burralecave, në të cilat fshihet ai.

- Nuk po të kuptoj, i thash.

-Eeeeece, bëri ai, duke e rrudhur syrin dhe duke pshtjellë edhe një cigare. Po, mirë e kupton ti...

.. në këto anë, vazhdoi të flasë fshatari, shumë kohë më përpara, hakmarrja nuk bëhej sikur sot: edhe pas shpine të shtijnë me armë. Aso kohe, njerëzit kishin dalë në dyluftim, ballë për ballë dhe, cili qe më i zoti... e paska pas bërë të veten. S’them, e as nuk është ta them unë se vlen a s’vlen kjo të luftojë vëllau me vëllanë. Po, ta merr mendja, edhe budalla qofsh, nuk është e mirë dhe rrugë e së drejtës kjo. Mirëpo, prej dy të ligave, njeriu zgjodhi atë që është më pak e ligë, apo jo?

-Po, i thash.

- E qe, kur erdhën muhaxherët, e liga e hakmarrjes u bë edhe më e ligë për ne, edhe më e zezë. Tani s’të merr më plumbi në ballë, po edhe në rruzë të shpinës...

-Po pse the muhaxhirët!

Të thash se, përpara, si më thoshte gjyshi, njerëzit tanë, në këto anë, kur kishin punuar ditën nëpër ara, natën kur ktheheshin të pushojnë, nuk i merrnin plugjet e veglat e tjera në shtëpi, po i lenin nëpër ara, sepse askush nuk i merrte. Me ardhjen e muhaxherëve, plugjet që mbeteshin natën në arë, të nesërmen nuk mund t’i gjeje. U prish edhe besa, pastaj, edhe kjo, të kërcasë pushka pas shpine. Sot s’bën, o mik, t’u besosh skutave brrylave të rrugëve në terr. Të mori e liga...

Më në fund, treni u ndal në stacionin e vockël të Ratkovcit dhe prej tij nuk zbriti askush tjetër pos meje dhe fshatarit, me të cilin bisedoja. Pas pak u gjetëm përsëri në terrin e rrugës së përloqur të fshatit, të rrahur nga shiu që tani ia kishte lëshuar sikur me rrëshekë. Ndonëse i ngarkuar me duqet, që i mbante në shpinë, ai ia dilte në krye t*i* kapërcejë lehtë pengesat në rrugën e lagur shumë dhe, herë pas here, ndalej të më presë gjersa t’i afrohem.

- Po kështu, qe besa, më tha duke qeshur, ti s’do të mbërrish as gjer nesër atje në Dejnë. Po rrimë sonte këtu... bukë e...

-Falemnderit... do të mbërrij unë atje. Në mos për dy, atëherë për tri orë po se po...

- Erdha pra, e po të përcjell.

-Jo, i thash. Shkoj unë. S’është aq punë e madhe kjo. Faleminderit për duhan... Në brrylin e rrugës, që shpiente për në Dejnë, ai u ndal dhe më shikoi nëpër terr, thuase nuk më kishte parë gjatë tërë udhëtimit. Ma shtrëngoi dorën dhe më tha: E, ju shkollarët, ndoshta dikur... dhe e la fjalën përgjysmë e u nisë sikur t’i vinte keq pse ndaheshim, ose sikur të ishte i bindur se krejt kjo bisedë me mua dhe takimi me të nuk kishte qenë asgjë më shumë se një ëndërr e gjatë dhe pak e çuditshme. Ose, ndoshta do të ketë dyshuar se kurrë më nuk do të takoheshim përsëri... dhe, i rënduar nga kjo bindje, do të ketë shkuar aq i hutuar, pa më thënë as natën e mirë. U nisa i shtypur nga mendimet që m’i shkaktoi biseda me fshatarin e urtë nga Ratkovci. Vallë, a do të ketë pasur të drejtë që frikohej, mendova vetëm tani, kur çdo përgjigje që i jepja vetes ishte e pavlerë dhe e pamundur të më nevojitet. Ishte vonë të kthehesha dhe ishte turp të tregohesha kaq i pavendosur, por posa mbeta vetëm në terrin u dendur të rrugës dhe në shiun e ftohtë, që menjëherë m’i lagu teshat,

pash se më parë nuk frikohesha, meqë isha me njerëz, me fshatarin, ose pse nuk kisha pasur kohë të mendoj më shumë lidhur me atë që fliste ai. “Gjakësorët sonte e presin Dautin, mendova. E dinë se kthehet sonte dhe, posa të më dallojnë në terr, pa ditur mirë se cili është udhëtari, ose posa të shohin se ai është veshur me tesha qyteti, do ta dinë se është Dauti, sepse edhe ai vishej kështu, si unë. Dhe do të shtinë...”! Ndoshta u pendova pse nuk mbeta sonte të buj në Ratkovc, te fshatari që më ftoi me aq dëshirë, ose ndoshta kështu mendoja i shtyrë nga frika që më bëri të dal lëkure. Ndoshta nuk frikohesha fare, ndoshta vetëm mendoja keq dhe kobshëm, sepse vetëm pasi ka kaluar çdo gjë, m’është kujtuar se nuk kam menduar fare për vdekjen. Disi, më është dukur shumë e largët, sa as mendjen nuk ma ka rrëmbyer, disi si diçka, që më shumë është shkak, se sa e vërtetë. E vërtetë ishte vetëm ajo se unë shkoja rrugës së errët të fshatit, i pambrojtur, pa asnjë brisk të vogël në xhep, i pafuqi dhe krejt i vetëm.

Ose, jo: nuk ndjehesha i vetmuar. Më

kishin rrëmbyer aq shumë bindjet e fshatarit nga Ratkovci, sa disi çuditshëm e ndjeja praninë e njerëzve në pusi, gjithkah rreth meje, çdo lëvizje e dëllinjave në storn të rrugës, ishte frymëmarrje njeriu që pret me pushkë në dorë, çdo bërryl rruge fshihte prapë një njeri tjetër, i cili, qe, posa t’i afrohesha, ikte diku, fshihej, sikur ta lëshonte toka. Kisha harruar qëllimin e atij njeriu, e ma kishte mbushur kërshërinë vetëm prania e tij. Prania e tij pak edhe më trimëronte: nuk isha vetëm, ai ishte afër, kurse çdo gjë që do ta bënte ai, ishte diçka më e largët, diçka e pamundur të ndodhet kaq shpejt, kaq e papritur. Ndjenja e pafajësisë më bënte të tillë, të çliruar nga paragjykimet, por mendimi ishte nganjëherë si rrufeja, që vret në kthjelltësi verore: ai më jepej rrëmbimthi, duke më bindur se s’pyet kush për krejt ndjenjën time të pafajësisë, se ai që nuk pyet, shpejt do të përgjigjet me tytën e me kërcimën, por edhe kjo kishte akoma kohë të ndodhte shpejtë. E ndjejnë, vallë. veten të gjithë ata që i pret kërcima prapa spine, kështu si ndjehem unë?, e pyesja veten, por

kurrë nuk arrija ta pres përgjigjen as prej vetvetes. Më shumë doja të di se sa do të më trimëronte, po të kisha me vete diçka që kërcet, në mos këtë që kërcet, sikur së paku të kisha ndonjë thikë, ndonjë hu, çfarëdo qoftë, e pastaj, shpejt, përnjëherë turpërohesha nga vetja pse dëshiroja kështu, më kujtoheshin fjalët e arsimitarit tim, dhjetë dymbëdhjetë vjet të thëna, para kësaj që po ndodh, më kujtohet si thoshte ai se njeriu nuk duhet të mbajë me vete asgjë që vret tjetrin, si njeriu i qytetëruar dhe i kulturuar nuk dëshiron t’i frikohet askush, se vetëm kafshës duhet t’i frikohet njeriu, se njeriu, prej të cilit frikohet njeriu, është sikur kafsha, dhe, kështu shthurur, çdo gjë më jepej parasysh, fët, më përfytyrohet, pastaj zhduket sa çel e mëshel sytë, më rrëmbejnë mendimet që inkurajojnë, pas tyre përsëri frika, pas frikës përsëri bindja se nuk jam vetëm, pas kësaj bindjeje se nuk zam vetëm, bindja tjetër se, ata që nuk më lënë vetëm, kanë qëllim të qartë të... Kur u ula afër votrës, të nxehem aty në odën e Berishajve, ata panë se isha zverdhur krejt dhe se dridhesha si purtekë. (1972)

Pikëpamje

ÇMIMI I LIBRIT

Në kulturën shqiptare këtu ende nuk është bërë profilizimi i ideve dhe koncepteve. Faza e profilizimit, e filluar me krijuesit që lidheshin me traditën kulturore e jo atë klasore, pushoi me funksionimin e shtetit përmes institucioneve të veta edhe brenda kulturës

Ramadan MUSLIU

Në kulturën shqiptare iluminizmi përbën një nga nocionet shumë të rëndësishme. Arsyeja kryesore pse iluminizmit dhe librit si artefakt kulturor i kushtohet rëndësi tepër e madhe, rrjedh nga fakti se gjithë historia nacionale e tyre është histori kulturore, ku libri pos që ka vlerën e një dokumenti artistik, është edhe histori e kontinuitetit nacional. S’është e rastit pse kultura shqiptare sot paraqitet si një amalgamë e pandashme e traditës së përbërë nga shtresa të ndryshme heterogjene, që për kulturat e tjera do të ishin përjashtuese për njëra-tjetrën. Asnjë shqiptar sot nuk ka kurrfarë rezerve ndaj traditës iluministe të proviniençës katolike, ortodokse apo muslimane, sepse që të tri këto tradita në vete përmbajnë atë ekstraktin nacional, që traditën nacionale e bën të identifikueshme dhe, si të tillë, edhe kontinuitive. Nuk është aspak e rastit pse monografinë më të rëndësishme për veprën dhe jetën e Pjetër Bogdanit e shkruan Ibrahim Rugova, pse dramën me tematikë nga jeta e këtij kolosi të kulturës dhe traditës ekleziastike do ta shkruajë Teki Dervishi etj. Një traditë e këtyllë e të çmuarit të librit, që gati shkon deri në fetishizim, siç thonë edhe M. Horkhajmer dhe T. Adorno, të përmbajë në vete edhe atë paradoksin e njohur: mungesën e qëndrimit kritik ndaj vetë këtij fenomeni. Mungesa e qëndrimit kritik ndaj fenomenit, sjell gërshetimin e kriterëve dhe ngatërrimin e tyre. Kështu, kriteri kualitativ identifikohet përmes dukurisë së kuantifikimit dhe anasjelltas. Ky paradoks i sjell kulturës fenomenin e simplifikimit të saj dhe kësisoj kultura privohet nga elita. Privimi nga elita i sjell asaj cilësimin e oficielitetit. Dihet se çdo kulturë oficiele përfundon në kulturë të regjimit ose në skajshmërinë tjetër, në akademizmin dogmatik, që është gjithashtu produkt i regjimit të caktuar. Faza e tranzicionit, që sot po e përjetojnë shqiptarët e që shprehet në dy nivele (në atë nacional dhe ideologjik), solli edhe nevojën e konvertimit dhe të transformimit të interesave. Shumica sot harrojnë se secili sistem dhe formacion shoqëror mbështetet në institucionet e veta. Prandaj, institucionet e kulturës, duke filluar që nga Akademia e deri te asociacionet profesionale, kanë

fizionominë e funksionin e sisternit. Steriliteti i institucioneve është rezultat pikërisht i shkallës së funksionimit brenda sistemit. Nga kjo rrjedh se asnjë institucion kulturor e shkencor nuk i solli shqiptarëve ekspertin e ndonjë lëmie. Mirëpo këtu qëndron edhe paradoksi: institucionet kulturore me ndihmën e shtetit promovuan autoritetet, të cilat çdo lëkundje tektonike e sistemit mund t’i detronizojë. Nuk është për t’u habitur me insistimet e disa intelektualëve tanë që, pas rrëzimit të sistemit, të kapen me

“kashtën” nacionale të shpëtimit, duke harruar se për validitetin e autoritetit të tyre do të flasë vepra: libri dhe rezultatet e tyre në art dhe shkencë. Çdo gjë tjetër është e parëndësishme, sepse fama u erdhi me pushtetin dhe ikën me të. Vetëdija se intelektual i mund të bie në nivelin e një shërbëtori të regjimit, nxiti iniciativën qëllimmirë të disa intelektualëve shqiptarë, që t’i përvishen punës për konstituimin e një akademie të re ekskluzivisht nacionale. Pozicioni dhe statusi i tyre shoqëror bëri që edhe



institucioni i posafilluar të dështojë me një demaskim publik të fushatës provinciale. Çfarë ishte pozicioni intelektual në shoqëri i themeluesve të tillë, ishte edhe statusi i këtij institucioni. Pas dështimit të iniciativës akademiste, skenën kulturore e vërshoi shundi i ri: vlerat diletante, që promovohen nën maskën e patriotizmit. Këto vlera surrogate, zakonisht, iniciohen nga ambicia e disa individëve që mëtojnë të promovohen si botues përmes veprave që e kanë pedigrenë e autorit. Pas shumë botimeve që fare s’ vlejnë të përmenden, ilustrativ është botimi “Libri i lirisë” i pesë autorëve, për ndryshe, të burgosur politikë. Ajo pedigrea e personalitetit simplifikohet në titullin pretencioz, duke harruar se libri i lirisë shkruhet përmes artit të mirëfilltë, i cili nuk ka lidhje me statusin qytetar të autorit. Shembull më i mirë për këtë është vepra e Kadaresë, që ishte shkrimtar i regjimit, por që dha vepra të klasit të parë. Pesë autorë mbulohen me një titull, duke abstraguar faktin se libri është artefakt me jetë më të gjatë e jo vetëm brenda dite. Nga të pesë autorët nuk mund të promovohet as vlera e poezive, sepse zgjedhja është e paktë, as mund të shihet individualiteti krijues i tyre, as preokupimet. Qenia e krijuesit nuk mund të simplifikohet vetëm brenda një dimensionit: të angazhimit shoqëror. E tash: ku është libri? Cila është vlera e librit? Ai koncepti iluminist rishtaskthehet, por kësaj radhe me petkun romantik. Në kulturën shqiptare këtu ende nuk është bërë profilizimi i ideve dhe koncepteve. Faza e profilizimit, e filluar me krijuesit që lidheshin me traditën kulturore e jo atë klasore, pushoi me funksionimin e shtetit përmes institucioneve të veta edhe brenda kulturës.

A mjafton sot të kesh mjete materiale dhe të botosh librin? Është gjë që dihet se këtë s’mund ta bëjë asnjë krijues, që s’i ka takuar konjukturave të pushtetit. Shkrimtarët dhe, përgjithësisht, artisti shqiptar i shtetit nacional ikën nga historia. Artistët shqiptarë të Kosovës vrapojnë nga historia, sepse historia e tyre është histori e kulturës. Këtu vihet ajo shenja e barazimit. Në fund do thënë se, në domenin e historisë, me relevancë është akti historik, e në lëmin e kulturës artefaktet artistike e, ndër ta, edhe libri. (1992)

Simbologji

HËNA

Besimi i lashtë popullor e njeh mirë ndikimin e fazave hënore mbi ngjarjet tokësore; ai nuk shkakton vetëm baticat, por edhe rritjen dhe zvogëlimin e rrjedhjes së limfës tek bimët



Zija VUKAJ

Hëna në simbologji, së bashku me diellin, është ndër më të rëndësishmit e yjeve. Kryesisht është parë si figurë “femërore”, për shembull, në ideogramën yin, ku është një trup qiellor që e merr dritën në mënyrë pasive, por edhe për analogji mes muajit hënor dhe ciklit të menstruacioneve femërore. Rritja dhe ndryshimi, ashtu si përtëritja e përhershme e figurës së re, është një simbol që përmbledh çdo ide që i përgjigjet konceptit “vdis dhe bëhu”. Rrallëherë hëna është parë në formë mashkullore, siç ndodh në përdorimin gjuhësor gjerman (Mani, vëllai i Sol, gjermanishte jugore Suna- Diell), ndërsa shumë më shpesh është interpretuar si femërore (lat. Luna; gr. Selene apo Artemida; lindje e largët Kuan-yin, Kwannon; Maya: Ixchel). Në simbologjinë alkimike hëna paraqet argjendin, por edhe mbretëreshën që martohet me “mbretin” duke u bërë hermafrodit (deledash). Besimi i lashtë popullor e njeh mirë ndikimin e fazave hënore mbi ngjarjet tokësore; ai nuk shkakton vetëm baticat, por edhe rritjen dhe zvogëlimin e rrjedhjes së limfës tek bimët. Sipas këtij koncepti edhe prerja e flokëve dhe praktika e heqjes së gjakut duhen bërë duke marrë parasysh fazat hënore. Për qetësimin e dhimbjeve menstruale përdorëshin bimë hënore (që lulëzonin natën). Në ikonografinë kristiane virgjëresha Mari krahasohej shpesh me Hënën ose e paraqitur në këmbë apo e ulur në fron mbi draprin e Hënës; kështu, në botën austriake, është lidhur kryesisht me fitoren mbi turqit (flamuri i të cilëve përbëhej nga gjysmëhëna), edhe pse e ka zanafillën te Apokalipsi i Gjonit (12, 1: një grua e veshur me Diell, me Hënën nën këmbë- simbol i fitores mbi forcat armike). Si simbol hënor është paraqitur në mënyra të ndryshme

edhe sëpata dytehëshe, latusha me dy teha të lakuar në formën e Hënës dhe për këtë është cilësuar si arma e Amazonave, gratë luftëtare legjendare të antikitetit; përveç kësaj, ato kishin edhe një hark në formën e draprit hënor. Edhe perëndesha e errët Hekata Troidite, “ajo që ka tri fytyra”, është e lidhur me fazat hënore (hënë vajzë, hënë e plotë, hënë e errët apo e re); në letërsinë moderne femërore i është kushtuar vëmendje e madhe “pjesës hënore” të burrit.Sisteme dualistike; lart-poshtë; bosht. Në legjendat hebraike (J. Bin Gorion 1980, Bibl. 24) ka një mit simbolik që bazohet mbi sistemin dualistik Diell/ Hënë dhe është i caktuar të shpjegojë arsyen pse Hëna, njëra nga dy “llambat”, lëshon një dritë më të dobët. Krijuesi i shpjegon Hënës që janë dy pjesë: këndej dhe andej dhe se ekzistenca e dy dritave çon në këtë polarizim. Hëna, së cilës i është dhënë hapësira më e madhe e andej-it, është e pakënaqur që s’mund ta kalojë me ndriçimin e saj Diellin. “E Zoti tha: ‘Vërtet, ti deshe që unë të të bëja të madhe, duke zvogëluar Diellin. Por,mbasi ke qëllime të liga ndaj tij, ti do të jesh më e vogla dhe ndriçimi yt gjashtëdhjetë herë më poshtë se i tij!’ Dhe Hëna tha përpara Zotit: ‘O Zot i Botës! Kam thënë vetëm një fjalë dhe duhet të ndëshkohem kaq ashpër?’ Dhe Zoti tha: ‘Një ditë (pra, me gjasë, pas Gjykimit) do të bëhesh e madhe si Dielli dhe drita e Hënës do të jetë e barabartë me atë të diellit.” Megjithatë, shenja e Gjykimit Universal (fundit i botës) është errësimi i Hënës (Gioele 4, 15). Hëna është pranuar jo vetëm me pjesën e natës së botës e me botën e pëртеjme por- shumë shpesh- edhe në Izrael, me feminilitetin dhe kjo anologji e qartë e ciklit menstrual me fazat e Hënës, duket edhe nga lidhja e saj me fushën semantike të “pjellorisë”. Gra dhe kafshë shtëpiake (deveja) mbanin në qafë hëna të vogla si zbukurim.

Apologjeti grek, Teofili i Antiokisë (shek. II pas Krishtit), i shihte Diellin dhe Hënën si simbole dualistike, “përçues dhe pamje të një misteri të madh.Në fakt, dielli është imazhi i Zotit, kurse Hëna imazhi i njeriut” (që e merr dritën nga Dielli).Në një kuptim të ngjashëm simbolik Origjeni (184- 254) e interpretonte perceptueshmërinë e dritës nga ana e Hënës si imazhi i Kishës, që përcjell për një sekondë ndriçimin tek të gjithë besimtarët. Njëvlefshmëria simbolike e përsëritjes së vizionit të “lindjes së re” të Hënës me rilindjen, këtu është e qartë. Në Perunë e lashtë, nderimi i thellë i Hënës ishte i varur nga ai i Diellit sundues. Inkasi Garcilaso de la Vega (1539- 1616), e quan Hënën “gruaja e Diellit” dhe shkruan se brendësia e tempullit kishte qenë e mbuluar me pllaka argjendi «me qëllim që nga e bardha të merrej vesh se bëhej fjalë për dhomën e Hënës. Si në rastin e Diellit, aty ndodhej një portret i realizuar në formën e fytyrës së një gruaje mbi një lingotë të trashë argjendi. Hyhej në këtë dhomë për të kërkuar Hënën dhe për t’i besuar mbrojtjes së saj, mbasi mbahej motra dhe gruaja e Diellit, si dhe nëna e inkasve dhe e gjithë fisit të tyre; prandaj e quanin Mamakuila, që do të thotë “nëna Hënë”. Nuk i sakrifikoreshin asaj si Diellit. Nga të dy anët e figurës së Hënës qëndronin trupat e mbretëreshave të vdekura, vendosur sipas rendit të ardhjes në fron dhe sipas moshës...» Në astrologji, si në sistemin gjeocentrik të antikitetit, sateliti i tokës bën gjithnjë akoma punën e “planetit” dhe, së bashku me Diellin, është një nga dy “dritat kryesore”. Është trupi qiellor më i afërt i tokës dhe i shfaq përherë të njëjtën“fytyrë”, gjë që është bërë origjina e shumë legjendave. Mbi bazën e ndryshimeve të fazave të saj, në astrologji ajo është konsideruar “e ndryshueshme, nga efekti kalimtar”, por edhe “bamirëse”

(benefactor); për arsye se “planeti femëror”, ndikon mbi shpirtin, seksin femëror, nënat dhe gjithë popullsinë. Në shenjën e zodiakut është e lidhur me demin (për shkak të brirëve të kafshës, që të kujtojnë draprin hënor apo për shkak të martesave mitike të perëndeshave hënore me një partner mashkull në formën e demit). Astrologjia më e re i mvesh Hënës cilësinë e administrimit te gruaja të personalitetit të jashtëm e te burri personin e thellë. Antikiteti fliste ndër të tjera, për Luna mendax ose Hëna e rreme, për arsye se vargu i fazave paraqet një ngjashmëri me shkronjën C (crescere) e D (decrescere), gjë që, megjithatë, është në kundërshtim me atë çfarë tregon ndryshimi i figurës në draprin e Hënës. Në bazë të dhënies së kuptimit simbolik janë përcaktuar “gurët hënorë”, perlat, opali, seleniti dhe gjerdanët e sedefit; metali i saj përgjegjës është argjendi. Që Hëna nuk është vetëm një “vend simbolik” i rajoneve qiellore, me të gjitha vlerat e saj poetike, por është pushtuar nga njeriu, për astrologjinë nuk do të thotë asgjë; dhe kjo në cakun e shëmbëllimit të universit drejtuar mbi njeriun, për të cilin planetet “tradicionale” kanë ruajtur domethënien e tyre përcaktuese nga këndvështrimi sombolik. Ikonografikisht, Hëna është paraqitur më së shumti si një drapër, me profil të drejtuar nga e majta.Megjithatë, drapërat hënorë shfaqen në emblemat kombëtare të shumë vendeve islamike. Böckler interpretoi imazhet heraldike të hënës, duke kujtuar faktin se njëqind këshilltarët e Romulit mbanin mbi këpucë një gjysmëhënë në formë C-je “për të treguar se shkelnin çdo gjë që ndodhej poshtë Hënës, se toka është e zbrazët apo që kështu të njiheshin përballë të tjerëve si këshilltarë. Ata fisnikë që mbanin Hënën që tregon rritje, mbi emblemat e tyre, ndoshta e kanë marrë dikur nga turqit”.

Roman

APOKALIPSI I BOTËS SHQIPTARE

Konflikti që shfaqet mes të gjallëve dhe të ringjallurve është gjetje e qëlluar e shkrimtarit për të t’i dhënë përmasat e shqetësuese të degradimit njerëzor

Zyrafete SHALA

Romani i Zija Çelës, Apokalipsi sipas Shën Tiranës, i botuar nga Toena në prag të vitit 2012, sjell tek lexuesi shqiptar një version të veçantë të apokalipsit, i cili nuk ka të bëjë me fundin e botës për të cilin është shkruar dhe folur shumë, e që sipas disa profecive përkonte me 2012 - ën. Apokalipsi i Zija Çelës përmes ndërthurjeve me të gjitha sferat e realitetit shqiptar, mes të kaluarës dhe rrëfimeve të librave të shenjtë, krijon një shëmbëllim të absurditetit e shkatërrimit moral, politik, kulturor, historik e social në vorbullën e të cilit tash sa vjet po rrotullohet bota shqiptare, pa arritur ende të gjejë rrugëdaljen nga labirinti ku ndodhet. Përmes një fabule ku kryqëzohen rrugët, fatet dhe veprimet e njerëzve të gjallë e të vdekur, ku bota reale dhe përtej bota tejkalojnë çdo barrierë dhe komunikojnë lirshëm, shpalosen ngjarje të ndryshme nga përditshmëria, çaste të bukura e të hidhura që i përvijojnë konturat e këtij romani, në hyrje të të cilit shkrimtari bën një pakt me lexuesin, duke i dhënë mundësinë e zgjedhjes së një titulli tjetër, që tremb më pak. Romani ndahet në 24 kapituj dhe secilit prej tyre i është vënë nga një emër që ndërlidhet me përmbajtjen e tij, Kreu i Dasmës është ai që e hap romanin ndërsa Kreu i Mohimit e mbyll atë. Duke e përcjell narratorin në rrugë- timin e tij nëpër kryeqytetin shqiptar, lexuesi arrin të njohë për së afërmi strukturën e shoqërisë, mekanizmat e funksionimit të saj dhe të gjitha hallkat e jetës dhe aktualitetit. Në kërkim të arsyeve që sollën në atë shkallë të degradimit, shkrimtari nisat nga e keqja brenda familjes, si qelizë e shoqërisë, për të vazhduar më tej me përmasa më të gjera, ku hap pas hapi zbulohen vatra gjithnjë e më të mëdha nga të cilat vjen e stërkeqja e përgjithshme. Kështu, tragjedia që zë fill në familjen Hoti, ku rrënohen kufijtë mes dasmës dhe mortit, për t’u zgjeruar më tej në fafesisin e tyre dhe në fund kjo bëhet pikënisje e tragjedisë që përfshinë tërë kryeqytetin, ku brenda natës tragjike gjejnë vdekjen 173 të rinj. Deri këtu rrjedha e ngjarjeve përcjellë ritmin e ligjeve të botës reale, ngjarje të tilla ndodhin kudo dhe njerëzit janë të pafuqishëm për t’i penguar ato, mirëpo, shqiptarët nuk duan t’u nënshtrohen ligjeve që vlejnë për të gjithë njerëzit, ata nisin të protestojnë kundër Zotit, bëjnë grevë urie dhe përgatisin ultimatum përmes të cilit kërkojnë që Zoti t’ua kthejë të gjithë të vdekurit.



Këtu zë fill edhe hapi i parë i absurditetit, por edhe aluzioni për popullin që dekada të tëra i ishte nënshtuar një diktatori - njeri, ndërsa tani ngre krye kundër urdhrave të perëndisë!! Kjo këmbëngulje sjell si rezultat përmbushjen e kërkesës dhe ringjalljen e të vdekurve. Ringjallja, apo ardhja nga përtej bota nuk është motiv i ri as në letërsinë shqipe, e as në atë botërore, ai zë fill që nga baladat e lashta, ku të vdekurit ngrihen nga varri për të çuar në vend fjalën e dhënë, pengun që nuk i lë të bëjnë gjumin e amshueshëm, apo ngrihen edhe për të thënë të vërtetën, atë të vërtetë që nuk mund ta gjejnë të gjallët pa ndihmën e tyre. Dihet se në shkrimet e shenjta ringjallja e të vdekurve lidhet me fundin e kësaj bote, me apokiametin, siç e quan shkrimtari, apo me Ditën e Gjykimit. Por, vdekagjallëve të Zija Çelës që nuk kanë dhënë premtime dhe nuk kanë lënë detyra të papërfunduara, shqetësimi dhe nevoja e kthimit u vjen nga të gjallët. Rivlerësimi i figurave të së kaluarës që ka marrë hov vitet e fundit

është një ngacmim i tillë. Trillimet, fajësimet e manipulimet me emrin dhe veprën e atyre që nuk rrojnë më, shtrojnë domosdoshmërinë dhe nevojën e sqarimit të çështjeve, apo siç thotë një personazh “po të flisnin të vdekurit, s’do të gjendej magazinë për të palarat tona, të gjitha do të dilnin në shesh, edhe krimet shtetërore”. Pritja e të ringjallurve me organizim koncertesh e spektaklesh, që më pas zëvendësohet me shpërfillje dhe në fund me refuzim dhe urrejtje, tregon më së miri për mënyrën euforike të përjetimit të gjërave që e karakterizon popullin shqiptar. Këmbëngulin për të arritur një ndryshim dhe sapo realizohet ai synim përsëri janë të pakënaqur, luftojnë kundër një pushteti skllavërues dhe sapo e shembin atë, më të zëshmit e kësaj lufte kthehen në skllavërues, e përjetojnë me eufori shembjen e sistemit totalitar, por në momentet e zhgënjimit edhe mund ta kërkojnë atë. I dëshpëruar nga veprimet e bashkëkombësve autori gërmon

në thellësitë e natyrës njerëzore, i kthehet gjenezës, ashtu siç e përshkruajnë librat e shenjtë, Kur’ani dhe Bibla, por krahas saj e shqyrton edhe konfliktin kozmogonik (Zot dhe Djall), mëkatin që njeriun e dëboi nga parajsja dhe e shndërroi nga të përjetshëm në të përkohshëm, për të vazhduar kërkimin edhe tek fundi i botës dhe ringjallja. Meqë sipas shkrimeve të shenjta ringjallja ndodh pas apokalipsit, apo pas shkatërrimit të botës, atëherë “fenomeni i shfaqur i ringjalljes, që e gjejmë në këtë roman, del të jetë një bastardim i Ringjalljes teologjike dhe si i tillë, nuk është punë e Zotit por e Djallit”. Një sugjerim tjetër sjell në përfundimin se më kot pritej apokalipsi, ai tanimë kishte ndodhur dhe kjo argumentohet me degradimin e njeriu, apo me shfaqjen e njeriu hipokrit. Aq i shpërfytyruar shfaqet njeriu i kohës sonë, aq shumë ka devijuar nga natyra e tij, sa doemos të çon para dilemës se mos është fjala për ndonjë ndërhyrje klonimi nga ana e alienëve. Personazhi që shfaqet si alter ego e autorit, Mark Pali, jo vetëm që i vëzhgon dhe regjistron të gjitha ndodhitë, por i përjeton me shqetësim ato. Të ringjallurit krijojnë parti politike dhe kërkojnë të drejta të barabarta me të gjallët. Hapet Instituti për Higjienizimin Human që lehtëson rrugën e korrupsionit, mitmarrjes, vrasjeve me pagesë, krijimin e kultit të parasë, materializimin e ndjenjave njerëzore, që simbolizohet me tregun e Esencave ku shiteshin e bliheshin: trishtimi, melankolia, lumturia e dhembshuria, virtyte humane që kishin humbur kaheerë. As dashuria më nuk ishte si atëherë kur ajo krahasohej me gjakun, lëngun e jetës, tani edhe ajo shitej e blihej me para. Kopraci hiqej si bujar, hajni si evlija, bukëshkali si besnik, imorali predikonte moral, femohuesit binin në gjunjë në kisha dhe xhamia. Konflikti që shfaqet mes të gjallëve dhe të ringjallurve është gjetje e qëlluar e shkrimtarit për të t’i dhënë përmasat e shqetësuese të degradimit njerëzor. Të ringjallurit nuk dëshirojnë pushtetin, përkundrazi duan të mbeten opozitë e përhershme parlamentare, që synojnë t’i detyrojnë partitë politike të kujtohen për trashëgiminë e mendimit dhe të praktikave të sjelljes së njerëzimit, si pasuri botërore më e çmuar. Natyrisht që një përmbysje e tillë e botës përjetohet rëndë nga ata pak njerëz që i kanë shpëtuar molepsjes dhe derisa të tjerët janë kapluar nga shfrenimi, kjo specie rrezikon të zhduket në pamundësi të ndryshimit të gjendjes. (2012)

Qasje

VËLLIM POETIK ME DENDËSI FIGURACIONI

Mbi vëllimin me poezi të Xhevat Muqakut – “Orë e (v)arkës në liqenin e kaltër”, botoi “Armagedoni”, Prishtinë 2021

Sadik KRASNIQI

Vëllimi i katërt me poezi, “Orë e (v)arkës në liqenin e kaltër”, i poetit Xhevat Muqaku, është kontinuitet i librit pararendës “Bërthama e fjalës”, ndërsa të dy këta libra krijojnë një diskontinuitet me dy librat e tij të mëparshëm. Një konstatim i tillë dallues mes dy librave të fundit nga ata të mëparshmit, rezulton më tepër në figurshmërinë e tyre poetike dhe strukturën e ligjërimit lirik, sesa në atë tematiko-motivor. Vëllimi “Orë e (v)arkës në liqenin e kaltër” karakterizon shestimën e poetit për ta begatuar të shprehurit lirik me një poetikë me sa më shumë figurshmëri. Lirisht mund të themi se këtë intencionalitet Muqaku e arrin me sukses. Synimi i poetit për permanencë figurative vërehet që në titullin e librit, sidomos në sintagmën e parë të tij: orë e (v)arkës. Ora paraqet një dykuptimësi: ora si mjet i matjes së kohës, por edhe si figurë e mitologjisë orale i Orës (zanë) me misionin ruajtës e shpëtues, ndërsa (v)arka shquhet për ambiguitetin semantik: mjet lundrimi dhe simbol biblik i arkës shpëtuese të Noes gjatë përmbytjes së madhe.

Vëllimi nis me një qasje diskursive për idenë iniciale të krijimit, përmes lutjes së muzës dhe nxitjes së zekthit deri te finalizimi i tij. Kjo arrihet në saje të “rrezatimit të Hijes, Vlerës, Zanës e Kreshnikut”. Edhe pse këtë diskursivitet mbi mënyrën e ardhjes së librit e shquan një konjitivitet bisedimor, “Bre lut muzën e nxit zekthin, hajt se jua dua shumë vetëm të bëjmë një brumë gati për gatim”, hasim një ambivalencë emrash, si: hije, vlerë, zanë e kreshnik, që mund të jenë emra konkretë të të afërmve (me të cilët konsultohet rreth librit) e, njëkohësisht, janë edhe konotacione poetike. Përmbajtja e librit konstruktohet përmes tri cikleve poetike: “Aromë e ankthit tim”,

“Orë e zhdeshtjes” dhe “Derisa t’i përtërij grafitet”. Që në emërimin e cikleve të këtij libri vërehet intenca e poetit drejt abstraksionit metaforik: në ciklin e parë dhe të dytë dhe të diskursivitetit në ciklin e tretë. Cikli i parë, “Aromë e ankthit tim”, është tejet personal, në të cilin heroi lirik shfaq raportin emocional me më të dashurit e tij të afërsisë familjare.

Empatia për pjesën e zemrës, siç thotë poeti, shfaqet përmes një figuracioni shumë të dendur epitetesh, si: thesar florinjsh, engjëj të bardhë, shqiponjë e qëndisur, park diellor, gravitet i dashurisë, ngjyrat e luleve, adrenalinë e yjeve, dritë polare, yll vere, fytyrë hyji, gojë e artë, farë e artë etj. Në këtë cikël poetik, përveç reflektimeve me një emocionalitet solemn, hasim edhe evokativën për njerëzit që tashmë janë bërë kujtime, ose siç thotë poeti, “dritëhije për jetë e mot”. Evokativja në këtë cikël nuk është një lament i zëshëm, por një ndjenjë e ndrydhur në emocionalitet racional, që është karakteristikë e një intelektualizimi përjetues ndaj këtyre dukurive, që përkon me mendimin e Robert Frostit, se poezia është emocion, ka gjetur mendimin e mendimi ka gjetur fjalën.

“Orë e zhdeshtjes” është cikli i dytë i librit, ku objekti lirik subjektivizohet me anë të një të shprehuri të përsqajshëm abstrakt, përmes një malgame figurshmërie. Vetë titujt e disa poezive, si: Gjurmë e formës dhe e hijes, Skulpturë uji, Në orët e dremitjes, Orë e zhdeshtjes, Në orët e yjeve, Në errësirën lakuriqe, Dorëshkrim i mjaltuem, Orë e shkopsitjes, janë sintagma të metaforave kontekstuale me një kontemplacion të thellë.

Intencionaliteti këmbëngulës i poetit, që narracioni lirik i tij të jetë sa më abstrakt, “relativizon semantikën e shumë poezive, siç do të thoshte kritiku i shquar Ramadan Musliu. Ndaj disa poezi në këtë libër e zbehin kontinuitetin kuptimor brenda rrëfimit.

Për receipientin shpesh errësohet perceptimi integral i shumë poezive dhe se, nëse shprehemi figurativisht, shumë poezi janë si “pacienti”, të cilit i merret me shumë vështirësi gjaku për analizë, jo se nuk ka mjaftueshëm gjak, por mezi i gjendet damari, prej të cilit duhet të merret gjaku. Në këtë cikël poetik motivet e imazheve emocionale e intelektuale subjektivizohen, pra bëhen alterego e poetit. Shumë poezi shfaqin shndërrimin e idesë lirike në përbrendësinë e subjektit lirik. Ja si shprehet poeti.

Të ndjeva brendapërbrenda si diçka të ngjashme
Ndërmjet trajtës së paqëndrueshme dhe identitetit. (f. 49)

Në këtë cikël poeti figurshmërinë e ligjërimit poetik e përzgjeron në sentencë metaforike, duke krijuar inversion semantik:

Gjurmët i dhuruan hije të mirë
Hënës, qiellit të alpeve tona
Çasti kur gjahu vrau gjuetarin. (f. 54)

Në ciklin “Orë e zhdeshtjes” kemi gëlim metaforash kontekstuale (personale), si shpirti i trembur, pëlhurë e djegur, brumë i lig, portë e durimit, bardhësi e lënduar, litar e enigmës, aurë polare, përkundje e ëndrrës, flakë e hipnozës, etje e ëndrrës, dritë e ëmbël, koronë e mjerë, fluturim shpirti, parashutë e përflakur etj. Intenca e poetit për një ligjërim lirik me dendësi figurshmërie sikur ia imponon aplikimin e simboleve dhe të metaforave konvencionale, si: guri i nxehtë, shqiponjë e qëndisur, duvak i kuq, qersh i mbi tortë, fllad i lehtë, valë e jetës, fjollë e dëborës, zëri i zanës, leshi i arapit, shiu sixhim, çastet e ëmbla, thes i shqyer, lot i ngrohtë, gjuhë e ëmbël, shpresë e plagosur, lulja e kujtimit. Këto metafora duke genë të rëndomta dhe të konsumuara

tradicionalisht shpesh, sikur nuk i shkojnë për shtat hijeshisë së këtij libri, pra janë si një vijë e pakujdesshme makijazhi në fytyrën e zbukuruar.

Xhevat Muqaku efektshëm di ta përdorë edhe figurën e metonimisë, si në poezitë Çmallje dhe Këngë e Shkrelit. Në poezinë e parë metonimia kanjusha e verdhë nënkupton Jusuf Gërvallën, ndërsa në poezinë e dytë metonimitë karvani i bardhëdhe bibla e heshtjes nënkuptojnë autorin e librave me këta tituj, pra Azem Shkrelin.

Cikli i tretë, “Derisa t’i përtërij grafitet”, veçohet për nga imazhet e ndryshme erotike, refleksive, të natyrës, profesionit etj. Imazhet e Muqakut janë imazhe mendimi, të cilat realizohen përmes një flake përsiatjeje. Përsiatjet imazhiste të poetit realizohen përmes abstraktes së thellë. Erotika te poezitë Kërshëri në hije, Siluetë e engjëllit, Çast magjik, Hije në distancë, nuk mbulohet me vrellot e epiteteve konvencionale, por me transcendencë mendimi. Në këtë cikël, si në të gjithë librin hasim kontrastin figurativ, siç është oksimoroni: akull i djegur, oazë e flakëruar, hije e skuqur, dritë e verbuar, lot i tharë, shi i thatë etj. Të folurit lirik në këtë libër bëhet përmes një gjuhe të kujdesshme dhe mjaft të pasur, me një ritëm konstant të strukturuar bukur, si vargje dhe strofa. Receptimin për këtë përmbledhje do ta kisha përfunduar me mendimin e poetit dhe kritikut të shquar Adem Gashi, i cili njëkohësisht është redaktor i librit, që shprehet: “Shenja e parë e këtij vëllimi, mbushja intelektualiste, si rrallë te ndonjë bashkëkohës i tij, vjen e bëhet vlerë estetike dhe përmbajtësore”. Kësaj shenje them se i rri bukur metafora e Daniel Golemanit: inteligjenca emocionale. Ndaj mund ta lexojmë edhe në variantin alternativ: emocionet inteligjente.

UDHËRRËFIMI I BRIRËVE TË DREERIT NË UNIVERSIN TONË


(Shënime meditative mbi romanin e Ballsor Hoxhës “Bora dhe unë”, Onufri, 2024)

Agron TUFA

Në traditën e prozës sonë (klasike apo bashkëkohore) nuk mbaj mend të ekzistojë një vepër letrare që ka fund e krye në qendër vetëdijen e traumatizuar të njeriut në agoni, të njeriut që përpëlitet në një kllapi të pafund dhe bën betejën e tij të mbijetesës duke u kapur për fije të fundit – tek dy-tre imazhe thelbësore – me të cilat shpreson t’i vërë pendë dezintegrimit rrënues të ndërgjegjes, shthurjes së mbeturinave të fundit të “Unit”. Ajo është beteja me iluzionet, shajnitë, shpesh e dyshimtë, e pasigurt dhe se perspektiva e shpresuar nuk të jep dot garanci. Bëhet fjalë për njeriun e rënë, për njeriun e shndërruar në plojë e pluhur të qenësisë dhe ekzistencës së vet, të vetshkatërruar, qoftë edhe nga vetkënaqësitë vetëndëshkuese, si një ndër format e revoltës. Dhe çfarë burrërie lypet për t’u ngritur nga pluhuri i plojës?Çfarë force duhet për të dalë gjallë dhe i kthjellët nga kurthet e një labirinti të ndërlikuar iluzonesh dhe vizionesh të traumës së gjatë, sistematike, rob dhe peng i së cilës ke mbetur ndër vite të shumta? Ku ta gjejë këtë forcë “Uni” i rrënuar? Kush e ndihmon dhe a është i ndihmueshëm? Duke parashtruar këto kushte, tejet të njohura në breza të tërë të rinjsh gjithkund në shoqërinë moderne (padyschim edhe në shoqërinë shqiptare të pas viteve 1990 në Kosovë dhe Shqipëri), unë kam filluar tashmë të flas për lëndën që ushqen një pjesë të mirë të veprës letrare të shkrimtarit tonë tejt të veçantë bashkëkohor, Ballsor Hoxhës. Bota e muzgjeve depresive që ka vënë poshtë vetëdijen e protagonistit të romanit “Bora dhe unë”, përshkohet nga agonia e drithërima e Qenies në teh të honit që nxin, e natës së një qielli të pa anë që e bart si një kafshatë në gojën e një maceje të zezë. Ballsor Hoxha na ka dhënë një roman në trajtën e confesionit, rrëfimit të dëndur, të ngjeshur, të thellë e troqtë, përmes vetës së ngushtë “unë”, duke shpalosur më shumë si monolog murmuritës kronikën e një historie akulluese, apo më saktë tatuazhin e saj në lëkurën e vet. Kur përmenda më lart mungesën e kësaj tematike në traditën e prozës sonë, harrova t’ju ndërmend një përjashtim: romanin “Odin Modvalsen” të Kasëm Trebeshinës, por natyra e traumës së protagonistit aty, është e një natyre tjetër, e viktimës së dhunës nga shteti totalitar, dhe, për më tepër, është fiction. Këtu ndahet çështja: romani “Bora dhe unë” i Ballsor Hoxhës është rrëfim (confession) i nxjerrë nga balta më e thellë e shpirtit të vet me gjithë poezinë që rrezëllin si diamant i zi. Çdo krahasim tjetër për këtë roman (dhe romaneve e novelave të tjera të autorit, që sapo janë botuar e janë në proces botimi) nuk vlen. Kush ka lexuar romanin e Irvine Welsh “Trainspotting” (apo ka parë filmin me të njëjtin titull), mund të përafrohet disi me ferrin depresiv dhe vegimet e përbindshme, por prapë, krahasuar me lëndën dhe situatën e narrativës së romanit “Bora dhe unë”, gjithçka mbetet një shurup trëndafili.

1. Romani si një bastun për t’u ngritur në këmbë

Ajo që të bën përshtypje që në prolog të romanit, është flakja e çdo maskë, sajese, truku apo shtirjeje dhe mësymja e autorit në thelb të zisë brenda suazës së rrëfimit: “Po, jam me sëmundje të rëndë psikike. E ky roman, përvojë e imja në pafund versione... është derti im, lufta dhe përpjekja për të qenë, dhe për të marrë pjesë në këtë shoqëri”. (“Bora dhe unë”). Romani pra është mjet, është fija e mbijetesës ku kapet i pashpresi, çka përbën dhe kredon e këtij rrëfimi drithërues e djersitës, deri në fund të shpirtit. Përvojat personale të traumës veçse e përligjin mandej tërë atë



golgotë të përmbysur vuajtjesh, të cilat, janë ku e ku larg stereotipit të shoqërisë dhe hamendësimeve tona të rutinizuara nga filmat, propaganda dhe spektaklet. Madhështore këtu është ideja e autorit, e ndërkallur që në fillim: të gjesh shpëtim tek rrëfimi, tek letërsia. Për fat, shkrimtarët del se, në rastet më fatlume, e kanë vetë ilaçin e shërimit të vetvetes. Por jo miq, nuk është aq e thjeshtë, nuk është aq e sigurtë: jemi në botën e ideve andaj le ta shohim shigjetën e lëshuar drejt qëllimit. A është, a mund të shërbejë romani, si një shkop për t’u mbajtur, për t’u ngritur në këmbë, për të marrë pjesë edhe njëherë në shoqëri, përmes rrëfimit? Rrëfimi si bastun, për të kontrolluar sadopak drejtpeshimin e trandur në themel. Rrëfimi si një shkop që heton, prek, orienton shtigjet nga duhet ecur... Rrëfim romanesk përmes vetëdijes së çarvalosur, mëtimi për të përmbledhur skajet e një identiteti të çarë, të një ndërgjegjeje të ciflosur në një unitet e vetëkontroll – pra, - rrëfimi romanesk si një kopsë që përmbledh Qenien e përshqyer e të plasaritur. Kjo është dhimbja dhe burrëria njëherësh: të vazhdosh të përvijosh daljen nga labirinti përmes rrëfimit në agoni. Ky është poeti, prozatori, eseisti e kritik u letrar Ballsor Hoxha që na rrëfen përvojat akulluese nëlëkurë të personazhit të vet e që në mos je ti, direkt, është yt vëlla, jot motër, yt bir, miku yt i ngushtë, jemi ne, gjithsesi, në hipotëzën tonë të gjithëmundshme të sociumit tonë. Kur ke mbaruar së lexuari kupton dhe një të vërtetë, ndoshta shumë të lashtë: që arti, kur bëhet i singertë dhe i pakompromis, shëron. Bëhet, nga shkop për t’u mbajtur e ngritur në këmbë, në strumbullar qëndrese për veten dhe të tjerët. Ja dhe një dhe një nga virtytet etike që vazhdon jehonën e vet pasi ke mbyllur fletën e fundit të romanit “Bora dhe unë”.

2. Qiell dhe univers i errët me shkëlqimin e syve të macës së zezë

Romani si narrativë letrare krijon një lehtësi komode nga pikëpamja e lexuesit, sepse është një linjë homogjene rrëfimi, pa ndërlikime dhe stisje, duke ruajtur një sens mase e kontrolli, që flet për zotërimin me mjeshtëri të lëndës, e cila nuk shket dore asnjëherë. Përsëritjet i japin efekt për të

vënë në spikamë rrathët e së panjohurës qe shtjelllet e rrotullohet si një enigmë torturuese në vetëdijen e përndezur, që sillet, vete e vjen si një karusel e shpejtë, gjithë në lëngatë. Romani krijon një atmosferë të pashqitshme e konstante. Jemi në epiqendrën e paralizës, në gjendjen e një horizonti ankthi monoton që ka përfshirë Prishtinën e viteve nëntëdhjetë; me brezin e të rinjve të ngecur që nuk ikën dot;që përpiqet të krijojë iluzionin e një shoqërie me trendet bashkëkohore me egot dhe me atë pijen e shpifur, Bambus, një kokteil i sajuar me verë dhe alkoole të ndryshme; me ambientet universitare ilegale dhe shtresat e dëshpërimit që majmen në pikëllim, asfiksi, ë kapur në një kurth pa shtegdalje; me ëndrrat dhe imagjinatat që rrahin të gjejnë një udhë, të hapin një lirishtë, si bisha e zënë në leqe; tërë brezi i ri, tërë forca radioaktive e ëndrrave kërruset, si saqepi dhe çaponjtë e një shpendi të privuar nga fluturimi për të përgjakurvetveten. Kjo është ajo Prishtina e paraluftës që nuk e njohim. Ky në letërsi koncepti i pashmangshëm i kronotoposit bahtinian. Ky është sheshi i dramës që shumëkush nga bota në tërësi, përfshij dhe atë shqiptare, nuk e njeh, skena e dramës ku luhet tragjedia e një populli të ngujuar për thetore dhe, më përveçmas, e gjeneratës së re të autorit, të cilës nuk i mbetet gjë tjetër për veprim, përpos se të ahahet e grihet me vetveten, të përfundojë në shpikjen e kënaqësisë së ëmbël të vetëshkatërrimit. Revolta zien, është e pazëshme, për më tepër është e paadresë: kujt t’i drejtohesh? Megjithatë ajo, në momente të padurueshme gjen një të çarë dhe shpërthen me tehun e saj të mprehtë dhe asgjësues, si revolta e Fatit (Stalkerit), një ndër personazhet më të dhimbshëm e më tragjikë të rrëfimit, dhe atëherë shqyhet dhe ajo maskë mondane që është sajuar në mënyrë iluzive: “...Fati si i krisur u pat ngritur në këmbë dhe bërtiste në mes të party-të, jo për tjetër por për të shkatërruar po të njëjtën për pikë të qefit, “çka kari u bo, krejt bota po thonë po qinë, e krejt femrat të virgjëra”, dhe qeshej, qeshej, qeshej sikur këto fjolla të borës që bien si të çmendura në xhamin tim, pastaj pat vazhduar, si mbret, si tigër, si ujk, si çjap - “jau dhjefsha Bambusat në dorë që po i mbani, jau dhjefsha 501-shat,

krejt çka kemi i kemi marrë prej Beogradit, prej serbëve, i imitojmë si thi, si ketra, si dreqën, e shtiremi se jemi dikushi; qayrni jashtë çfarë dite, e jemi kuforna, të gjalla, arkivole të javës së ardhshme, jemi një masakër e madhe në pritje për me ndodhë...” Ja ku jemi tash, të dërrmuar në dëshpërim e pikëllim, pa maskë, pa një skutë ku të arratisemi, pa një lirishtë në shmang të botës. Dhe shtegu për tek kjo lirishtë e padukshme, ku mund kutullohesh me veten duke lëpirë gjymtyrët e gjymtuara të qenies – është një shteg i bardhë, mjegullor, dëbora e përjetshme e heroinës, që të kredh në qiej të zinj, prej të cilëve nuk del del e nuk dëshiron të dalësh: Fati (Stalker i), binjaku apo dhe kipci (fetishi apo dubli) i autorit protagonist i jep fund jetës me vetëvrasje. I mbijetuari që na rrëfen rreket torturueshëm të gjejë një “kopsë” ideale, me të cilën të mund të mbërthejë planet e shkalafitura të identitetit tërësej të plasaritur në vetëdijen e traumatizuar: “Mall është të jesh pa një pjesë të jetës. Pa një heroinë, them krejt papritur. Por ku del këtu heroina, pyetem dhe macja e zezë, që jam vetë unë, në një skutë në qiell, lëvizë dhe kërkon të rehatohet, kërkon diçka, është e shqetësuar. Për një moment prapë pyetem, dhe nuk e di as se si e shoh dhe as ku jam, as çka është e çka nuk është më. Por vazhdoj, duke qenë i bindur se kjo do të krijojë një diçka, do të gjejë diçka, apo jam macja e zezë e uritur, pyetem. Heroina është malli për heroinë, heroina është malli për mungesën, për pjesën që të mungon. Heroina, por ndoshta heroina është vetë macja e zezë, vetë unë... Përnjëherë shoh se si qiellin e vërshon një e kuqe e mbylltë, si vlim, si shpërthim, macja, lëviz pak dhe e shoh duke e lëpirë veten, e gjej më në fund, një fill. E gjej se çka është Heroina”.

Romani e nis rrëfimin nga një shtëpi pushimi në bregdetin e Shqipërisë, për t’u kredhurigjithi nëvorbullëneerrët të realeve të Prishtinës së ngujuar, të paraluftës dhe vazhdon me pasojat e pasluftës. Mbyllja e rrëfimit është rikthimi (i satit?) në Psikiatri. Një rreth vicioz që nuk dihet sa do të zgjasë e kur do të dilet. Palcën e rrëfimit nuk e bëjnë aq shumë rrëfimet dhe historitë, se sa përjetimi dhe përpëlitja mendore për të mbajtur të pazhbëshëm identitetin e qenies së përshqyer që pluskon në fragmente. Dhe një ndër këto pika referimi të ndritshme në horizontet e turbulluara të vetëdijes është e bija gjashtëmbëdhjetëvjeçare Drenusha ose Bora.Drenusha/Bora mbetet deri në fund si filli më i mbramë e rezistent që e mban lidhur me realitetin. Megjithatë, nuk ka asnjë siguri, asnjë saktësi. Realiteti i njerëzve dhe sendeve është gjithmonë i dyshimtë, ambivalent, sepse përshfaqet me shumë faqe, shpesh të përkundërta. Është si të marrësh shenjë me një top artilierie, kur ai nuk është i fiksuar në tokë, por mbi valë tallazitëse. Pra bregdeti i Shqipërisë në një mëngjes të nxehtë e të kthjellët është koha dhe vendi ku rrëfimtarin e kap kriza depresive, konvulset e traumës dhe përmasa e paanë e kllapisë. Kjo përbën dhe rondon e vazhdueshme të rrëfimit, një sjellje e përsjellje si në rrathët e ferrit dantesk se, me që ra fjala, është saktësisht një roman dantesk në kuptimin që i japim këtu. Dritat shuhen në ndërgjegje dhe më të rrallë dëgjohen zhurmat dhe stërkalat e detit aty pranë. Heroi duke parandjerë shtjellë e zezë verbuese të vetëdijes, është ndarë nga e bija dhe instinkti e drejton të plandoset në verandën e banesës së tre pushuesve – një çift dhe një mysafire e tyre – të cilët e lidhin me kujtimet e djalërisë së pikëlluar të Prishtinës. Gjithë çfarë sundon në përpëlitjen e krizave, përbën rrëfimin si regjistrim, përshkrim dhe reflektim në disa kohë e disa versione. Bëhet fjalë për botë vegimesh, shajnish e hijesh. Derisa hero i

HEJZA

nuancën e vet:

“Po mahitem, unë mendoj që ti e mendon patrian krejt si unë. Njëfarë deti, njëfarë pamundësie me dalë jashtë saj, dhe njëfarë pafundësie e njerëzve që janë krejt së bashku të lidhur njani me tjetrin në një fat, por se ky fat nuk shihet se është i tejdukshëm, është i pranishëm dhe në ne e mbi ne, por është i padukshëm vetëm për këtë arsye. Më kupton babi?”

Tani koncepti mbi patrian shtrihet si një stihi e ujshme zanafillore dhe e paanë (një imazh i kaosit zanafillor prej duket se del në fillim të romanit vetë protagonisti), një det, masë oqeanike, me pamundësinë për të dalë jashtë saj dhe, përngjashëm me të, dhe deti njerëzor i lidhur mesvedi me në nyjë fati, ashtu si nyjet dhe cungjet e rrënjëve në tablonë e Van Gogh-ut, porse këto lidhje e këto nyja janë të padukshme për shkak të tejdashmërisë. Kështu koncepti i patrias likuidon dhe thuajse i zë vendin konceptit të fatit. Protagonistët e romanit dhe novelave të Ballsor Hoxhës e kërkojnë këtë virtualitet të tejdukshëm në lirishtat e tyre të qeniesimit, për të qenë frymë dhe shpirtra të lirë, të paspikatshtëm, të pavërejtshëm: një askeze engjëllore duke vetshkaturuar poetikisht nga kënaqësia, nën lexime e filozofime, nën tingujt e muzikës dhe teksteve me poezi dhe duke shkapërcyer atë, që Kundera e ka quajtur “Lehtësia e papërballueshme e qenies”. E papërballueshme tashmë, sepse jehonat janë si zgjatimi i zërave të Sirenave në veshët të ndjekësve të Odiseas, i cili, i çarvalosur prej aq shumë e shumë drobitjesh dëshiron të dorëzohet, pohim të cilin ia bën Jehonës në minutat e tij të kthjellimit: “Sepse nuk kam dëshirë, as për të vdekur. Jam aq i zbrazët, në të vërtetë jam aq i vdekur, më kupton Jehona, jam aq i panevojë, pa dëshirë për të vdekur.” E gjitha kjo të sjell ndërmend lodhjen, rëndesën dhe veleritjen e Ekleziastit: “Gjithçka është kotësi kotësish dhe rraskapitje shpirti”. Po “patria”, pas gjithë kësaj përvoje sfilitëse dhe pikëllimi të paanë, ka mbetur ende një ide e pakthjelluar? Duket se përvoja e fundit shtesë me Jehonën, diç ka ndryshuar, diçka zhdvaritur e përshkëllirë. Ka ndryshuar, mbase, nga prekja e saj njerëzore për qeniesim: “Kur e mendoj, ndoshta ka dashuri, ndoshta dashuria që ndjeja për Jehonën këto ditë, para natës së sontme, është e vërtetë, nëse ka ndonjë gjë të vërtetë, sepse më kishte kthyer në njeri, në përkatës të kësaj bote, e jo si vampirë i kësaj bote pa asnjë lidhje me të”.

Ballsor Hoxha nuk është tipi i pozitivistit hamngjitës e motivues, për ata që kërkojnë moral mallëngjyes nga letërsia, e cila, siç thamë në fillim, i shërbeu si bastun për t’u ngritur në këmbë nga ploja ku dergjej, por nëse letërsia e ndihmon të ngrihet, atëherë mos prisni që, me t’u ngritur në këmbë, t’ju mbaj një fjalim prekës e moralist. Ai është larg prej kësaj epidemie banale dhe nuk është aspak i sigurt për qëndrueshmërinë: nuk ekzistojnë receta, sikundrse nuk bëhet fjalë as për kompromentimin e shkrimtarit me moralistin mallëngjyes. Shkrimtari i pakorruptueshim kthjellon e përthjellon misterin, shqyrton e ripërkufizon më qartë patrian e tij, që tashmë, në fund të romanit, ka ngrohtësinë e rrjedhshme të gjakut në damarë, diç tejet e gjallë e njerëzore: “Por patria, nuk është strehë, në të vërtetë, është vetë gjaku, rrjedha e tij, dhe në fund premtimi i tij, jeta, dhe vdekja si premtime, dhe tërë ajo që është në mes, - njëlloj ndërthurje e rrjetave të njeriut, dhe të njerëzimit në tërësinë e asaj që është”. Po patria e tij, ku është patria, për të cilën ravgon qenia si një minë me sahat? Ajo është përherë iluzioni ynë i ëmbël që na ngashënjen, na ndjell t’i bindemi ta ndjekim në fshehtësi, larg atij zinxhiri ndërmues me hallkat e shkaqeve dhe pasojave, qofshin këta prindja, familja, farefisi: - është bukuria tejtokësore e ëndrrës dhe imagjinatës që na përthith me hijeshinë dhe elegancën efemere, përdegëzimi ku treterni si në një rrjetë bigëzimesh fraktal në univers. Me një imazh metaforik të kësaj ideje mbi bukurinë dhe imagjinatën e virgjër mbyllet dhe romani “Bora dhe unë” i shkrimtarit Ballsor Hoxha: “Nuk ka gjë më të bukur në natyrë se brirët e drerit, mendoj. Kapërthimi i tyre, degëzimi i tyre, dhe përthyerja e tyre në një spontanitet tej të njohurës, janë pikërisht maja e natyrës së këtij universi që e quajmë botë”. (Zvicër, 31 dhjetor 2024)

dhe imagjonohet, sakundër edhe “Cul de sac”-u individual (qorrsokaku)? Nga njëherë ai duket si ato enët konceptuale të filozofisë ontologjike, për t’u mbushur me një mori kuptimesh e nuancash kuptimore, njëfarë Dasein-i alla-Heidegger. Por jemi në një rrëfim artistik, në faqe romani dhe nuancat e “patrias” jepen përmes kuvendimesh të frymëzuara. Shtjellimi i këtij koncepti disi mjegullor fiton gjithë e më tepër qartësi e konkretësi dhe shtrihet edhe nëveprat të tjera të autorit, si për shembull, në novelat “Sytë e zinj të Borës” dhe “Shënime nga përmbi”. “E çka është patria (arku), pyetem. Prania e një babe, një strehe, një ligjësie dhe një udhe brenda kësaj ligjësie”. (fq. 306, “Sytë e Borës”)“Është e çuditshme, por ndërsa një kohë njerëzit jetonin të bëheshin prindër, baballarë, sot është tmerr e ankth të bëhesh babë. Nuk do njeri të bëhet babë, të jesh baba është sikur të jetë një re, hije, mbulesë dhe paracaktueshmëri e fatit të fëmijës së tij. Askush nuk do t’ia lindë fatin e vetë, fëmijës së tij”. (Po aty). “Për mua, Bal, patria gjithmonë ka qenë ajo gjëja e parë në këtë botë. Ajo, apo ai, që e ka bërë të tërën pikërisht kështu siç është, siç ka qenë dhe siç do të jetë përgjithmonë”. (fq. 312, “Sytë e zinj të Borës”). Këto janë përfytyrimet e Fatit (Stalkerit), i cili ka po këtë emër, si në këtë roman dhe në novelën “Sytë e zinj të Borës”. Më heret ai e percepton patrian herë si “retë”, herë si “babë”. Jo ose/ose, por edhe/edhe. Edhe brenda të kuptuarit e Fatit, përkufizimi i “patrias” ndryshon nuancë e madje thelb përkufizues: nga “babë”, “strehë”, “ligjësi” dhe udhë e kësaj ligjësie, ai befas shtyn kufijtë, si me thënë, të një energjie eidosiane kozmogonike, bëhet Zanafillë e Zanafillave, përndryshe Demiurgu, Hyji. Por te romani “Bora dhe unë” Fati më nuk është gjallë dhe arsyetimet mbi natyrën e “patrias” mbeten të autorit (në novelën “Sytë e zinj të Borës” është e pamundur të identifikohet se kush çfarë ka thënë, se kush çfarë ka shkruar midis autorit dhe Fatit). Dhe autori shtjellon konceptin e vet të patrias: “E të varfër ishim të gjithë, ishim të varfër qoftë edhe për lirinë e të mësuarit në universitetet tona”. “Por në të vërtetë ishte patria, ajo që na mundonte, patria si fat, vetë Fati, Stalker duke e pas shpikur këtë problem tonin, patria ishte vetë piktura e Van Gogh “Rrënjët”, e fundit para vetëvrasjes, ishte njëlloj pështjellimi aq i keq i pazgjdhshëm i tërë patriave të tërë botës në një fat, për ne të dy, në një fat për të gjithë ne në të vërtetë për të kaluar nëpër luftë, dhe ndërsa të tjerët iknin, ne disa të tjerë merrnin heroinë”. Tashmë këtu “patria” nuk është më kuptimi larin i vendlindjes, atdheut, as “baba”, “streha”, “ligjësia” dhe as “gjëja e parë në botë siç ka qenë” që nuk do të ndryshojë siç e ka krijuar “Ajo apo Ai”. Këtu “patria” lëviz drejt një sinonimie të plotë me horizontin e fatit, “vetë fati”, destini, që për çudi mishërohet me pikturën e Van Gogh-ut “Rrënjët”. Po pse me këtë pikturë? Çfarë është ajo? Është fjala më saktë për tablonë “Rrënjët e pemëve” (holandisht: Boomwortels) - një pikturë e Vincent van Gogh, e pikturuar në 1890 në Francë. Sipas disa studiuesve, kjo është piktura e fundit e pikturuar nga Van Gogh para vetëvrasjes. Në pamje të parë, piktura mund të duket si një kompozimi formave abstrakte dhe ngjyrave të ndezura, por ajo përshkruan rrënjët dhe fundamentin e pemëve, bimëve dhe gjetheve. Formati i pikturës është i zgjatur horizontalisht dhe përfaqëson “dy katrorë të lidhur horizontalisht”“Megjithatë, piktura “Rrënjët e pemës” doli të ishte shumë e ndritshme dhe plot jetë. Kjo është një vepër shumë e guximshme e së njëjtës ditë me vetëvrasjen. Është e vështirë të thuash se Van Gogh e konceptoi me vetëdije këtë pikturë si një lamtumirë që do të ishte një akt shumë racional. Të gjitha këto rrënjë të përdredhura dhe të ngjizura lënë përshtypjen e diçkaje kaotike, tejmase emocionale, por kjo pikturë nuk është produkt i një psikike të sëmurë.Ai e dinte se ç’po bënte. Ja, kjo ngjizje, përzierje, kokolepsjeje e pashqitshme e dheut me rrënjët dhe fundamentin përbën dhe truallin e sigurt dhe organik të “patria-s”, një model ideal për të cilën përmallen ëndërruesit me ndërgjegje të ciflosur e vetëdije të dezintegruar: përmallja për identitetin, të qenët organikisht një tërësi e pacenuar, vetvetja, por që fatkeqësisht është një vetvete që me veten s’rrin. Më së fundi përfytyrimeve e hamendësimeve mbi patrian i shtohet dhe gjykimi adoleshentes Drenusha vs Bora, e bija e narratorit, e cila i shton gjithashtu

që e kuptoj, që nuk është e Drenushës, por që e ndiej si të Drenushës, apo më vjen si prej shumë larg nga Drenusha, e kushedi ndoshta janë të gjitha së bashku, pikërisht në qiell derisa më përkëdhelë, më kafshon dhe më lëpinë macja e zezë, më thotë se unë jam vetëm një maskë e saj, unë nuk ekzistoj, e qoftë edhe nëse ekzistoj jam vetë macja, e si mace kam ndonjë rast për të mbijetuar, por jo si njeri. A e din pse ikë ti? Më pyet macja. Po pse? I them, po pse? Ikë sepse jo që ke frikë nga dashuria, por se dashuria ka frikë nga ti, ti je si unë, dhe ajo është e sajuar nga njeriu për të dhënë kujdes, për të marrë e dhënë, për të zgjeruar këtë botë, për të zotëruar njëri tjetrin, e ti, ti dashuron si mace. E si dashurojnë macet, e pyes? Po ja, kështu, si që të kam bartur e të kam gjetur një skutë. Po çfarë skate është kjo jemi në mes të qiellit, e qielli nëse nuk ka ndonjë gjë ai nuk ka as mes as skutë. Ku e gjete këtë mes, pyes macen e zezë? Kështu duam macet. Por jo edhe macet e zeza, ne duam pak më ndryshe, ne duam ndryshe, jo prej ndonjë mirësie, ajo nuk është askund, as kurrë nuk ka pasur, ka vetëm heqje dhe mundim e vuajtje, dhe ne macet. Ngrihem me mundim përballë syve të saj dhe ia shikoj, është e brengosur, e vuajtur dhe e vetmuar, po sikur mace e zezë. Pikërisht në këtë moment ajo më gjuan nga qielli”.

Janë padyshim fragmentet më të fuqishme të prozës sonë bashkëkohore! Një cilësi e të menduarit abstrakt, alogjik e halucinant e ndërthurur pandarazi e dorëpërdorë me racion, gjykimin e kthjellët: nga kjo përshkënditje lind poezia dramatike, energjitika e lartë fërgëlluese e tekstit. Dhe përsiatje të tilla sfilitëse zënë pjesën më të madhe të tekstit të romanit. Pra nesh hapet humnera, honi i zi përpirës përmes dëshmisë së njeriut që i ra pashë më pashë dhe prapë e prapë këmbëngul, se ky është realitet i injoruar në faqet e letërsisë sonë, pavarësisht sëmbimit therës e të pashërim të brezave të tërë të rinisë që kanë qenë krah nesh, në radhët tona, në shtëpitë tona me trajtën e vëllezërve e motrave, bashkëshortit apo mikut. Dhe pikërisht për këto plagë dhe pengje që na therin në shpirt, qoftë si kujtime angështitëse, qoftë si malcim i vazhdueshëm, i përsëritur e i ri, na duhet të paktën të hyjmë në lëkurën e kësaj dhimbjeje të pakufishme, në zemrën regëtitëse të traumës së vërtetë. Mësimet morale nuk vlejnë; këshillat dhe udhëzimet nuk vlejnë; strategjitë dhe rrengjet institucionale nuk vlejnë – asgjë nuk vlen – nëse nuk njëjtësohemi e nuk zbresim kapilarë në palcën e rrënjëve të kësaj tragjedie, e cila, e theksoj, nuk erdhi vetvetiu, por u përvijua beftë diku, mes peizazhit tonë të dëshpëruar shoqëror. Bota që na ka marrë pakthim ëndërruesit tani arratiakë me zemra të brishta dhe imagjinatë të harlisur, nuk i ka rrënjët në sipërfaqe, por thellë, ashtu si piktura e famshme e Van Gogh-ut. Sepse pengje të këtij zjarri të bardhë apo bore përvëluese janë shpesh, paradoksalisht, djeme vajza me imagjinatë kreative të tejndjeshme, sikurse është në këtë rast njëri nga të mbijetuarit, autori, shkrimtari i mrekullueshëm i këtij romani dhe i romaneve e novelave të tjera të ngjashme. Janë sfungjerë të etur për liri, dhe në mungesë totale të lirisë, ata do ta përftojnë atë, qoftë edhe me çmimin e përzishëm tragjik të vetshkatërrimit të ëmbël – vetmitarë ëndërrues, asocialë.

3. Kërkimi i etshëm dhe gologota e “patrias”

“Fati kur i përzihej latinishtja dhe na thoshte neve dyve se e kishim gabim, se nuk ishte patria, jo atdheu, por se ishte vetë streha e imagjinuar e njeriut, një herë si retë, e pastaj si babë”. Në nga konceptet fundamentale filozofiko-diskursive në roman, është koncepti i mjegulluar i “patrias”. Dy siamezët dhe dublat e ndërsjelltë – autori dhe Fati (Stalkeri) - janë në kërkim të patrias së tyre dhe vazhdimisht rreken të zhdavarisin mjegullat që veshin thelbin kuptimor të ikshëm, të rrëshqitshëm të “patrias”. Patria në të kuptuarit e tyre është sa i qartë, po aq dhe abstrakt, andaj lypsen bërë gjithëherë sqarime të reja në vetminë e tyre asketike dhe gjithëherë “patria” fiton një nuancë të re, sepse është si një planet misterioz që lyp vrojtme të reja nga këndshikime të ndryshme me “teleskopë” të fuqishëm galaktike – një lloj planeti, për shembull, si “Melankolia” në filmn e Lars von Trier-it. Më vonë këtyre diskurseve mbi patrian i shtohet dhe Drennusha alias Bora. Po ç’është në të vërtetë kjo patria që kërkohet

është plandosur, i errësuar në vetëdije, me jargë që i kullojnë dhe duke u dridhur nga të ftohtët në motin e nxehtë 40 gradë, ai aty, në verandën e ish të njohurve, përpigjet instinktivisht gjatë gjithë kohës të provokojë gjallësinë e tij, gjithë duke grithur me thonj murin e drunjtë. Ashtu e gjejnë dhe do kohë t’i bien në të se kush është. Për t’u shënuar për gjendjen e tij është se, për orë të tëra, i vërtitet periodikisht në tru veçse një paradoks gjuhësor: “Doriani kishte mbushur mendjen E luante jetën porsi Doriani Me kujtimet e tij...”

Kush është Doriani. Cila është enigma që fshihet pas tij? Janë vargjet e tij apo asociacion i një realeje tjetër? Mos është fetish i vetes së tij, siç i bëhet se ka qenë Dorian dhe ka kaluar vite në Angli? Janë kthina të errëta të labirintit që duhen ndriçuar. Duhet përftuar një cifël identiteti. Mos është Dorian Grey i Wide-s? Dhe tortura e rigjetjes së kësaj lidhjeje rinis sërish. Por, kyçi i vegimi në roman, që e përshkon krejt botën e romanit me makthet dhe iluzionet, është imazhi i maces së zezë, një trasfigurim i maces Zeza, që ka pasur në shftrofkën e viteve të heroinës, pra i një maceje të zezë që lëviz nga toka në qiellin me yjet e që mandej e lëshon nga lart të bjerë. Ky është imazhi sundues, më i ankthshmi, më djersitësi, më lënguesi, që besoj nuk do t’i shqitet kurrë lexuesit.

“Në qiellin sterrë nga vezullima e syve të saj, më del macja e zezë, krijesë në qiell, ecën, më bart kafshuar në gojën e saj dhe sikur kërkon të më skajojë diku, diku në qiellin e paanë... Sikur të ketë telashe çka të bëjë me mua dhe ku të më lërë, unë bartur ashtu në gojën e saj që jargavitet nga pesha ime e madhe me këmbët duke m’u zvarritur në qiell; ndiej një dërmim dhe dëgjoj çelësa të derës, por jam i dorëzuar. Se si macja, krijesë në qiell është një e zezë thellë brenda të ngrysurës së qiellit, është sikur kanal që thellon tutje, kalon dhe shndrit me të zezën dhe vezullimin në sytë e saj. Macja më në fund ndalet, ndalet në mes të qiellit, por për atë është një skutë e saj, nuk ka hënë dhe as drita, të gjithë kanë ikur nga plazhi, që do të thotë nuk ka asnjë ndriçim nga poshtë, dallohen vetëm sytë e saj që vezullojnë dhe këmbët e mia që zvarriten bartur në gojën saj. Në këtë skutë ajo më mbështjellë me trupin e saj dhe më lëpinë, kujdeset për mua... Çudi, i them maces, ti as nuk e njeh qiellin, dhe më bartë kështu nëpër të. Qielli nuk ka skuta dhe as rrugë dhe as lagje e shtëpi e ushqim dhe ti më tërheq zvarrë. Më lësho të lutem, më lësho, çka nëse më sheh Drenusha?” Ky imazh i mëshirshëm dhe i gjithëpushtetshëm i maces së zezë që e bart duke hapur një brazdë, një thellukë nëpër qiellin e zi të natës, është imazhi i së kaluarës, e kaluara vetë që nuk e lëshon, ajo e kaluar e vetëshkatërrimit me kënaqësi në strehën e një banesë të braktisur, - lirishtë e qenies dhe qenësimit që ka gjetur, asketizmi i vetmisë, i daljes në shmang për të harruar tok me dublin e vet, Stallkerin dhe me totemin e përbashkët – Zezën, macen e tyre të zezë që kanë rritur bashkë. Po Stallkeri (Fati) nuk është më, është vetëvrarë, ndërsa Zeza është zhdukur. Ajo rikthehet me tërë ngarkesën e së shkuarës mallëngjyese si imazh shpëtimtar për rivazhdimin dhe rikthimin në lirishtën e Qenies në shmang, përt’i shkUAR në fund mbase vetshkatërrimit me kënaqësi. Macja që e bart në qiell është thirrje për rikthim në strehën e transcenduar tashmë në Patrie. Poetika e traumës e shpleks fije-fike vetëdijen e ciflosur në tërë dezintegrimin e subjektit, dhe elaborimin e një filozofia subjektive të “patries” dhe “Cul de sac” personal, qorrsokakut të zgjedhur. Përftohen dhe simbolika vetvetiu ose të menduara si Jehona (jehonat e shumëfishta të identitetit vetjakje po kështu, binjakëzimi, shkrirja padallueshëm e identiteteve të pashqitshme me Fatin (fatin). Jehona është mysafirja e çiftit, e ardhur nga Anglia, por është dhe jehona e puthjes së rinisë në një nga ndejat e lokaleve të Prishtinës së paralizuar të viteve nëntëdhjetë. Ajo ka qenë dikur ëndrra e parealizuar e djalerisë, që rishfaqet tashmë në bregdetin e Shqipërisë. Por ai nuk është më në gjendje t’i flasë e t’i përmendë veten kësaj ëndrrë të dikurshme. Ai tashmë gjendet nën pushtetin e maces së zezë që shtegton duke hapur një hulli nëpër qiellin e zi: “Frynë përnjëherë dhe macja e zezë me mundim më mbanë dhe më strehon për të mos më bartur era, për të mos u shkëputur nga kafshimi i saj, nga goja e saj që jargavitet në mua. Në gjuhën e saj

16

Botime

RRËFIME TË THELLA PËR KUPTIMIN DHE ABSURDITETIN E JETËS

(Analizë e librit “Hapësirë e akullt” të Xhemë Karadaku, botoi URA, Prishtinë, 2024)

Lumnien Thaçi-HALILI

Letërsia është pasqyrë e realitetit social dhe shpirtëror shpesh gjen mënyra të ndryshme për të trajtuar dilemën njerëzore, duke zhbiruar thellë në shtresat e errëta dhe komplekse të ndërgjegjes, shoqërisë dhe moralit. Tregimet e analizuara këtu përmes simbolikës, ironive dhe karakterizimeve të hollësishme, i ofrojnë lexuesit një shteg për të kuptuar absurditetin e disa prej fenomeneve bashkëkohore, marrëdhëniet komplekse mes individit dhe shoqërisë, dhe dilemën morale për të ruajtur integritetin përballë sfidave të përditshme. Kështu që edhe libri i botuar së fundmi nga Botimet URA (tregime të përzgjedhura) me titull “Hapësirë e akullt” të autorit Xhemë Karadaku, edhe pse janë shkruar në kohë të ndryshme, lidhen ndër vete me një bazament të fortë, ecjen nëpër mundimet të asaj që quhet jetë, si realitet, por edhe si krijim i bazuar në fantazinë krijuese, pra bazuar në “realitetin e ri” letrar. Autori trajton tema nga kaluara e largët apo e afërt, apo edhe tema aktuale, ku ngjarjet brenda tregimeve, japin një pamje të dhembshme dhe tragjikomike, me atë që ka ndodhur, me atë që ndodh tash ose pritet të ndodhë në të ardhmen. Tregimet, sikur krijojnë postulate pak a shumë ironizuese të vetë asaj jete “lakurique”, për t’u mbindërtuar në diçka që s’do mend, është edhe vetë kërkesë e asaj që quhet pretendim artistik. Ndërmjet këtyre “vrojtimeve”, autori skicon jetën me të mirat dhe të këqiat e saj, me të bukurat dhe të shëmtuarat e saj, duke bërë letërsi. Leximi i librit me tregime “Hapësirë e akullt”, të lë një mbresë se je duke lexuar, fletë ditari të jetës, apo je duke shfletuar një bllok skicimesh, pasazhesh apo copa fragmentesh të asaj që quhet jetë reale ose asaj të fantazuar. Apo, thënë më mirë, gjatë leximit, je duke parë një film dokumentar, për ato që (s’)kanë ndodhur, e të cilat në njëfarë dore i ke parë, e mënyra se si i ke parë, nuk janë film dokumentar, por një omnibus rrëfimesh, që fillojnë me shpalosjen e identiteteve të personazheve, nga tregimi “Pellgorja ndryshe”, deri te tregimi “Ëndërr me ëndrra”. Gjatë leximit të tregimeve, lexuesi e krijon portretin e njeriut të këtij nënqielli, të mbushur me vuajtje, dhembje, sakrifica, halle etj. Pra, gjashtëmbëdhjetë tregimet te “Hapësirë e akullt” janë pasqyrim i një kohe, e cila ka lënë vragë tek autori, e do të lënë gjurmë edhe në mbamendjen e lexuesit të tyre. Tregimi i parë është “Pellgorja ndryshe” që gërsheton elemente të realitetit dhe fantazisë, duke krijuar një strukturë narrative që kap ndjesitë e jetës rurale, të mbështjella me një shtresë të pasur të imagjinatës. Në njërën anë, përshkrimi i peizazhit, jetës së fshatit dhe përditshmërisë së kullotjes së deleve krijon një atmosferë reale dhe autentike, duke pasqyruar një botë rurale të gjallë e të gjeneruar me kujdes. Në anën tjetër, figura e Hazir Pusit merr përmasa mistike, duke i dhënë tregimit një dimension të fshehur dhe të paqartë. Ai paraqitet si një figurë enigmatike, me elemente fantastike që burimet e rrëfimit i thurin nëpërmjet përshkrimeve të bimëve misterioze, ritualeve të natës dhe perceptimit të tij si njeri “i mbrapshtë” nga bashkëfshatarët. Përplasja mes realitetit të përditshëm dhe kësaj fantazie krijuese ndihmon në ndërtimin e një hapësire ku lexuesi ftohet të imagjinojë përtej të zakonshmes. E kaluara e afërt dhe e largët si fletë ditari te ky tregim shfaqet si një kronikë e jetës në fshat, duke evokuar një ndjesi nostalgjie për kohët e shkuara. Emërtimet si “Arat



e Pusit,” “Vorri i Hazir Pusit” dhe “Kroi i Pusit” bëhen pika referimi që lidhen me kujtime kolektive dhe personale, duke rikujtuar një të kaluar që për lexuesin e ka humbur përjetimin e drejtpërdrejtë. Këto vende bartin histori, të cilat protagonistët përpiqen t’i mbartin në një të tashme ku peizazhi dhe shoqëria kanë ndryshuar. Tregimi pasqyron dhimbjen dhe tragjedinë e jetës së Hazir Pusit, por e ndërthur atë me një dozë humori të errët, duke e bërë lexuesin të ndjejë një përzierje emocionesh. Fakti që njerëzit e perceptojnë atë si njeri të rrezikshëm dhe misterioz, ndërkohë që në realitet ai përballlet me një dhimbje të thellë personale, krijon një kontrast emocional të fuqishëm që e ndan lexuesin midis keqardhjes dhe një humori të hidhur. Tregimi ngre pyetje të rëndësishme mbi bukurinë dhe shëmtinë, mbi normat dhe përjashtimet sociale. “Pellgorja ndryshe” përçon një mesazh të fuqishëm mbi ndërlikimet e jetës njerëzore, përplasjen mes së kaluarës dhe të tashmes, dhe kompleksitetin e perceptimeve tona mbi të tjerët. Tregimi ndërtohet mbi kontraste të forta-midis të bukurës dhe të shëmtuarës, të kaluarës dhe të tashmes, të jashtmes dhe të brendshmes. Për shembull, drunjtë e lartë dhe të drejtë të Pellgores kontrastojnë me kujtimet për therrat dhe gardhet e dëmshëm të së shkuarës. Haziri, nga njëra anë, shihet si një person i frikshëm dhe i mbrapshtë, ndërsa, nga ana tjetër, na zbulohen aspektet e tij njerëzore dhe tragjike;Elementet natyrore, si Pellgorja, drunjtë dhe jehona, personifikohen për t’i dhënë peizazhit një rol të gjallë dhe aktiv në narrativë. Metaforat përdoren për të përshkruar ndjesinë e izolimit dhe ndryshimit. Veçojmë edhe elementet nostalgjikë, si përmendja e emrave të vendeve dhe kujtimet për fëmijërinë që krijojnë një ndjenjë melankolie dhe lidhje të fortë emocionale me të kaluarën. Autori përdor një gjuhë të thjeshtë, të

kuptueshme dhe të rrjedhshme, duke i dhënë tregimit një ndjesi natyrale të përditshmërisë rurale. Gjuha e tregimit përshkohet nga elemente të gjuhës së përditshme të fshatit-dialektizmi, të cilat i japin autenticitet dhe besueshmëri. Në shumë momente, tregimi përdor një ton ironik, veçanërisht në përshkrimin e Hazirit dhe marrëdhënieve të tij me të tjerët. Ky ton shpesh ndërthuret me një ndjenjë tragjike, duke nxjerrë në pah dhimbjen dhe vuajtjen që fshihet pas historisë së tij. Tregimi i dytë titullohet “As ombrellë, as hije...” është një pasqyrë e mprehtë e jetës reale të individëve dhe shoqërisë pas luftës së fundit dhe tranzicionit në Kosovë, por e përshkruar nga një dozë fantazie krijuese që i jep një shtresë simbolike rrëfimit. Pjesa realiste përshkruan jetën e një personi të lidhur me botën e punës, ekonomisë dhe shpresës së mbështetur te politika. Përshkrimi i shtypshkronjës NEM si një hapësirë e lodhshme dhe me plot probleme praktike, përforcon realitetin e ashpër të jetës së pasluftës. Megjithatë, tregimi kalon përtej këtij realiteti me figurën e Kushës, e cila shndërrohet në një simbol të humbjes së shpresave dhe ëndrrave për një jetë më të mirë në një kontekst shoqëror të trazuar. Hija e tij, e përshkruar në fillim si një siluetë e trishtë me ombrellë në shi, krijon një atmosferë fantazie dhe fshehtësie që mbulon një realitet të errët dhe të dhimbshëm. Kjo hije nuk është vetëm një individ, por një metaforë për gjithë ata që kanë humbur iluzionet e tyre në tranzicionin shoqëror.E shkuara afërt dhe e largët, funksionon si një kronikë brenda tregimit, duke u rikthyer në kujtime të një kohe kur gjithçka dukej e mundur. Rrëfimtari na kthen në një periudhë kur entuziazmi pas lufte kishte mbushur zemrat e njerëzve dhe ëndrrat për sukses e rindërtim ishin të gjalla. Përmes përshkrimit të shtypshkronjës, që në një kohë shihej si një hap i madh përpara, por gradualisht u

shndërrua në një burim zhgënjimi, tregimi trajton temën e iluzioneve që thyhen nga realiteti i ashpër. Kusha, dikur një figurë e respektuar dhe e fuqishme, përfaqëson një ideal të shkuar që është shembur nën presionin e korrupsionit, politikës dhe dështimeve personale. Kujtimet e rrëfimitarit për periudhën e entuziazmit të pasluftës dhe përkushtimin ndaj punës përplasen me realitetin e ftohtë të zhgënjimit, duke e bërë të kaluarën një fletë ditari të përditshme.Tregimi është një shembull i shkëlqyer i tragjikomikes-kombinimit të dhimbjes dhe humorit që krijon një efekt të veçantë emocional te lexuesi. Kusha, është një figurë tragjike që na bën të reflektojmë mbi rënien e dikujt që dikur ishte i suksesshëm dhe i respektuar. Fjalët e tij: Unë do të jem Qeveri në hije (f. 20), pasqyrojnë jo vetëm ambicien, por edhe ironinë e fatit të tij, që përfundon si një hije e vetvetes. Tregimi është i mbushur me postulate ironizuese që pasqyrojnë një jetë “lakurique,” ku e bukura dhe e shëmtuara bashkëjetojnë në mënyrë të çuditshme. Ironia është një element që përshkon të gjitha aspektet e rrëfimit: që nga përshkrimi i shtypshkronjës si një simbol i ambicieve të mëdha, por që përfundon e mbytur në probleme teknike dhe menaxheriale, deri te kontrasti mes ëndrrave politike të Kushës dhe realitetit të tij të dhimbshëm.“As ombrellë, as hije...” është i mprehtë dhe satirik në ton. Kjo është pasojë e tematikës urbane dhe fokusit te politika, dështimi social dhe zhgënjimet personale. Atmosfera është cinike dhe ironike, duke ekspozuar iluzionet politike dhe sociale përmes një stili më urban dhe të ngarkuar me dinamizëm, zhvillohet në një kontekst urban dhe përmban një ritëm më të vrullshëm dhe më dinamik, duke përfshirë përshkrime të jetës së qytetit, problemeve teknike dhe marrëdhënieve sociale që ndërthuren me një tension të brendshëm. Ka një gjuhë pragmatike, me elemente të gjuhës urbane dhe të folur, duke përfshirë dialogë të gjallë dhe detaje teknike për shtypshkronjën, makineritë dhe sfidat e përditshme. Ndërtimi i një atmosfere folklorike dhe legjendare jepet përmes tregimit “Kali i drunjtë”, i cili mbështetet fuqimisht në një atmosferë që gërsheton elemente folklorike dhe legjendare. Vin Jaka dhe kali i tij, Gjoku, shndërrohen në figura mitike brenda tregimit. Përshkrimi i Vin Jakës, një burrë me plis të bardhë, pallto të gjatë dhe pushkë në krah, krijon një karakter që të kujton një hero epik, një figurë që ecën në vijën ndarëse mes realitetit dhe mitit. Ndërsa kali, si simbol i lirisë dhe lidhjes shpirtërore, merr përmasa të jashtëzakonshme. Ai është më shumë sesa një kafshë, ai është një figurë mitologjike, duke u krahasuar me Pegasin nga mitologjia greke dhe Kalin e Trojës.Vin Jaka mishëron një botë të vjetër dhe konservative, ku zakonet, burrëria dhe lidhja me natyrën janë thelbësore. Ai dhe Gjoku janë përfaqësues të një brezi që jetonte sipas kodeve tradicionale. Kjo kundërshtohet me figurën e Ban Sukës, i cili përfaqëson një qasje më pragmatike dhe tregtare ndaj jetës, duke i trajtuar kuajt si një burim tregtie, jo si shoqërues shpirtërorë. Shihet një simbiozë mes njeriut dhe kafshës, ngase marrëdhënia mes Vin Jakës dhe Gjokut është zemra emocionale e tregimit. Ajo pasqyron një lidhje simbiotike, ku kali bëhet pjesë e personalitetit të Vin Jakës dhe një zgjatje e qenies së tij. Vdekja e Vin Jakës është e ndërlidhur simbolikisht me Gjokun, duke lënë përshtypjen se ata nuk mund të ekzistojnë njëri pa tjetrin. Rrëfimi i Ban Sukës se si Gjoku ishte një

HEJZA

mëz i braktisur që e kishte gjetur dhe më vonë e kishte humbur, përforcon idenë e përkohshmërisë dhe misterit të lidhjes njerëzore me natyrën dhe kafshët. Zë vend një tension i dukshëm në këtë tregim midis besimit dhe realitetit. Andaj, një nga pikat më të spikatura të tregimit është tensioni midis narrativave mitike dhe të vërtetës së zbuluar. Ky tension ekspozon nevojën njerëzore për të ndërtuar legjenda për të përballuar realitetin e zakonshëm. Tregimi pasues në libër titullohet “Daja Rrem, he legjendë!” me personazhin kryesor: Rrem Ahishta (Daja Rrem). Pra,Rrem Ahishta është zemra dhe fryma e këtij tregimi, një personazh që shfaqet si një përzierje midis një antiheroi komik dhe një legjende të gjallë të shoqërisë. Ai është një figurë shumëdimensionale që përmban elemente tragjikomike, ironike dhe një dozë të theksuar të zgjuarsisë popullore. Ai është i formuar nga shumë tipare, ja disa nga më kryesoret: Antiheroi komik dhe ironia e fatit-Daja Rrem është portretizuar si një njeri i cili, përmes zgjuarsisë dhe aftësisë së tij për manipulim, sfidon normat shoqërore dhe ligjet e kohës. Ai shpall veten të paaftë mendërisht, por ironia është se ky “i paaftë” arrin të mashtrojë mjekët, policinë dhe gjithë sistemin për të përfituar materialisht. Kjo ironi e fatit e bën atë një antihero komik: një njeri që sfidon absurditetin e sistemit përmes një absurditeti të vetëkrijuar; Humori dhe tragjikomedia në karakterin e tij- edhe pse Daja Rrem shpesh është qendra e komedisë në tregim, ai gjithashtu përmban elemente të një tragjikomike të heshtur. Ai është një simbol i një shoqërie që lufton për të gjetur një vend në një botë të padrejtë. Përmes kësaj figure, nënkuptohet që jo rrallë në përditshmëri, ndodh të bëhet edhe mitizimi i zakonshmërisë.Daja Rrem shndërrohet në një figurë mitike përmes tregimeve dhe bëmave të tij, duke u bërë një personazh që tejkalon realitetin dhe futet në botën e legjendave popullore. Hakmarrja si fuqi natyrore dhe morale mbizotëron thelbin e tregimit të radhës “Legjenda për Sukën”, që trajton një nga temat më të fuqishme të letërsisë dhe jetës njerëzore: hakmarrjen. Kjo hakmarrje, në tregim, nuk është thjesht një veprim i ndërmarrë nga njerëzit, por një forcë më e madhe që mbin nga vetë natyra, duke nxjerrë në pah një drejtësi transcendentale (epërsi-mbi-fizike) dhe të pandalshme. Përmes ngjarjeve të zhvilluara, tregimi artikulon një kuptim të thellë të konceptit të hakmarrjes, jo si diçka të nxitur nga pasioni njerëzor, por si një energji që lind nga dhimbja dhe padrejtësia. Hakmarrja si drejtësi e natyrës dhe e fatit me Sukën si simbol i lidhjes njerëz-natyrë. Suka përfaqëson jo vetëm një mal të pasur me jetë, por edhe një subjekt a qenie të gjallë, që ndien dhimbje dhe padrejtësi. Pasi digjet nga fushorët, Suka përfaqësohet si një forcë e heshtur që kërkon drejtësi dhe hakmarrje. Ajo shndërrohet në një “hakmarrëse” të natyrës, duke përdorur elementet e saj-drunjtë, lulet, therrat dhe kafshët, për të rivendosur një ekuilibër të humbur. Këtu përmes natyrës, hakmarrja përfaqëson një akt moral, një reagim të pashmangshëm ndaj padrejtësisë së bërë. Kjo drejtësi nuk kërkon ndërhyrjen e njeriut, pasi është vetë natyra që vendos baraspeshën. Kjo shihet në momentet, kur secili nga fushorët, që kanë bërë be (betim) të rreme, përballet me vdekjen në mënyra të pazakonta, duke përforcuar idenë se askush nuk mund t’i shpëtojë drejtësisë së natyrës. Ata, prafushorët në tregim, përfaqësojnë padrejtësinë dhe ligësinë, janë përshkruar si figura të ligësisë dhe manipulimit. Ata përpigjen të përfitojnë nga bujaria e Kodrasve (dhënia e krojeve) dhe shkojnë aq larg sa të zhvendosin kufijtë natën dhe të kallin Sukën, duke ia vënë fajin Avdiut. Këto veprime jo vetëm që tregojnë një mungesë morali, por edhe përforcojnë idenë e tradhtisë dhe pabesisë. Betimet e rreme përfaqësojnë kulmin e ligësisë dhe të përpjekjes për t’i shpëtuar drejtësisë njerëzore. Megjithatë, natyra dhe fati ndërhyjnë për të sjellë një drejtësi

të pashmangshme. Kjo ndëshkon jo vetëm pabesinë e tyre, por edhe shërben si një paralajmërim për të gjithë ata që i shkelin normat morale. Sidoqoftë, nuk vonon hakmarrja, ajo vjen e bie në mënyra të pazakonta, të mistershme dhe simbolike si “hak i Sukës”.Nuk nuk vjen si një akt i shpejtë, por si një proces i natyrshëm që ndodh kur ekuilibri moral i shoqërisë është prishur. Një koncept filozofik i lëvizjes dhe kohës, prezantohet në titullin e tregimit të radhës“Lavjerrësi i kohës”, i cili bart në vetvete një simbolikë të thellë filozofike. Një lavjerrës është një objekt që lëviz herë anej e herë këndej, duke ndjekur një trajektore të përcaktuar nga forcat e natyrës, dhe përfaqëson ciklikën, përsëritjen dhe kalimin e kohës. Lavjerrësi nuk është vetëm një mjet matës i kohës, por edhe një metaforë për iluzionet, pasiguritë dhe pritjet e njerëzve që shpesh varen në mënyrë të pavetëdijshme nga forca përtej tyre. Të lidhur me kohën, lavjerrësi bëhet një simbol i humbjes dhe shpërdorimit të kohës në kërkime që, shpeshherë, nuk kanë përfundim të qartë. Kjo lidhje filozofike aludon për natyrën njerëzore, që shpesh kërkon shpëtim të lehtë, por përfundon duke shpërdoruar kohën dhe energjinë.Në filozofi, ky koncept mund të lidhet me moralin e Sokratit, që thotë se njerëzit shpesh ndjekin gjëra që nuk kanë vlerë reale, por që duken tërheqëse për shkak të paraqitjes. Lavjerrësi është një simbol i pavetëdijes kolektive që e lidh masën njerëzore me instinktin për të ndjekur gjëra të paqarta, të cilat në fund nuk sjellin asnjë rezultat konkret. Koha, në tregim, paraqitet si një element thelbësor apo qendror i ekzistencës. Titulli “Lavjerrësi i kohës” sugjeron një mekanizëm që e mat dhe njëkohësisht e shpërdoron kohën. Kjo metaforë filozofike ngre pyetje të mëdha për mënyrën se si njerëzit e kalojnë jetën e tyre: duke ndjekur dëshira dhe iluzione të kota, apo duke jetuar një jetë të vërtetë dhe autentike. Kështu që, të ndikuar nga lavjerrësi, njerëzit harrojnë qëllimet dhe përmbajtjet e rëndësishme të jetës së tyre, duke humbur një pjesë të madhe të kohës në ndjekje të diçkaje që nuk ekziston. Ky iluzion lidhet edhe me filozofinë e Martin Heidegger-it, që fokusohet në konceptin e “të qenit në kohë” dhe “autenticitetit”- Kohëshmëria është përvoja e kohës nga perspektiva e ekzistencës njerëzore (Qenia dhe koha - Sein und Zeit). Lavjerrësi përfaqëson humbjen e autenticitetit njerëzor, duke i drejtuar individët larg nga vetvetja dhe realiteti.Në qendër të tregimit rri simboli i absurditetit njerëzor, pikërisht në vendin ku ndodh ngjarja, “Fusha e përrallave,» është një simbol tjetër filozofik, që përfaqëson një hapësirë ku realiteti dhe imagjinata përzihen, duke krijuar një ambient që është njëkohësisht joshës dhe absurd. Fusha e përrallave ngjan me një «fushë eksperimentale» ku njeriu përballet me dobësitë dhe iluzionet e tij, duke ilustruar në mënyrë të qartë edhe konceptet e absurditetit.

Tregimi me titulli “Të hëngërt macja” mbart një ironi të rëndë tragjike që e përshkon të tërin. Fillimisht, kjo shprehje përdoret si një lojë dashurie, një përkëdhelje që reflekton pafajësinë dhe dashurinë e pakushtëzuar për Zogën, foshnjën e vogël, buzëqeshja e së cilës ndriçon një botë të përplasur nga vuajtjet dhe brutaliteti. Megjithatë, kjo shprehje e ëmbël, e lidhur me jetën dhe gëzimin, kthehet në një mallkim tragjik. Titulli ngërthen kontrastin e ashpër mes dashurisë së pastër dhe pafajësisë njerëzore dhe fatit të pamëshirshëm që godet në mënyrë të papritur. Ai sinjalizon një paradoks të jetës: ajo që fillon si një shaka dashurie përfundon si një simbol i dhimbjes së pashlyeshme. Thellësia e këtij tregimi na e mban të gjallë kujtesën për të mos harruar të kaluarën! Pra,një thirrje për të mos harruar vuajtjet dhe sakrificat e brezave të mëparshëm. Përmes rrëfimit të plakut, brezat e rinj mësojnë të vërtetën historike për vuajtjet e popullit shqiptar gjatë përndjekjeve dhe spastrimet etnike të regjimit serb, se mbi gjithçka,të mos harrosh të kaluarën është një detyrim moral dhe një formë

mbijetese shpirtërore!Fshati Bilur është këtu simbol i atdheut të braktisur që mbetet i shkretuar dhe i braktisur, përfaqëson atdheun e humbur, një plagë të përhershme për të gjithë ata që u dëbuan. Tregimi “Letra” eksploron në mënyrë të ndjeshme temën e vetmisë, ndarjes, dhe marrëdhënies së njeriut me fatin dhe vdekjen. Përmes një narrative të thurur me elegancë dhe simbolikë, ai trajton dilemat ekzistenciale të individit që, në pleqëri dhe izolim, kërkon lidhje me të tjerët dhe shpresë për një komunikim përtej kufirit të jetës dhe vdekjes. Letra bëhet simboli i përjetësisë së ndjenjave njerëzore dhe e përballjes me brishtësinë e jetës. Më konkretisht, letra e dërguar nga Lam Qyteti paraqet një përpjekje për të kapërcyer kufirin fizik dhe emocional të vetmisë. Përmes marrëdhënies së dy miqve, Lam Qytetit dhe Mal Bjeshkës, tregimi përshkruan nevojën njerëzore për lidhje dhe kuptim. Megjithatë, përmes letrës së fundit, autori na lë të kuptojmë se kujtimet dhe krijimet njerëzore kanë aftësinë të mbijetojnë kohën dhe hapësirën, duke i dhënë kuptim ekzistencës edhe përtej vdekjes. Tregimi “Ara e Mirë” është një përsiatje filozofike mbi përpjekjet njerëzore, rëndësinë e punës, përkushtimin dhe transformimin, por edhe mbi kalueshmërinë dhe ciklin e jetës. Përmes historisë së një familjeje dhe një therrishte të kthyer në arë të mirë. E rëndësishme në këtë tregim është toponimia dhe simbolika, sikurse “Therrishta”, “Zabeli i Rrallë”. “Ara e Mirë”etj. Tregimi “Vdekja duke qeshur shqip” është një krijim i veçantë, i cili shquhet për stilin filozofik, sarkazmin e hollë dhe thellësinë simbolike. Kjo veprë trajton temën e jetës, vdekjes dhe absurditetit njerëzor në mënyrë unike, duke i dhënë një dimension universal një ngjarjeje që përndryshe do të dukej lokale. Me një frymë ironike dhe një mesazh të fuqishëm nëntekstual, tregimi na fton të reflektojmë mbi shoqërinë, ekzistencën dhe kuptimin e vdekjes në raport me botën ku jetojmë. Titulli “Vdekja duke qeshur shqip” është shumëdimensional. Fjalët “Duke qeshur shqip” theksojnë origjinalitetin e tjetërllojshëm të këtij akti. Në një kontekst shqiptar, ku tragjedia dhe humori shpesh ndërthuren, ky titull përfaqëson një formë të veçantë të ballafaqimit me vdekjen. Ajo tregon se, edhe përballë fatkeqësive dhe absurditetit, qeshja mbetet një akt që ruan dinjitetin dhe lirinë. Tregimi përcjell disa mesazhe të ndërthurura, ndër të cilat spikat si më kryesorja, protesta ekzistenciale dhe sociale nga vendimi i personazhit kryesor për të vdekur duke qeshur, e cila është një formë proteste kundër absurditetit të botës moderne. E qeshura, në këtë rast, bëhet simbol i refuzimit të një realiteti të mbushur me padrejtësi, rrena dhe hipokrizi. Duke zgjedhur të vdesë në këtë mënyrë, ai sfidon rregullat e pashkruara të shoqërisë dhe vetë konceptin tradicional të vdekjes. Tregimi “Hapësirë e akullt”, nga i cili emërtohet dhe libri, përmban një dimension të thellë ekzistencial dhe filozofik, duke u ndalur në pasojat e jetës së një njeriu të pashpirt, të larguar nga vlerat dhe ndërgjegjja, i cili në fund përballet me boshllëkun dhe akullin që ka krijuar brenda vetes. Hapësira e akullt është një simbol i fuqishëm i izolimit, pendesës dhe ndëshkimit të brendshëm, një pasqyrim metaforik i shpirtit të ngrirë nga mungesa e ndjeshmërisë, dashurisë dhe humanitetit. Vjen natyrshëm ndëshkimi i ndërgjegjes, duke treguar gjendjen shpirtërore të personazhit, i cili vuan si rezultat i veprimeve të tij të shkuara dhe mungesës së empatisë për botën përreth. Ky është një ndëshkim i vetëshkaktuar: ai është viktimë e veprimeve të veta dhe i botës së brendshme që ka krijuar përmes gabimeve dhe egoizmit. Akulli që ndjen nuk është fizik, por një gjendje e vetmisë ekzistenciale dhe ndëshkimit moral, ku ndjenja e fajit dhe ndërgjegjja e ngurtë e kanë larguar nga çdo ngrohtësi njerëzore. Hapësira e akullt si metaforë e izolimit dhe shkëputjes nuk është vetëm një mjedis fizik, por një realitet shpirtëror.

Personazhi ka humbur lidhjen me botën dhe me të tjerët, duke mbetur një figurë që endet në një ekzistencë të ngrirë, të ftohtë egoiste. “Hapësirë e akullt” është një tregim i thellë filozofik dhe ekzistencial, që përshkruan ndëshkimin moral dhe shpirtëror të një individi të larguar nga vlerat humane. Ky tregim na paralajmëron për rëndësinë e ndërtimit të një jete të pasur me dashuri, mirësi dhe ndërgjegje, në mënyrë që të shmangim një fund të akullt, të ftohtë dhe të vetmuar. Hapësira e akullt është një metaforë universale për alienimin, vetminë dhe pasojat e largimit nga thelbi njerëzor. Tregimi “Sëmundja bashkëkohore” është një satirë sociale e mprehtë dhe plot humor, që vë në pah një fenomen të përhapur në shoqëri: korrupsionin moral dhe shpirtëror që shoqëron pushtetin dhe pozitën e lartë. Tregimi “Dashamirë, ju faleminderit!” përcjell një porosi të fuqishme mbi natyrën njerëzore dhe realitetin e marrëdhënieve shoqërore. Përmes ironisë dhe situatave që ndjekin protagonistin, autori sjell në pah zhgënjimin që shpesh ndodh kur pritet mbështetje nga të afërmit dhe miqtë në momente të rëndësishme. Prandaj, shpeshherë, zhgënjimi nga të tjerët na mëson se duhet të mbështetemi kryesisht tek vetvetja! Tregimi “Ëndërr me ëndrra” është një rrëfim alegorik dhe satirik, që në thelbin e tij trajton temën e udhëheqjes, realitetit politik dhe iluzioneve të mëdha të individëve të përfshirë në skena publike e politike. Përmes ironisë, paradoksit dhe figurës groteske të gomarit, autori flet për realitetin e hidhur të politikës, ambicieve njerëzore dhe ëndrrave të rrejshme që shpeshherë shndërrohen në zhgënjime. Autori përçon një kritikë të thellë ndaj shoqërisë dhe klasës politike, duke përdorur metafora dhe simbole të forta për të zbuluar hipokrizinë, dështimet dhe mënyrën se si individët e përfshirë në pushtet shpesh harrojnë realitetin e popullit që përfaqësojnë. Njëkohësisht, autori thekson mënyrën se si politikanët janë të prirur të krijojnë iluzione dhe ëndrra boshe, të cilat, në fund, rezultojnë të pakuptimta. Udhëtimi i protagonistit me gomar përfaqëson mënyrën “e ngadaltë” dhe të pashmangshme të trajtimit të çështjeve të mëdha politike, ku zvarritja dhe premtimet pa fund zëvendësojnë veprimin real. Më pas ronia dhe satiraqëndron te përpjekjet e protagonistit për të përfaqësuar popullin dhe për të trajtuar çështje madhore, ndërkohë që realiteti i udhëtimit me gomar dhe dështimi për të arritur rezultate konkrete ekspozon absurditetin e kësaj përpjekjeje. Apo pritja me ovacione në sheshe dhe pritjet e mëdha në Shtëpinë e Bardhë, ironizojnë mënyrën se si njerëzit dhe liderët shpesh fokusohen te detajet e parëndësishme. Tregimi “Intelektual i pavarur” është një kampanë kritike ndaj sistemit politik. Shkurt e shqip, përmes përvojes së Emilitt, autori kritikon realitetin e polarizuar politik. Në një shoqëri ku grupet politike janë shpesh të interesuara vetëm për pushtet dhe përfitime, të mbetesh «intelektual i pavarur” është një akt rezistence dhe dinjiteti. Përmes tregimit të tij, autori rishqyrton mbi rëndësinë e ruajtjes së vlerave personale në një mjedis të politizuar dhe të polarizuar. Si epilog finalizues, tregimet e librit “Hapësirë e akullt”, ngjallin larmi emocionesh, situatash dhe refleksionesh që tejkalojnë përditshmërinë, duke u ndalur në ato momente kyçe kur njeriu përballet me vetveten dhe realitetin përreth. Përmes një ndërthurjeje mjeshtërore mes ironisë, dramës dhe simbolikës, autori i jep lexuesit një pasqyrë të fuqishme të sfidave ekzistenciale, shpirtërore dhe sociale. Tregimet e Karadakut janë më shumë se rrëfime, ato janë thirrje për ndërgjegjësim dhe reflektim, duke e shtyrë lexuesin të shqyrtojë vlerat, marrëdhëniet dhe rolin e tij në një botë ku shpeshherë njerëzorja vihet në sprovë. Me një stil të veçantë dhe një botëkuptim të thellë, këto rrëfime,në fund, na kujtojnë se edhe në hapësirat më të akullta të shpirtit, gjithmonë ekziston mundësia për të kuptuar, ndryshuar dhe gjetur kuptimin e vërtetë të jetës.


Recension

SHKRIME TË NJË RËNDËSIE TE VEÇANTË

(Prof. dr. Mehmet Ahmetaj, KUNDRIME GJUHËSORE, Instituti Albanologjik – Prishtinë, 2023)

Dr. Faton KRASNIQI

Ky vëllim i profesor Mehmet Ahmetajt përmban varg punimesh studimore, shkencore, kumtesash, artikujsh, thesaresh leksikore, materialesh onomastike, etnografike, terma etnografikë dhe toponomastikë. Në këtë libër janë përfshirë punimet e botuara më parë në revista të ndryshme shkencore, si: Gjurmime albanologjike - seria e shkencave filologjike; Gjuha shqipe; ASHSH, IGJLSH-Konferenca shkencore “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot”; Studime historike - ASHSH, Instituti i Historisë; revista “Lemba”(Art Club-Ulqin); Gjuha jonë - ASHSH, IGJLSH; Fjala jonë; Koha-revistë për art, shkencë, kulturë dhe çështje shoqërore; Rilindja; Koha Ditore; Jehona-Shkup; 50 vjet studime albanologjike-IAP; Meshari i Gjon Buzukut monument i kulturës shqiptare/ Material nga sesioni shkencor, Ulqin, 1995; Dija-revistë për shkencë, kulturë, art - Ulqin etj. Studimet e profesor Mehmet Ahmetajt paraqesin një kontribut të rëndësishëm shkencor për gjuhësinë shqiptare. Në këtë libër kanë gjetur trajtesë edhe një numër kritikash, kronikash, recensionesh, ekspeditash kërkimore - shkencore si një veçanti në fushën e dialektologjisë shqiptare. Në trajtesat e tij shkencore, e në veçanti për toponomastikën e territoreve etnike shqiptare, në Mal të Zi, profesor Mehmet Ahmetaj ka bërë një punë studimore disavjeçare, shkencore si në rrafshin historik, gjuhësor etnik e gjeografik dhe ka sjellë rezultate shumë të rëndësishme për gjuhësinë shqiptare. Për t’i realizuar punimet e tij shkencore dhe trajtesat në fushë dialektologjisë, për subjekt vështrimi profesor Ahmetaj zakonisht



i ka marrë pleqtë dhe plakat, e sidomos femrat e lindura e të martuara përbrenda trevës, përkatësisht bajrakut të Anës së Malit, sepse, sipas profesor Ahmetajt, gratë janë më konservative se burrat, meqë nuk kanë lëvizur jashtë krahinës së atjeshme dhe e ruajnë shumë më besnikërisht gjendjen e moçme të gjuhës së gjallë të folur, me të gjitha tiparet, specifikat e veçantitë e saj të gurrave dialektore autoktone. Profesor Mehmet Ahmetaj për të realizuar veprat e tij si dhe punimet shkencore, në vazhdimësi ka realizuar ekspedita kërkimore – shkencore ku tradicionalisht ka mbledhur lëndë dialektore në më shumë se 17 pika vendbanimesh të krahinës së Anës së Malit, trevë kjo veriperëndimore e truallit gjuhës të shqipes. Vlen për t’u theksuar se për realizimin dhe argumentimin veçorive të fushave të ndryshme gjuhësore të

shqyrtuara në punimet studimore të tij, profesor Ahmetaj ka pasur një material shumë të pasur dialektor. Në studimet e tij, ai ka bërë një përshkrim sinkronik, e herë – herë diakronik të ligjërimit popullor të Anës së Malit, që i ka pasur objekt studimi dhe trajtimi të veçantë në të gjitha sferat, përkatësisht rrafshet e saj. Si studiues dhe gjurmues i përkushtuar e i palodhur, ai në vazhdimësi ka sistemuar materiale të rëndësishme lëndore e shpirtëror, me vlerë të shumanshme, nga fusha e etnografisë, mitologjisë, folklorit, historisë, arkeologjisë, ilirologjisë e paganizmit. Nga veprat e tij, studimet e tij, veç tjerash, lënda leksikore e këtyre trevave, pothuajse në mënyrë tërësore, përveçohet për origjinalitetin, ngjyresën e ligjërimit popullor, figuracionin stilistiko – gjuhësor, përkatësisht autoktonitetin vazhdimësor të birësisë iliro – shqiptare.

Në fokusin e studimeve të tij profesor Ahmetaj kryekëput ka pasur arealin truallor etnik të ligjërimeve shqiptare të Ulqinit, të Anës së Malit, të Shtojit, të Bregut të Bunës, të Tivarit, të Shestanit, të Briskut, të Krajës, të Tuzit, të Hotit, (Trabonit të Moçëm), të Grudës, të Trijepshit, të Kojës, të Plavës e Gucisë, të Rozhajës. Gjithashtu në studimet e profesor Ahmetajt, kanë gjetur trajtesë të thellë dhe të thukët një mal i tërë antroponimesh, toponimesh, topleksemarsh, ojkonimesh, hidronimesh dhe tumash. Profesor Mehmet Ahmetaj, përpos kësaj vepre ka botuar edhe disa vepre me rëndësi për dialektologjinë, frazeologjinë dhe onomastikën shqiptare, si: 1. Studime gjuhësore II (Dialektologji), bashkautor, Prishtinë, 1996; 2. Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi, Prishtinë, 1996; 3. E folmja e Plavës dhe e Gucisë, (monografi), Prishtinë, 2002; 4. Gjurmime Onomastike (përmbledhje punimesh), Prishtinë, 2009; 5. Fjalor Onomastik i territoreve shqiptare në Mal të Zi, Prishtinë, 2017.

Shënime për autorin: Mehmet Ahmetaj u lind në Vuthaj të Plavës dhe të Gucisë më 1946. Shkollën fillore e kreu në Vuthaj – Guci, kurse të mesmen në Pejë. Fakultetin Filozofik, Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, e mbaroi (1974) në Prishtinë. Gjithashtu në Universitetin e Prishtinës u magjistrua (1974) dhe u doktorua (2000) në shkencat filologjike (në fushën e dialektologjisë shqiptare). Ai që në krye të herës punoi në arsimin e mesëm si profesor i gjuhës shqipe, në Podujevë, në Prizren dhe në Lipjan dhe si bashkëpunëtor shkencor në Institutin Albanologjik – Prishtinë.

Profile: Goliarda Sapienza

MES SHKËLQIMIT, HARRESËS DHE KUJTESË

Sapienza nisi të shkruajë rreth kohës së dhimbjes të humbjes së nënës (1953). Shkroi për herë të parë poezi. Me kalim-in e viteve, shumë gjëra në jetën e saj u bënë të pakëndshme

Xhahid BUSHATI

Sapienza u lind më 10 maj 1924 në Katania, Siçili; nga Maria Giudice (1880-1953) dhe Giuseppe “Peppino” Sapienza (1880-1949). Giudice, ishte një gazetare e shquar, me origjinë nga Lompardia dhe aktiviste e shquar feministe. Goliarda ishte fëmija i dytë i çiftit Sapienza. E kaloi fëmijërinë në një mjedis feminist, por jo-konformist. U hoq nga sistemi formal shkollor, kur ishte 14 vjeçe. Shkollohej në shtëpi. Sapienza i mësoi vetes dramën, pianon dhe rikrijoi filma që kishte parë në kinema, sipas perceptimit dhe imagjinatës së saj. Në vitin 1941, në moshën 16-vjeçare fitoi një bursë për të studiuar teatër në “Accademia d’arte drammatica” në Romë. U transferua atje, e bashkëshoqëruar me nënën e saj. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Sapienza filloi karrierën si aktore teatri, duke u dalluar në rolet e personazheve të Pirandelos. Ajo, gjithashtu, aktroi në disa filma (seriale)e inkurajuar nga Alessandro Blasetti. Për shkak të personalitetit të saj në talentin e aktrimit, u bë një figurë qendrore në kinemanë neorealiste. Në vitin 1947, u takua me regjisorin neorealiste të kinemasë Francesko Maselli. Me të hyri



në një lidhje që do të zgjaste afro 20 vjet. Më pas ndahen. Sapienza nisi të shkruajë rreth kohës së dhimbjes të humbjes së nënës (1953). Shkroi për herë të parë poezi. Me kalimin e viteve, shumë gjëra në jetën e saj u bënë të pakëndshme. Për këtë shkroi dy kujtime radhazi. U botua në Lettera Aperta” (1967, për fëmijërinë e saj) dhe në “Il Filo di Mezzogiorno” (1969), për përvojën e saj në psiko-analizë. Këto janë përshkruar si përpjekje për të rindërtuar kujtimet e shkatërruar nga elektroshoku.

Iu kushtua tërësisht shkrimit. Vepra e saj “Arti i gëzimit” mbetet kryevepra e saj në krijimtarinë letrare. Iu deshën 9 vjet për ta përfunduar (1976). Ishte një roman historik, me prirje monumentale. Për shkak të trashësisë së librit (mbi 700 faqe) dhe portretizimit të një gruaje të papërmbajtur nga morali konvencional dhe, mbase, e papërligjur në rolet dhe funksionet e mentalitetet tradicionale që përfaqësonin shumë personazhe-femra, u refuzua nga botuesi. Realisht nuk gjeti një botues për gjatë jetës së saj. Do të kujtojmë

një moment nga jeta e trishtë e saj: Shkroi një rrëfim të kohës së saj nga burgu. U botua në “L’Università di Rebibbia” (1983) dhe pati një sukses të vogël. Në vitet e fundit të jetës, dha mësim aktrimi në “Centro Sperimentale di Cinematografia” në Romë. Shkroi vepra të tjera letrare, disa prej të cilave mbeten të pabotuara. Pas vdekjes së saj, bashkëshorti Angelo Pellegrino financoi botimin e plotë (1998). Disa vite më vonë, u dërguan disa kopje në Panairin e Librit në Frankfurt. Romani u vu re nga një redaktor gjerman, i cili besonte se ishte një kryevepër e harruar. Redaktori gjerman ia kaloi një redaktori në Francë. U shitën 300 000 kopje. Suksesi i botimeve të saj (pas vdekjes) në Francë, Gjermani dhe Spanjë bëri që Sapienza të krahasohej me D.H. Lawrence dhe Stendal. Si përgjigje, Sh. B. “Einaudi” botoi një vepër të autores. Më pas kjo Shtëpi Botuese çoi për botim romanin “Io, Jean Gabin” (2010, vepër gjysmë-autobiografike), dy përmbledhje me poezi, tregimin “Elogio del bar”... etj., etj. Në vendlindjen e saj, në Katania, si dhe në Palermo, Gaeta dhe Linguaglossa; rrugët dhe sheshet kanë emrin: ‘GOLIARDA SAPIENZA’.

JANA SHKOI NË PRAGË

Jana shkoi në Pragë duke e mbyllur në një sirtar gjithë ëmbëlsinë e kristaleve të tij bohem, ndihet i bllokuar, i mbyllur nga çdo kafaz, dhe, duke qëndruar në dritare, duke përqaftuar hekurat, ajo vëren me kureshtje komoditetin e moslirisë.

Jana shkoi në Pragë duke vendosur të gjitha pikturat e tij, idetë e tij, në çantën e tij, interpretimi i tij i trishtuar i egërsisë brutale të çdo mashkulli, i gozhduar në letër, i dënuar, si një organ i thjeshtë, për të luajtur në kisha gjatë funeralit, për të bartur mosbesueshmërinë e hormoneve të dikujt si gurët e Tantalit.

Jana shkoi në Pragë me një zemër të dekurajuar nga mërzia e vetmisë, duke harruar guximin e ne shpirttrave të lirë në rezistimin ndaj shitjeve ose shitjeve të emocioneve, duke moderuar instinktet tona për kënaqësi, mban fort në duart e artizanatit të saj, të ftohta pasi duart e vajzave të Karlovy Vary mund të jenë të ftohta, vizatimet e një dragoi, shenjat prerëse të dashurisë së vajzës së tij vendoseni, sikur të ishte qelibar, në plastikën e fortë të një lodre seksi.

Jana shkoi në Pragë me buzëqeshjen e tij si një diamant i humbur në një kopsht për të vënë në dyshim vlerën e saj të padiskutueshme përballë një gote verë dhe turpi, sikleti i dhimbshëm i neve të pistave, kur përpiqemi të shlyejmë skllavërinë tonë me këste, duke u besuar në krahët e atyre që na tregojnë pak interes.

Jana shkoi në Pragë dhe nuk e di nëse do të kthehet. ende më deh me shijen e buzëqeshjes së tij me ngjitjen e parfumit të tij, me entuziazmin e lëkurës së tij, Jana shkoi në Pragë dhe unë do të jem atje, me të.

BRONKOPNEUMONIA

Ti erdhe nga tokat e errëta të Lindjes së ftohtë, e djegur nga zjarret ndriçuese të Jan Hus dhe Jan Palach - më kujtojnë tingullin e paqartë të emrit tënd që ende nuk di të them, se ende nuk di të bërtas, ti erdhe me një thes plot me punët e mia herkuliane pa mundur të ndërroj sytë e tu me sytë e mi, pa mundur të shkrihem nën goditjet e shijes gërryese të frymës sime (gjuha më pritet, gërryhet, digjet).

Shpirtrat binjakë nuk kanë nevojë për dy shpirtra, përplasen si trupa në betonin e tokës, ata përplasen për faturat për të paguar, për llogaritë e tepërta, për jetën në bilanc, shpirtrat binjakë nuk kanë nevojë për dy trupa për t’u futur, duke u rrotulluar me epsh në shtretër të lagësht mbi të cilat mbeten të ngulitura shenjat e zinxhirëve, Shpirtrat binjakë nuk kanë nevojë për dy mendje, Shpirtrat binjakë nuk kanë nevojë për dy tru, shpirtrat binjakë nuk kanë nevojë për dy zemra.

Fluturove si filladi i fantazmës së një dashurie të brishtë duke më lënë detyrën të marr copat e gjuhës sonë të re: italisht - anglisht - český, në një treshe që, në mënyrë të arsyeshme, do të karakterizojë historinë tonë, të përballem me frikën tënde për të dashuruar dhe paaftësinë time për t’u dashuruar,

kollitje, të vjella gjaku, djegie (dy muaj?) të një bronkopneumonie të pandalshme dashurie.

Binjakët e shpirtit nuk kanë nevojë për asgjë, mjaftojnë në vetvete, figurina të dyfishta mbivendosur në albumin e kujtimeve të jetës, për të nxjerrë në pah një moment të shkëlqyer lumturie në preken e një Zoti që mbledh kufomat dhe përvojat e të tjerëve, në Milano, në Karlsbad ose në Milansbad.

RINO

Përpara se kritikët të kuptojnë se ekziston Më duhet të bëj fundin dramatik të Rino Gaetanos, pa jastëkun e ajrit që mbron shoferin pa kohë më kapur dorën.

Prekja, prekja, prekja e tasteve rrih fort, rrih përsëri me shfaqjen e studiuesve akute që do të ndryshojë modelin siç është tani.

Dhe ndërkohë shkruaj duke qarë me lot kanelle, në zemrën time gruaja që përziu kromozomet e mi, Më duhet të jetoj me shikanë si në një pistë hipodrom, me një thikë midis dhëmbëve për të shqyrtuar të gjitha aksiomat e mia.

Nuk jam i sigurt se mund të mbijetoj pas kaq shumë vuajtjesh dhe dhimbjesh, më së shumti do të më gjejnë të vdekur, vjen për të nuhatur erën time të keqe.

HEPATITI IVA

Tatimpaguesi mesatar italian midis taksave, detyrimeve dhe akcizave vuan kafshimet stoike dhe apelon më keq se në Gjykatën e Asizave, duke lundruar gjithnjë në gjendje të rëndë, e shpallën shenjtor dhe kundrejt djegieve të faturave tatimore vesh një kostum azbesti.

Hepatiti IVA është një sëmundje shumë ngjitëse, pyka fiskale ka funksionin e një kateteri pa hipotenuzë, kullimi i lëngjeve nga vrimat e zeza të llogarive rrjedhëse nuk është mburrje ideja për t’i bërë bashkëqytetarët e vuajtur të ulen deri në vitet nëntëdhjetë.

Metafora e kullimit, ndaj shtetit italian, nuk është e çmendur, Agjencia e të Ardhurave na i kthen pantallonat si një prokurë e paëpur, sëmundja tashmë është kronike, taksa e sheshtë mbetet si terapi qetësuese qetësia e sheshtë e tregjeve ndërkombëtare nuk na e bën të lehtë relaksimin,



ndërmjet kursimit të 5,000,000 italianëve ose rritjes së përhapjes zgjedhja është aq e thjeshtë sa nuk do të duhej një Dredd, le të shpresojmë që një Dr. Sottile e re të mos lëshojë tërheqje të detyruara në 6% të llogarive rrjedhëse të fatkeqve të zakonshëm.

BURRAT PA MBIEMRA

Burrat pa njerëzi nuk kanë mbiemra, ata jetojnë, të pakuptueshëm, si një numër i vetëm gjysëmbisquavers, duke kultivuar kopshtin e tyre të vogël të mjerueshëm, dy dhoma gjumi dhe një banjë, në kërkim të amnistive të përsëritura, mbi pronat shtetërore.

Burrat skllëvër të indiferencës nuk kanë mbiemra, na imunizojnë, të kota, si shpretka në bark me zjarr, interes, solidaritet civil, duke e kthyer egoizmin e stilitit në një stil.

Burrat pa inteligjencë nuk kanë mbiemër, ata godasin me çekić, propagandistik, me arrogancën e një reklame, duke dënuar botën ndaj ekspozimit ndaj 100,000 röntgen me sjelljen mashtruese të piramidës së Khafres.

Burrat pa mbiemra quhen Roberti, Lorene, Glorie, ata duhet të jenë mbytur në hektolitra damnatio memoriae, ata nuk duhet të përfshihen, Mario Chiesas i ri, sepse hedhja e vlerave tona në tualet nuk është një ndërmarrje e mirë.

NËSE DO TË KISHA LEJE

Nëse do të kisha leje të të shkruaja, Unë do t’ju thoja që nuk besoj në mrekulli, që i lexova, me lot, të gjithë artikujt tuaj me një gungë që më mbyt nga ngjitja e tentakulave të saj.

Unë pi ananas Santal Plus dhe kokos, Kohët e shkrimit tim pa lëng kanë ikur Unë jam rritur, një kukull e lirë, Unë nuk i përdor më tre vargjet e mia, në mapi.

Edhe nëse përfundoj në mat, në ekzistencë, ju e dini, unë nuk strehohem Unë punoj shumë, por nuk punoj shumë Përplasem me jetën dhe nuk mavijohem.

Tregim/ Musine KOKALARI

NJË QEN QË HAMULLIT NUK HA

- Urdhëro, urdhëro brënda, zotrote je e shtëpisë, urdhëro këtu, ku rrimë vetë, ne jemi t’onat. Na humbe, s’na ke dalë fare, na u-harrove’ si katënxhika, si unë thamë se mos ishe gjë sëmurë.

- Eh! biró, mirë thua, kur është puna e pasosur, nuk të dilet. Moj vjehrën Razo ku ma ke? Gjëthënjë rrëzave e gjej, s’e shoh kurrë në shesh’ si ka urdhëruar Perëndija, vërc andej, vërc këndej, gjithë ditën e ditës në këmbë, si me nuse, si pa nuse, një-lloi. U! ja tek më vjen kapetanja, hë hë! se ç’m’i ka përveshur duart gjer në rrëzë, se ç’ma mban futanë në bres pa eja, pa eja, se më mori malli, ne u-bëmë për t’u puthur. Ç’po bën? Ke zënë nga hullimi? Duket je bërë kok’ e këmbë me miell’ pse s’më thua, do të bëç birek, dhe të kreve nga puna.c

- Ulu, Xhevro, pa e mbaron nusja, se në të mbaruar e sipër është, dhe di petë kanë mbetur’ ulu, ulu’ kur erdhe e kur do të ikëç, ne akoma s’jemi pjetur.

- Mirë thua, moj Razo’ po, po u-shtrova unë, dreka do të më ngrejë këtej. Si je? Gjithë mirë? Aganë me shëndet?

- Mirë, desh Perëndija, përgjigjet Xhevrua.

- Djalin, nusen?

- Mirë të marrin dorën.

- Fëmilën? Me shëndet si ju venë? I zuri gjë fruthi, se hiqet shtëpi më shtëpi? Beqirit i shkoi llafostija? se herën e fundit e laçë krodhë?

- Ja ashtu, plagë e ka’ thomi sikur i mbillet, po prapë i rrjeth. Hoqmë lemerinë.

- Motrën e ke parë gjë, të ka ardhur, a i ke vatur? Kartë na djali ka marrë, parà i ka dërguar?

- E, ç’ka, herë dërgon e herë jo, me buzë të plasur.

- Vajza deshi Zoti shpëtoi mirë dhe ajo foshnjë pastë këmbën e mbarë, jetë të gjatë dhe me djelm këtej e tutje. Jam turpëruar, po tri ditë kam q’e kam marrë vesh.

- Të mirë paç, zënëç dhe nga djemt, nga vashat, dhe gjithëkush nuk ka, iu përgjegj teto Xhevrua.

- Nuse, bjemë një ujë, se plasa, m’u bë gola shkrum është xhuxhullja jashtë. U ngrita që pa gdhirë, për të mos më zënë dielli’ po sa erdha ndënë kala, leu’ dhe që na pazari i druve e gjer këtu e kisha mbi kokë. Shi! Ju thom dhe një herë, në keni punë, më thoni t’iki, pa unë jam e shtëpisë dhe s’më vjen keq, dal dhe bëj të tjera hatëre.

- Jo, jo, Razo, të keqen, të thaçë, për kokë të fëmilës, tani do t’i flitnja nuses t’i mbaronte ajo, se vetë kisha për të qepur, pastaj do të zë nga xhurapet, se, ja, na erdhi dimri.

- Kur është kështu, moj Xhevro, do të



shtrohem dhe të kuvëndojmë. Nuse, se të ktheva prapë na udha, hiqma këtë ferexhenë, se e kam të trashë. Më iku dhe jemeniu na koka, nuk e di pse më ranë dhe leshrat fare, mbeta si kacidhjare, shi! di fille...

U-ulnë të dija mbi çilte, e pjeti dhe Xhevrua na ana e saj. Ishin di shoqe që të jetës. Ishin martuar, me një griké fëmile dhe dashurin’ e parë s’e kishin harruar. Razos i gëzohej shpirti që Xhevrua e kish nusen të mirë, pastaj ja kish bërë vetë krushqinë. Andej këtej, më së fundi i thotë Razua Xhevros:

- Moj, e ke parë gjë Nazon, të ka thënë gjë për mua? Jemi prishur bashkë, as vete, as më vjen. S’më ka shkelur në derë që në Bajramin e math. U-prëçë, se atë doja dhe unë, dhe si kisha nonjë fal.

pjeta atë më parë, asaj i shpunë kafenë. Kësaj i kish ardhur rëndë: “si unë më e madhja dhe të nderojnë atë?” E ku i di unë vjeçt e botës? Ec e mbushi menden. Me t’i dëgjuar këto fjalë, i dërgova një njeri në shtëpi dhe i thaçë që prapë këtu të mos më shkelë, se nuk e dua. Për të folë mos qoftë, s’më ka ardhur prapë.

Duke shkuar vitet, sa vete e shkundet fare. Mbeti gjithë ditën e ditës udhëve. Shtëpi-prishur. Na, i ka dhënë Zoti një nuse, që bota ja kanë zili. Përgjërohet mëhaleja për të, është si prifti pa gjuhë. Kurrë nuk e kanë dëgjuar të ketë bërë fjalën di, dhe me atë burrë godo, djalë i nënës. Shtëpinë e mban bus po ja bën vjehrëzeza, që mos qoftë më mirë, jasht’ e brënda kurkut pllëc ati e pllëc këtu me ato këmbë.

- U! lere, ç-ma zë në golë, shtoi teto Xhevrua. Lipsma se s’e shoh dot, java shtatë dhe ajo tetë. Unë kurrë s’i kam shkelur në shtëpi. Nuk edi se ku e ka fare, nuk e marr vesh se ku e ka gjetur gjith’ atë dashuri për mua që më tregon. Jemi zënë e jemi bërë lakra, kush e di sa herë, me gjith’ atë nuk shkojmë ditë pup, me suke prapë. Më ra në qafe, njatë nuk shkojme dite dëgjo mullirin e kafesë. Kaqë herë kam bërë sikur nuk kam qënë këtu unë, s’ka gjë. Kërcen prifti nga belaja dhe unë kështu e kam ketu Kam krier djalin t’i thotë se kam dale si përgjigjet e pres pësuar shumë herë. Dua, s’dua i dal, ç’të bëj. Më vjen që ta zë ndonjë ditë nga krahu dhe t’i thomë ec e mos të të shoh më këtu. Ësht’ e mërëzitur. Më tha e më tha për ti, po kush e dëgjo, kush i ka kokën... e... e’ ja bëj e shko tutje. Ç’t’i flaç, thuaj për njërën, thuaj për tjetrën. Fut fite andej, fut fite këndej, bjer e shpjer fjalë. Atje ku jam unë të gjitha e njohin dhe s’i var njeri veshin, pa kur ikën të gjitha e munxosin na prapa.

- Ësht’ e marë dhe për vehten e saj. Nuk mblidhet çikë në shtëpi, po mbeti udhëve. Nuk shikon që me një i bie çatija, që do t’i zëjë brënda të gjallë. Grisi dhe këpucët, po ato para ja blen dhe fëmilës bukë që vështrojnë duart e botës. Oh! moj Razo, një qen që hamullit nuk të ha, ashtu e pësoi dhe ajo, që fëlliq golën e saj dhe bëhet lodër e së tjerëve. Kokën që ka ashtu le të pësojë, si do që i vjen keq njeriut. Po ç’t’i bëç?

Ta lemë këtë fjalë se na ropi kokën, vjen të vemi tek Xha Ivziu për të folë, se për një javë janë të gjashtë muajt dhe unë s’i kam vatur akoma, atë të bëç.

- Mirë thua, ngreu të vemi. Një të veshur dhe dualinë të dija bashkë.

Tregim/Tatjanë DISHNICA

QENI NËN HIJEN E VDEKJES

Në një qytet të ngrirë nga mjegullat e vdekjes së madhe, ku çdo gjë kishte marrë një ngjyrë të dëshpëruese dhe ku çdo lëvizje bëhej si në ëndrrat e makthshme, një ngjarje e çuditshme u shfaq për të ngelur përjetë si një kujtim absurdi. Në mes të errësirës së një bote që po mbyllej në sëndukun e përjetësisë, një qytetar i zakonshëm, që nuk mund të thuhej se kishte shumë lidhje me jetën e përditshme të të tjerëve, e ndjeu se diçka e çuditshme do të ndodhë. Pati një ndjenjë të lehtë, si ai i një zogu të vogël që fluturon për here të pare përtej çerdhes së vet për të zbuluar diçka që ai nuk mund ta kuptonte ende. Një mëngjes të ftohtë, i ngarkuar me një ndjenjë të pandërprerë trishtimi, ai kaloi përpara shtyllës së betoni të lagjes së tij, një shtyllë ku gjithmonë ishin vendosur njoftime për funerale. Atë ditë, megjithatë, nuk ishte si çdo ditë tjetër. Të katër njoftimet e zakonshme e të zymta, ishin këtu. Këto njoftime vdekjeje ishin më shumë se sa thjesht një shenjë e humbjes. Nën çdo fletë, në çdo foto,


fshiheshin dhimbjet e jetëve të shkurtra që ngjallnin përmbysje. Pas njoftimit të katërt mbi një te ri të vdekur, një tjetër lajmërim u ngjit në shtyllën e betontë. Lajmërimi kishte një foto të një qeni të madh dhe të pamëshirshëm, një bulldog që shikonte drejt kamerës me një shprehje të dhembshme, që as që mund të kuptohej. Njoftimi ishte i thjeshtë: “Me dhimbje njoftojmë se kemi humbur Qenin tonë të dashur, Xhoni, 2 vjeçar. Kush e gjen dhe na njofton shpërblehet me 250 euro!” Dikush kërkonte vëmendje për një qen, në një periudhë kur njerëzit po humbnin të dashurit e tyre, kur gjithçka ishte kthyer në një lemeri. Ky lajmërim, i shpërndarë në mes të pasigurisë dhe tmerrit të pandemisë, ishte si një goditje fatale mbi një kryq të improvizuar me ashkla drunjësh të kalbur që po ngulej thellë në shpirt. Një zonjë plakë, që po kalonte aty pranë, nuk u durua pa e ngjitur në atë shtyllë betoni një kundër-njoftim. Ishte një thirrje për ta trazuar logjikën, një ngjarje që kishte nevojë për

një kuptim më të thellë. Ajo shkroi diçka të thjeshtë dhe të shkurtër, një fletë të vetme që do të përmbante më shumë sesa thjesht një mesazh të zakonshëm: “Qeni juaj u gjet. Është i sëmurë me Covid dhe është në reanimacion. Mjekët e spitalit të stërmbushur me të vdekur nga pandemia rekomandojnë urgjentisht dërgimin në Turqi... Ju lutem, nxitoni!” Ndërsa po kthehej në shtëpi, pronarit të qenit VIP i ra në sy ky kundër lajmërimi! Sakaq, e ndjeu të panevojshme çdo përpjekje për t’u shndërruar në heshtje, çdo përpjekje për t’u fshehur nga një realitet që e kishte bërë të huaj për veten. I shpërtheu një e qeshur e çuditshme, e thellë dhe e lënduar. Pastaj, iku me vrap nëpër shtigje të padukshme, si një erë që ngrihej nga dheu i shkrirë i qytetit që po shndërrohej në varrezë kolektive. Sërish, si një fantazmë e mjegullt, do të shfaqet para shtyllës së lajmërimeve mortore. Duke kërkuar të shpëtonte një jetë që nuk po kërcënohej nga askush e pa veten të ngatërruar në një luftë të brendshme.

Nuk ishte një luftë mes tij dhe të tjerëve, por mes tij dhe të gjithë asaj që nuk mund ta kontrollonte më. Ishte një betejë që, gjithnjë e më shumë, ngjante me atë të një deti të paqëndrueshëm që lëvizte gjithçka në përpjekje për të arritur një port të humbur. Dhe kështu, i zbërthyer nga e gjithë kjo valë e paqëndrueshme që tërhiqte gjithçka, ai e kuptoi se kjo ishte një luftë që nuk duhej të fitohej, por duhej të përjetohej. Ishte një betejë për një thjeshtësi që shpërtheu në çdo hap të jetës, një thjeshtësi që mund të ishte më shumë se një periudhë. Dhe kështu, ai, duke qëndruar në atë rrugë të ngatërruar të qytetit të ngrirë, para asaj shtylle të zisë, e kuptoi se ndoshta një ditë, do të mund të kthehej në një jetë më të thjeshtë, në një jetë që do të kishte kuptimin e këmishës së vdekjes dhe shiritit filmik të kujtesës që ruan dashurinë që ishte më e fuqishme se çdo absurditet.

Bisedë me Mahmoud Shukair, shkrimtar palestinez

TË SHKRUASH PËR FËMIJËT E PALESTINËS



“Mahmoud Shukair jo vetëm që po ndriçon botën arabe për Palestinën, ai po ndriçon botën mbi veten e tyre”, Yousef Khanfar, themelues i Fondacionit “Palestine Prize”

Nga Shereen MALHERBE

Mahmoud Shukair është një gjigant letrar në letërsinë arabe dhe palestineze, me një katalog të gjerë dhe mbresëlënës të veprave letrare që përfshin mbi tetëdhjetë tituj, të botuar në mbarë botën në dymbëdhjetë gjuhë të ndryshme. Ai është fitues i disa çmimeve, duke përfshirë Çmimin “Mahmoud Darwish” për Lirinë dhe Kreativitetin (2011) dhe Çmimin “Jerusalem” për Kulturën dhe Kreativitetin (2015). Romani i tij i vitit 2016, “Lavdërimi për gratë e familjes”, u nominua për Çmimin “Arab Booker”. Në prezantimin tim të parë me të, ai ishte ulur në një divan, me një perde të bardhë të varur mbi një dritare me hekura, ndërsa muzgu i butë i Jerusalemit të tij të dashur përshkon. Ai duket i sofistikuar me një këmishë blu dhe xhakëtë ngjyrë bezhë. Një fotografi e familjes së tij me kornizë ari varet në murin pas tij. Ai jeton në Xhabal el-Mukaber, një periferi e Jerusalemit, njëzet metra larg shtëpisë ku u lind. Unë e prezantoj atë në këtë mënyrë, sepse të kuptosh Shukairin do të thotë të kuptosh lidhjen e tij të thellë me Jerusalemin, një pjesë integrale (e pandashme) e jetës së tij. Megjithatë, puna e jetës së tij dhe akti i të shkruarit kanë pasur ndikime të thella, që kanë ndryshuar jetën në sigurinë dhe lirinë e tij. Kërkoj të zbuloj se çfarë e bën një gjigant letrar të vazhdojë të shkruajë kundër të gjitha gjasave dhe nën një pushtim brutal. Unë besoj se ka shumë shkrimtarë në një njeri dhe pasi studiova veprën e Shukairit, dallova katër faza në jetën e tij letrare. Ishte një nderë i madh të zbuloja më shumë për jetën, veprën e tij dhe kremtimin e arritjeve të tij, së fundmi fitoi Çmimin Palestinez për Letërsinë.

TË SHKRUASH PËR FËMIJËT PALESTINEZË QË JETOJNË NËN OKUPIM

SH. MALHERBE: Mahmoud Shukair, urime që u bëtë një laureat i Fondacionit të Çmimit “Palestine Prize”. Roli i Fondacionit “Palestine Prize” është “të ruajë, mbrojë dhe promovojë ëndrrat dhe arritjet palestineze”.

M. SHUKAIR: Faleminderit, kolege, autore Shereen Malherbe dhe faleminderit Fondacionit “Palestine Prize” që më nderoi me këtë çmim.

SH. MALHERBE: Si një shkrimtar i frytshëm për fëmijë, a mund të na thoni se si ndiheni për ruajtjen e ëndrrave të palestinezëve për fëmijët që rriten gjatë gjithë jetës nën okupim?

M. SHUKAIR: Mbajtja e ëndrrës së fëmijëve palestinezë të lindur nën okupim, nuk është kurrë një detyrë e lehtë, veçanërisht kur ata fëmijë janë të uritur, të vrarë dhe të nënshtruar ndaj gjenocidit, siç është aktualisht situata në Rripin e Gazës. Megjithatë, unë kam qenë i prirë në punën time, duke shkruar letërsi për fëmijë dhe të rinj, të ringjallja ëndrrën e një atdheu të lirë në të cilin fëmijët e Palestinës gëzojnë liri dhe siguri. Gjithmonë jam kujdesur që të rrënjos të fëmijët dashurinë për tokën, botën natyrore dhe atdheun e tyre përmes detajeve konkrete, të prekshme që ata mund të kuptojnë.

SH. MALHERBE: A mund të na jepni disa njohuri mbi betejat me të cilat përballen fëmijët palestinezë? Çfarë keni qenë dëshmitar?

M. SHUKAIR: Fëmijët në Palestinë po përjetojnë akte mizore të tmerrshme që nuk janë parë më parë mbi asnjë fëmijë tjetër në botë. Në Gaza, vdekja nga uria e fëmijëve palestinezë është një praktikë e qëllimshme që ka rezultuar në një numër të lartë të vdekjeve nga kequshqyerja dhe ushqimi i pamjaftueshëm, veçanërisht qumështi. Ka fëmijë që vdesin për shkak të mungesës së ilaçeve, të tjerë të vrarë nga bombardimet që synojnë shtëpitë e civilëve dhe disa që mbeten gjallë si të amputuar dhe jetimë pasi bombardimi synon familjet e tyre. Për shkak të gjenocidit që po ndodh aktualisht në Gaza, fëmijët palestinezë po përjetojnë trauma, tronditje dhe kriza të shumta psikologjike. Këta fëmijë kërkojnë kujdes mjekësor, mbështetje psikologjike dhe shkrime krijuese që adresojnë shpirtat e tyre të lodhur dhe të traumatizuar në mënyrë që ata të mund të kthehen në veten e tyre të rregullt.

SH. MALHERBE: Si ndihmon shkrimi juaj për ta bërë këtë?

M. SHUKAIR: Përpiqem të përfshij një element kënaqësie në të gjitha tregimet dhe romanet që shkruaj për lexuesit e rinj.

Edhe kur shkruaj për praktikat brutale të ushtarëve të okupacionit, kujdesem ta përcjell me njëfarë qetësie dhe pa shprehje të tepruara trishtimi e pikëllimi për të mos e futur fëmijën në gjendje trishtimi dhe frustrimi. Nuk inkurajoj vendosjen e fëmijës në një gjendje mjerimi si pasojë e rrethanave të vështira shoqërore dhe kombëtare, në mënyrë që ai të mbetet optimist dhe me shpresë për një jetë të sigurtuar dhe të sigurt.

SH. MALHERBE: Edhe ju jeni prekur nga okupimi gjatë gjithë jetës. Mund të na thoni më shumë për këtë?

M. SHUKAIR: Kur shkruaj për fëmijë, marr frymëzim për tregimet dhe romanet e mia nga ajo që shoh dhe di për vuajtjet e vërteta të fëmijëve në duart e pushtuesve izraelitë. Unë gjithashtu marr frymëzim nga ajo që jam ekspozuar nga pushtimi gjatë fëmijërisë sime. Kur isha shtatë vjeç, nëna ime më zgjoi ndërsa zhurmat e predhave dhe plumbave më tingëllonin në vesh. Na u desh të largoheshim nga shtëpia jonë atë natë për të gjetur siguri larg zjarrit të armëve pasi një bandë e armatosur sioniste sulmoi Xhabal el-Mukaber, ku jetonim unë dhe familja ime. Qëndruam katër muaj në pjesën lindore të fshatit tonë, pastaj u kthyem në shtëpi. Kur u ktheva, u ndjeva i lumtur, por frika e humbjes së shtëpisë dhe stabilitetit, që ishte vendosur thellë brenda meje pas asaj përvoje të hidhur, nuk më ka lënë rehat deri tani.

SH. MALHERBE: Gjithmonë shqetësohemi për fëmijët, por ç’të themi për ndikimin te ju si shkrimtar? A keni vuajtur nga pengesat, zhgënjimet, dëshpërimi, e kështu me radhë? Nëse po, si e keni trajtuar atë?

M. SHUKAIR: Do ta pranoj se për shkak të mjedisit sfidues politik dhe social ku jetoj, ka pasur momente kur jam ndjerë i pashpresë, i frustruar dhe sikur të jesh shkrimtar është e pakuptimtë. Megjithatë, nuk pranova të më kontrollonin këto emocione negative. Mblodha çdo grimcë të forcës së nevojshme për t’i kaluar këto emocione. Shkrimi më ndihmoi për këtë, së bashku me kulturën në të cilën isha rritur dhe formuar për veten time.

SH. MALHERBE: Kam lexuar se tregimet tuaja bazohen në ngjarje të vërteta. Mund të na tregoni më shumë rreth ngjarjeve që ju kanë frymëzuar të shkruani libra?

M. SHUKAIR: Për shembull, për shkak të arratisjes nga shtëpia, përvoja më mbeti për shumë vite dhe kur botova tregimet e mia të para në revistën Jerusalemite al-Ufuq al-Jadeed (Horizonti i Ri) në vitin 1962, historia ishte për atë natë. Shkrova gjithashtu një tregim të quajtur “Ushtari dhe lodra”. Ajo u bazua në një ngjarje të vërtetë që i ndodhi vajzës sime, atëherë trevjeçare, Amina, kur ajo erdhi me nënën e saj për të më vizituar pasi u dëbova nga burgu në Liban. Kur u kthyen nga Bejruti në Aman dhe rrugës për në Jerusalem, ushtari izraelit copëtoi kukullën e saj për t’u siguruar që nuk kishte eksplozivë të kontrabanduar brenda saj. Kam shkruar gjithashtu tregime për fëmijë, për fëmijë të vërtetë që u vranë nga ushtria izraelite gjatë demonstratave paqësore, duke përfshirë dëshmorin Ali Afana nga Abu Dees, një qytet i vogël afër Jerusalemit dhe Xhamal el-Zein nga Ramallahu.

SH. MALHERBE: Pse ishte e rëndësishme për ju të shkruanit tregimet e këtyre fëmijëve?

M. SHUKAIR: Kur shkrova këto tregime, u mërgova nga qyteti i Jerusalemit dhe nga Palestina. Kur lexova për martirizimin e këtyre dy fëmijëve, doja t’i përjetësoja në dy tregime. Gjithashtu doja t’u transmetoja fëmijëve arabë jashtë Palestinës diçka për vuajtjet e fëmijëve palestinezë, të cilët janë të ekspozuar ndaj praktikave të ndryshme negative që arrijnë deri në vrasje. Këto dy tregime i botova në një revistë arabe kushtuar fëmijëve përpara se t’i botoja në një libër që u botua në Palestinë me titull “Djaloshi palestinez”.

SH. MALHERBE: Çfarë elementesh stilistike përdorni për të përcjellë mesazhe në tregimet tuaja?

M. SHUKAIR: Unë i shkruaj tregimet dhe romanet e mia me një gjuhë më pak komplekse për t’u përshtatur në nivelin kognitiv të grupmoshës së fëmijëve. Unë jam i prirë të ruaj kënaqësinë e leximit në atë që shkruaj. Unë i drejtohem trashëgimisë në mjaft raste

HEJZA

për të përmendur figura që kanë vlerë në kulturën arabe, si Salahudin Ejubi. I përdor këngët popullore dhe përrallat popullore palestineze për t’i bërë historitë e mia të lidhura me fëmijët. Në të gjitha rastet, jam i prirë të jap elementin e imagjinatës, i cili është thelbësor për zhvillimin e aftësive të fëmijëve dhe pasurimin e njohurive dhe përvojave të tyre të reja.

SH. MALHERBE: A mund të na tregoni se si i përdorni shkrimet dhe tregimet për t’u lidhur me fëmijët palestinezë?

M. SHUKAIR: Të shkruarit është mjeti im më i rëndësishëm për të komunikuar me të rriturit dhe fëmijët dhe jam i kënaqur që fëmijët e Palestinës merren me tregimet dhe romanet e mia me pasion dhe interes. Kohët e fundit, kur u shpalla fitues i çmimit, një grua më gëzoi në një koment në rrjetet sociale kur tha: “Unë i rrit fëmijët e mi me vlerat arsimore, kombëtare dhe morale në tregimet tuaja”. Shpesh vizitoj shkollat dhe klubet për t’u takuar me fëmijët për të diskutuar librat e mi, dhe pas Covid-19, kam mbajtur dhe vazhdoj të mbaj seminare kushtuar komunikimit me fëmijët në shkollat e tyre ose qendrat kulturore për të diskutuar librat e mi me ta.

SH. MALHERBE: Sa e rëndësishme është kjo për fëmijërinë e tyre?

M. SHUKAIR: Mendoj se kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për fëmijërinë, veçanërisht me rritjen e popullaritetit të mediave sociale. Mediat sociale nxjerrin çdo ditë mesazhe, video dhe materiale të panumërta që nuk janë të përshtatshme për fëmijët. Këtu hyn në lojë vlera e një libri të mirë të specializuar për fëmijë – ai e çon fëmijën në një fushë tjetër, duke i njohur me vlerat kombëtare dhe njerëzore. Ndoshta ajo që është e rëndësishme në këtë drejtim është që prindërit, shkollat, qendrat kulturore dhe institucionet që lidhen me fëmijërinë duhet të jenë të prirë për të sjellë ndryshime në disa fusha: nxitja e fëmijëve për të lexuar, tërheqja e tyre për t’u interesuar për librat e fëmijëve, diskutimi i vlerave, konceptet dhe sjelljet në këto libra, duke u mundësuar fëmijëve të shprehen lirshëm dhe hapur.

SH. MALHERBE: A keni ndonjë këshillë se si ne arrijmë kolektivisht mbrojtjen dhe ruajtjen e ëndrrave palestineze mes një traume të tillë?

M. SHUKAIR: Unë nuk besoj në idenë e të qenit superior në mësimin e fëmijëve, duke i trajtuar fëmijët sikur të mos dinë asgjë për atë që po ndodh rreth tyre. Kjo është qasja e gabuar. Fëmijët janë shumë të zgjuar. Gjithçka që prindërit, mësuesit dhe edukatorët duhet të bëjnë është të kenë një diskutim të frytshëm dhe të ndërgjegjshëm me ta në një mënyrë që të respektojë mendjet e tyre dhe do të dalin rezultate pozitive. Duhet të bëhen përpjekje të mëdha për të shpëtuar fëmijët nga situata aktuale në Gaza. Aktualisht nuk ka shkolla apo kopshte, dhe shumica e fëmijëve janë të pastrehë dhe jetojnë në tenda që nuk ofrojnë aspektet më elementare të një jete të denjë. Përpjekjet vullnetare të ndërmarra nga disa institucione të rëndësishme për fëmijërinë fitojnë rëndësi të madhe. Ka vullnetarë në zonat e zhvendosjes që mbledhin fëmijët për t’i mësuar ata, për të zhvilluar diskutime dhe për t’u mundësuar fëmijëve të shprehin veten dhe të zbulojnë shqetësimet. Ka njëfarë ngushëllimi kur dihet se fëmijët ndiejnë ngrohtësi në praninë e njerëzve që punojnë për të kuptuar nevojat e tyre dhe për t’u mundësuar të shprehen.

BURGIMI NËN PUSHTIMIN IZRAELIT PËR TË SHKRUAR

SH. MALHERBE: Jeni burgosur nën okupim për përfaqësimin tuaj të brutalitetit të qeverisë izraelite në shkrimet tuaja. Mund të na tregoni për përvojën tuaj në burg?

M. SHUKAIR: Unë u burgosa për herë të parë në vitin 1969. Ushtarët erdhën me një oficer të inteligjencës izraelite dhe



rrethuan shtëpinë natën. Ata trokitën në dritare dhe në derë. Kur hapa derën, më prangosën dhe më kërkuan të qëndroja në cep të dhomës. Më pas kontrolluan shtëpinë. Ata kërkuan librat dhe nuk gjetën asgjë. Më çuan në burgun Al-Moskobiya, që ndodhet në kufirin midis Jerusalemit Lindor dhe Perëndimor. Këtu filloi përvoja ime me torturën. Pasi u vendosa në një qeli që ndriçohej ditë e natë për dy ditë, gjatë së cilës nuk mund të flija, më transferuan në një burg ushtarak, emrin dhe vendndodhjen e të cilit e fshehën ku ushtrojnë tortura dhe të gjitha format e shtypjes ndaj të burgosurve palestinezë. Unë qëndrova në atë burg, i cili më vonë u bë i njohur për palestinezët si Sarafand (që ndodhet në qendër të vendit). Kalova nëntë ditë në një qeli që ishte nëntëdhjetë centimetra e gjatë dhe tetëdhjetë centimetra e gjerë. Mblidhesha rreth vetes që të mund të flija, pa dyshek apo batanije. Jam rrahur ditë e natë nga hetuesit për shkak të veprimtarisë sime politike kundër pushtimit. Pas kësaj, më kthyen në qendrën e paraburgimit Al-Moskobiya, më pas në qendrën e paraburgimit Al-Ramleh, pastaj në qendrën e paraburgimit Al-Damoun afër malit Karmel, ku qëndrova si i paraburgosur administrativ. Më liruam dhjetë muaj më vonë. Në vitin 1972 më vunë në arrest shtëpiak për një vit. Kur shpërtheu Lufta e Tetorit në 1973, forcat izraelite pushtuese erdhën për të më arrestuar. Unë nuk isha në shtëpi. Më lanë një letër në shtëpi që duhej të shkoja në komisariat, por nuk shkova. U fsheha në një shtëpi në Ramallah që nga ai moment deri në dy javë pas luftës dhe më pas u ktheva në shtëpi. Në prill 1974 u arrestova përsëri dhe u transferova në disa burgje izraelite, i fundit prej të cilëve ishte burgu i Beit Lid. Pas dhjetë muaj burgim administrativ, më dëbuan nga burgu në kufirin libanez dhe qëndrova në mërgim për tetëmbëdhjetë vjet, pas së cilës u ktheva në Jerusalem në prill 1993. Përvoja e burgut ishte e hidhur, sipas të gjitha standardeve.

SH. MALHERBE: A kishit qasje në libra dhe materiale shkrimi? Si keni shkruar brenda këtyre kufizimeve?

M. SHUKAIR: Ka një bibliotekë në burg, por ka pak libra dhe nuk e plotëson etjen për të lexuar. E kisha të pamundur të shkruaja në kushtet e mbipopullimit të dhomave të burgut me të paraburgosur dhe mungesës së kushteve të përshtatshme për të shkruar. Jam mësuar me izolimin dhe me një atmosferë privatësie për të shkruar, ndaj nuk arrita të shkruaj asnjë tekst krijues në burg. I shkrova vetëm letra familjes, në të cilat fola shkurt dhe nuk përmenda vështirësitë brenda burgut, sepse letrat monitoroheshin nga administrata e burgut. Dikur lexoja çfarëdo librash që kishte në bibliotekën e burgut dhe nganjëherë fiksohesha pas disa ideve dhe situatave dhe ëndërroja për histori që do t’i shkruaja kur të dilja

nga burgu. Këtë e bëra kur u dëbova nga burgu në Liban, ku jetova në Bejrut për tetë muaj, gjatë të cilëve shkrova histori për burgun dhe dëbimin nga atdheu. Pas kësaj, u transferova në Aman dhe shkrova një roman për burgun atje. Megjithatë vendosa të mos e botoj, sepse nuk e pata bindës për shkak të shprehjes së drejtpërdrejtë politike dhe mungesës së prirjes artistike.

SH. MALHERBE: Mund të na tregoni më shumë për këtë?

M. SHUKAIR: Nuk kam shkruar asnjë vepër krijuese në burg, por gjatë periudhës së dytë të paraburgimit kam qenë i fiksuar pas shkrimit të një romani për periudhën e burgimit, vuajtjet e të burgosurve, largimin e Gamal Abdel Nasser dhe dështimin e grusht shteti kundër diktatorit Gaafar Nimeiri në Sudan. Kur dola nga burgu dhe jetoja në mërgim, fillova të shkruaj romanin që e kisha përmendur më herët ndërsa jetoja në Aman në vitin 1976. Titulli i tij ishte “Represioni”. Kur disa miq e lexuan dorëshkrimin, ata vunë në dukje drejtësinë e tij dërrmuese politike. U binda nga komentet e tyre dhe ndryshova titullin në “Çfarë iu tha një vizitori urgjent”. E zbuta qasjen direkte politike dhe ia dërgova poetit Mahmud Darwish, i cili ishte kryeredaktor i revistës “Palestinian Affairs” botuar në Bejrut. Darwish më dërgoi një letër ku tregonte se do ta botonte romanin në revistë, më pas, para se ta botonte, i dërgova një letër ku i kërkova të ndalonte botimin e tij, sepse nuk isha i bindur dhe sepse në narrative dominonte qasja e drejtpërdrejtë politike, e cila ndikonte drejtpërdrejt në cilësinë artistike dhe formën e romanit.

SH. MALHERBE: A ndryshoi këndvështrimi juaj për Jerusalem gjatë kësaj periudhe të jetës suaj? Nëse po, si?

M. SHUKAIR: Ky ndryshim ndodhi për shkak të një dashurie më të madhe për Jerusalem, sepse largimi prej tij është si një fëmijë të jetë larg nënës së tij të dashur. Kur isha në burg, m’u kujtuan ditët e mia në qytet dhe u lidha më shumë me të, më shumë e doja dhe më shumë shqetësohesha për qytetin nga përpjekjet për izraelizimin. Ndërsa isha larg Jerusalemit, e kuptoja se vetëm të ecësh në rrugët e tij ose të ulesh në kafenetë dhe restorantet e tij ka një vlerë të madhe, dhe ne duhet ta bëjmë këtë më shumë dhe të mos lëmë asnjë vend në të pa e vizituar dhe menduar detajet e tij. Kur u detyrova të jem në një distancë nga Jerusalemi, ai u bë më afër meje. I premtova vetes se kjo do të kthehej në vëmendjen më të madhe pa humbur një shans për të qenë pranë qytetit, më afër tij për ditët e mbetura të jetës sime.

SH. MALHERBE: Çfarë keni ëndërruar të arrini pasi të kishit lirinë tuaj?

M. SHUKAIR: Kur dola për herë të parë nga burgu në vitin 1970, mendja ime ishte e fokusuar në vazhdimin e luftës politike kundër pushtimit. Më kujtohet se dy javë pas liritimit nga burgu, mora një shënim nga oficeri i sigurisë në Jerusalem që të shkoja ta takoja. Shkova dhe thelbi i intervistës ishte që të më paralajmëronte që të mos bëja asnjë punë politike kundër pushtimit, përndryshe do të më arrestonin sërish. Megjithatë, ky paralajmërim nuk më ndaloi të vazhdoja aktivitetet e mia politike dhe vazhdova të nxisja protesta kundër okupimit dhe metodave të tij për arrestimin e qytetarëve palestinezë: marrjen e tokave të tyre, shkatërrimin e shtëpive të tyre, vendosjen e taksave të larta, ndryshimin e kurikulës në shkollat e tyre dhe duke fshirë çdo gjë që kishte të bënte me atdheun e tyre. Kur u largova nga burgu për herë të dytë, duke mos u kthyer në shtëpi, por duke u detyruar në mërgim në Liban, rifillova shkrimet krijuese me energji dhe aktivitet. Shkrova pjesë për të rritur që u botuan në “Djaloshi palestinez”, përmbledhja ime e dytë me tregime, dhe për fëmijë që i kisha botuar nën redaktimin e shkrimtarit të njohur sirian, Zakaria Tamer në revistën “Osama”.

MËRGIMI I DETYRUAR NGA ATDHEU I TIJ I DASHUR

SH. MALHERBE: Në vitin 1975 ju u dëbuat nga Palestina për aktivizmin tuaj politik. Keni kaluar gati dy dekada në mërgim. Si ndikoi mërgimi në shkrimin tuaj ndërkohë që ishit të distancuar fizikisht nga vendlindja?


M. SHUKAIR: Jeta ime dhe shkrimi janë ndikuar nga dëbimi nga vendi im në shumë mënyra. Nga njëra anë, ndihesha i paqëndrueshëm, sikur të kisha prerë rrënjët dhe të isha pezull midis tokës dhe qiellit. Gjatë gjithë mërgimit tim, isha i shqetësuar nga dëshira ime e vazhdueshme për familjen time, Jerusalem tim të lindjes dhe atdheun tim. Megjithatë, kisha avantazhe për të shkruar ndërsa jetoja jashtë vendit. Në Bejrut, kisha qasje në libra që nuk lejoheshin të hynin në territoret e pushtuara palestineze dhe iu përkushtova leximit me zell dhe me vëmendje.

SH. MALHERBE: Çfarë librash ju frymëzoi mërgimi për të shkruar?

M. SHUKAIR: Kam shkruar tregime për fëmijë dhe për fëmijët që u martirizuan nga autoritetet e pushtimit. Unë shkrova romanin e përmendur më parë dhe një tregim për të rritur të quajtur “Atdheu”, në të cilin përfshiva ndjenjat e mia të tjetërsimit në ditët e para pas dëbimit tim. Më pas erdhën tregimet e mia për të rritur dhe fëmijë, të cilat karakterizoheshin nga specifikat e mërgimit, goftë pozitivisht – në kuptimin e të qenit i hapur ndaj kulturave arabe dhe të tjera dhe të ndikuarit prej tyre për të shkruar letërsi më të pjekur dhe substanciale – dhe negativisht – në aspektin e tjetërsimit, malli, paqëndrueshmëria dhe mungesa e atdheut, familjes dhe shtëpisë. Mërgimi më njohu me shkrimtarët dhe intelektualët palestinezë që jetojnë në diasporë dhe me shumë shkrimtarë e intelektualë arabë. Qëndrimi në mërgim më lejoi të merrja pjesë në seminare dhe konferenca politike dhe kulturore, të cilat e përmirësonin jetën time dhe patën një ndikim pozitiv në shkrimet e mia, të cilat janë botuar gjerësisht që atëherë.

SH. MALHERBE: Si e keni parë Palestinën nga larg?

M. SHUKAIR: Unë isha më i aftë për t’i gjykuar gjërat nga distanca, dhe ndërsa isha në mërgim, isha në gjendje të shihja gjërat pozitive dhe negative tek ne palestinezët. Isha më i aftë të largohesha nga paragjykimet emocionale dhe entuziazmi i tepërt, kështu që gabimet dhe mangësitë tona i shihja objektivisht dhe në mënyrë të paanshme, dhe në të njëjtën kohë, mund të shihja se çfarë është pozitive në përpjekjet tona dhe në programet tona politike. Jam bërë më i vetëdijshëm për praninë e Palestinës në ndërgjegjen e botës. Propaganda mashtruese sioniste ka mundur të



shtrembërojë imazhin e Palestinës si një tokë pa njerëz dhe një moçal që përhap sëmundje. Kjo është një gënjeshtër dhe një falsifikim. Individualitete palestineze të shënuar nga kultura dhe qytetërimi i veçantë i Palestinës, kanë ekzistuar prej kohësh, dhe të dhënat dhe imazhet nga Haifa, Jaffa dhe Jerusalemi dëshmojnë për qytetërimin palestinez dhe qytetarët e tij. Si rezultat i kësaj, fillova të ndiej peshën e përgjegjësisë mbi supet e mia dhe mbi supet e shkrimtarëve dhe intelektualëve palestinezë, të cilëve u kërkohet të mbrojnë të vërtetën e Palestinës përballë propagandës së rreme dhe të sajuar sioniste.

SH. MALHERBE: Cilat janë momentet kryesore gjatë mërgimit që ju përcaktuan si shkrimtar?

M. SHUKAIR: Më pritën ngrohtësisht në Bejrut pas lirimnit nga burgu izraelit, jo vetëm sepse isha aktivist politik, por kryesisht sepse isha shkrimtar. Unë kisha botuar një histori të titulluar “Buka e të tjerëve” në revistën Jerusaleme al-Ufuq al-Jadeed (Horizonti i Ri) dhjetë vjet para mbërritjes sime në Bejrut, në vitin 1965. Historia ishte shpërndarë gjerësisht dhe ribotuar në gazeta dhe në radio, veçanërisht gjatë paraburgimit tim. Kjo rriti interesin për mua si shkrimtar nga gazetat dhe revistat palestineze dhe libaneze në Bejrut, gjë që më inkurajoi të shkruaj me pasion, përgjegjësi dhe interes. Bejruti në atë kohë ishte i zënë me veprimtarinë e përditshme politike, duke përfshirë Organizatën për Çlirimin e Palestinës, revistat e saj, qendrat kulturore, intelektualët dhe shkrimtarët, si dhe partitë e Lëvizjes Kombëtare Libaneze dhe aktivitetet e tyre të ndryshme politike dhe kulturore. E gjithë kjo më dha stimul për t’u angazhuar në veprimtari politike dhe kulturore, gjë që ndikoi pozitivisht tek unë.

NJË KTHIM I SHUMËPRITUR NË PALESTINË

SH. MALHERBE: Në vitin 1993 u nënshkrua Marrëveshja e Oslos dhe tridhjetë njerëzve iu dha e drejta për t’u kthyer në Palestinë. Ti ishe një prej tyre. A mund të na thoni si u ndjetë pas kthimit në vendlindje?

M. SHUKAIR: E pashë se kthimi im në Palestinë, Jerusalem, në shtëpinë time dhe në familjen time, ishte i jashtëzakonshëm nga të gjitha masat vlerësuese. Nuk e kisha menduar kurrë se do të kthehesha kaq shpejt. Kur nisën të rrjedhin lajmet për mundësinë e kthimit të tridhjetë të dëbuarve nga vendlindja e tyre, fillova ta ndjek me kureshtje këtë lajm për t’u siguruar që emri im të përfshihej në listën e të kthyerve të mundshëm. Kjo,

natyrisht, po ndodhte gjatë negociatave sekrete të Oslos midis izraelitëve dhe palestinezëve. U mbusha me gëzim të jashtëzakonshëm kur u zbuluan emrat e tridhjetë të internuarve, të cilët kishin pranuar të ktheheshin në atdhe. Më pas fillova të përgatitesha për kthimin tim. Ishim të shoqëruar nga familjet tona dhe ishim tubuar jashtë selisë së Organizatës për Çlirimin e Palestinës në Aman dhe ndërsa autobusët u nisën mbi urën për në atdheun tonë, përjetova një moment të pashoq në jetën time. Po kthehesha në Jerusalem pas tetëmbëdhjetë vitesh larg. Në stacionin e pushimit të Jerikos, na prisnin mijëra qytetarë palestinezë. Anëtarët e familjes sime, shokët dhe miqtë ishin aty për të më pritur. Isha shumë i lumtur. Atë ditë gazetarëve që ishin mbledhur rreth meje për të bërë intervista ju thash se jam shumë i lumtur për këtë kthim në vendlindje, por është i paplotë sepse një numër i madh i njerëzve të mi, të zhvendosur në diasporë, janë ende të privuar nga kthimi në vendlindje, në atdheun tonë.

SH. MALHERBE: A ndryshoi Palestina pas kthimit tuaj? Çfarë mbeti e njëjtë?

M. SHUKAIR: Po, ka pasur ndryshime në çdo nivel. Gjeta Jerusalem-in e rrethuar nga shumë vendbanime që e ndanin nga rrethinat e tij arabe palestineze dhe gjeta postblloque ushtarake izraelite që bllokoni rrugët dhe kufizonin lëvizjen e njerëzve. Gjeta breza të rinjsh që lindën dhe u rritën gjatë mungesës sime të detyruar nga atdheu, të cilët nuk i njihja, përfshirë një numër familjarësh. I gjeta të prekur nga Intifada e Parë e vitit 1987, e cila krijoi breza luftëtarësh që e donin atdheun e tyre dhe ishin të përgatitur të sakrifikonin për të. Në të njëjtën kohë ishin të pranishme edhe gjërat negative nga epokat e mëparshme. Intifada kishte krijuar vlera dhe sjellje të reja të lira nga fanatizmi dhe pikëpamjet negative për gratë. Gratë morën pjesë, ishin të pranishme dhe u angazhuan në beteja aktive. Më pas, vlerat e solidaritetit dhe mbështetjes reciproke u zbehën dhe u zëvendësuan nga konservatorizmi, fanatizmi, kufizimet e lirisë së grave, partishmëria dhe konkurrenca shkatërruese, joparimore si rezultat i rënies dhe përkeqësimit të Intifadës dhe kufizimeve burokratike që lidershipi i fuqishëm vendosi mbi të.

SH. MALHERBE: Çfarë tregimesh keni shkruar sapo u kthyet në shtëpi? A ishin ndryshe nga puna juaj në mërgim? Nëse po, si?

M. SHUKAIR: Kur u ktheva në atdhe dhe pashë zhvillimet pozitive që kishin ndodhur në rrjedhën e luftës kombëtare kundër pushtimit, së bashku me pengesat që shoqëruan dobësinë e Intifadës, e gjeta

veten me një tendencë të qartë. Vendosa të shkruaj histori satirike që tallen me arrogancën e pushtuesve dhe mburrjen e tyre për forcën që ata imponojnë mbi një popull të pambrojtur dhe ngritjen e barrierave që izolojnë qytetet palestineze nga njëra-tjetra. Isha gjithashtu i motivuar të ftoja figura të njohura nga e gjithë bota që të vinin në lagjet e njohura të Jerusalemit për të bashkëvepruar me banorët e lagjes. Ftova këngëtarin Michael Jackson, futbollistin brazilian Ronaldo, sekretarin amerikan të Mbrojtjes, Donald Rumsfeld dhe të tjerë. Në të njëjtën kohë, këto tregime tallen me disa aspekte të shoqërisë sonë dhe në këtë drejtim kam përfunduar shkrimin e dy përmbledhjeve me tregime satirike: Imazhi i Shakirës dhe Kushërira ime Kondoliza.

SH. MALHERBE: Punimet tuaja të mëvonshme marrin një ton ironik. Mund të na thoni më shumë për këtë zgjedhje stilistike?

M. SHUKAIR: Këto përralla tallin mendjemadhësinë dhe arrogancën e pushtuesve, ndërkohë që nënçmojnë statusin e tyre, sepse ata lëvdojnë, mburren dhe shfaqin forcën e tyre. Ajo tallet me disa nga besimet tona të vjetruara, veçanërisht ato për gratë – se ato nuk janë aq të vlefshme sa burrat dhe se liria e tyre duhet të kufizohet. Për ta paraqitur këtë tallje në mënyrë bindëse, përdora fjalë të urta, këngë dhe rrëfime popullore të nxjerra nga shpirti i popullit. Kam përdorur gjithçka për të stimuluar tendencën për të qeshur që përdoret nga njerëzit. Arti i karikaturës - i cili thekson disa pjesë të trupit, si hundën, veshët ose sytë, për t’i lënë marrësit një përshtypje sa të habitshme aq edhe humoristike - ishte e dobishme për mua. Si rezultat, disa nga personazhet e mi dhe veprimet e tyre u ndeshën në mënyrë befasuese dhe me humor, kështu që lexuesit i shijojnë ata duke ndjekur specifikat e këtyre tregimeve.

Sh. Malherbe: Çfarë po punoni tani?

M. SHUKAIR: Jam duke punuar në tekste narrative tani që janë më shumë të ngjashme me tregime shumë të shkurtra dhe janë të mbushura me gjuhë poetike. Bëhet fjalë për tragjeditë që po bëjnë pushtuesit izraelitë, të cilat rezultojnë me vdekjen e dhjetëra mijëra grave dhe fëmijëve, pa asnjë ndërgjegje apo frenim. Këto tekste fokusohen në anën njerëzore të vuajtjeve të shkaktuara nga bombardimet, uria, shpërnguljet dhe gjenocidi. Ato rrëfehen nga një burrë i arsimuar që jeton në Jerusalem dhe mbesa e tij, e cila jeton në Rafah, një qytet në jug të Rripit të Gazës, dhe i bashkohet rrëfimit. Si rezultat, tekstet lexohen si një roman me skena dhe kapituj të njëpasnjëshëm.

SH. MALHERBE: Çfarë të ardhme shihni për qytetin tuaj të dashur, Jerusalem-in?

M. SHUKAIR: Gjatë historisë së tij të gjatë, ky qytet – Jerusalemi im i dashur – ka qenë objektiv i pushtimeve të shumta. Ky qytet u shkatërrua shtatëmbëdhjetë herë nga pushtuesit, por çdo herë dilte nga hiri dhe jeta rivendosej përsëri. Është një qytet i përkushtuar ndaj diversitetit, bashkëjetesës së feve dhe ideve të ndryshme dhe bashkëjetesës së njerëzve në qetësi, siguri, solidaritet dhe paqe. Shtatë portat e saj të hapura nga të gjitha anët konfirmojnë natyrën e saj të përkushtuar ndaj pluralizmit. Aktualisht i nënshtrohet një vizioni ekskluziv të imponuar nga pushtuesit izraelitë, i cili e tregon Jerusalem-in si kryeqytetin e përhershëm të Izraelit. Sado që pushtuesit të përpiqen të ndryshojnë peizazhin e vërtetë të qytetit, sado që përpiqen të ulin numrin e palestinezëve që jetojnë atje, sado që taksojnë, sado shtëpi që prishin, sado që vendbanime të reja krijojnë brenda dhe jashtë mureve të qytetit, sado që ato cenojnë vendet e shenjta të qytetit për të krishterët dhe myslimanët, ky vizion i mbyllur nuk është në përputhje me natyrën e qytetit dhe nuk do të ketë sukses. Për banorët e tij hebrenj, myslimanë, të krishterë dhe jositionistë, Jerusalemi do të vazhdojë të jetë një qytet arab palestinez. Është një qytet i mrekullueshëm që frymëzon shpresë dhe harmoni në zemrat e njerëzve në mbarë botën dhe është i përkushtuar ndaj diversitetit, dashurisë dhe paqes.

SH. MALHERBE: Sa i rëndësishëm është roli i shkrimtarit në këtë vizion?

M. SHUKAIR: Në të njëjtën mënyrë që qyteti më rrënjos vlerat e tolerancës dhe mendjehapjes, unë i kam nderuar këto ideale të larta në tregimet dhe romanet e mia, i kam përkrahir ato dhe i kam bërë ato në qendër të stilit dhe këndvështrimit tim të larmishëm dhe të shumanshëm të të shkruarit mbi jetën.

SH. MALHERBE: Çfarë këshille keni për ta?

M. SHUKAIR: Meqenëse Jerusalemi është një qytet i pluralizmit, hapjes dhe paqes, unë mbroj nevojën për të respektuar cilësitë e qenësishme të Jerusalem-it. Kur autoritetet okupuese përpiqen të izraelizojnë qytetin, ta bëjnë atë të kufizuar në një vizion të ngushtë dhe të përjashtojnë vizionet e tjera, ato hyjnë në një kontradiktë flagrante me natyrën e qytetit dhe thelbin e jetës së tij, dhe këto përpjekje të bazuara në dhunë dhe shtrëngim nuk do të kenë sukses. (Përshtati në shqip: Fitim NIHIU)

Film

FLUTURIMI MBI FOLENË E QYQES

Filmi në fjalë është një nga kryeveprat e kinemasë, i cili na transmeton një eksplorim të fuqishëm të sistemit psikiatrik dhe lirisë individuale



Nga Leonard VEIZI

Një mik i mirë nuk të le të vuash e të jetosh i “tredhur” e pa dinjitet. Ai të lehtëson duke të dhënë një vdekje të shpejtë. Ky është dhe mesazhi i fundit që na jep filmi epike i vitit 1975 “Fluturimi mbi folenë e qyqes”. Ndërkohë që personazhi kryesor i filmit, - i cilësuar si i sëmurë psikik edhe pse jo i tillë, - i ishte hedhur në fyt dhe ishte gati ta mbyste kryeinfermierën e pavijonit, pasi kjo e fundit nga qëndrimi i saj shtyu në vetëvrasje një nga pacientët, më të riun mes tyre. Dhe kjo kishte sjellë ndëshkimin e tij me lobotomi, duke e bërë krejtësisht të paaftë për jetën. Por në të vërtetë mesazhi thelbësor i këtij filmi të njohur, - mbështetur mbi një roman po aq të njohur, - na e jep duke përshkruan konfliktin e vazhdueshëm midis themelimit dhe reformës, e ku, për shkak se shumica e të interesuarve qëndrojnë apatikë, reforma përfundimisht vjen pas valëve të dështimit dhe martirizimit...
...Në filmin “One Flew Over the Cuckoo’s Nest” apo “Fluturimi mbi folenë e qyqes”, interpreton mjeshtërisht një nga yjet e Hollivudit siç është Xhek Nikëllson në rolin e Randëll MekMërfi. Filmi në fjalë është një nga kryeveprat e kinemasë, i cili na transmeton një eksplorim të fuqishëm të sistemit psikiatrik dhe lirisë individuale. “One Flew Over the Cuckoo’s Nest” ka si regjisor Milos Forman, i cili është bazuar në romanin e shkrimtarit amerikan Ken Keizi. Në filmi Xhek Nikëllson interpreton rolin e një pacienti të ri në një institucion mendor, ndërsa aktorja Luis Fletçer si kryeinfermierja dominuese e institucionit. Ndërkohë që luajnë role dytësore: Uill Samson, Dani DeVito, Sidnei Lasek, Uilliam Redfiell, Kristofer Lloid dhe Brad Dorif.

Romani

“One Flew Over the Cuckoo’s Nest” është një roman nga Ken Keizi i botuar në vitin 1962. I vendosur në një spital psikiatrik

në Oregon, rrëfimi shërben si një studim i proceseve institucionale dhe mendjes njerëzore, duke përfshirë një kritikë të psikiatrisë. Libri fillon me ardhjen e Randëll MekMërfit, i cili ka falsifikuar çmendurinë e tij për t’u transferuar nga burgu në një spital psikiatrik. Ai është shumë i zhurmshëm dhe i fut pacientët me lojërat e fatit, duke i inkurajuar ata të rebelohen kundër regjimit të rreptë të infermieres Raçd, që është dhe kryeinfermierja administrative. “One Flew Over the Cuckoo’s Nest” njihet si një roman themelor që eksploron efektet dehumanizuese të institucionalizimit dhe luftës për individualitet. Skenaristi i njohur Bo Goldman e përshtati romanin në një film të vitit 1975 me të njëjtin emër me regji të Milosh Forman, i cili fitoi pesë çmime Oscar. I vendosur në një spital psikiatrik, romani thellohet në temat e mendjes, fuqisë dhe pasojave të konformitetit shoqëror. Tregimi i Keizi-t sfidon normat tradicionale dhe vë në pikëpyetje përkufizimin e çmendurisë, duke i ftuar lexuesit të marrin në konsideratë se kush ka fuqinë për të përcaktuar mendjen dhe çmendurinë. Historia rrëfëhet nga Shef Bromden, një pacient në një spital mendor, i cili vëzhgon rutinat shtypëse dhe dinamikat e pushtetit brenda institucionit. Ardhja e Randëll MekMërfit, një njeri rebel dhe karizmatik, prish sundimin autoritar të Infermierit Raçd dhe sjell një fije shprese për pacientët e tjerë. I botuar gjatë një periudhe trazirash sociale dhe kulturore, “One Flew Over the Cuckoo’s Nest” u bë një simbol i rezistencës kundërkulturore. Romani shquhet për portretizimin e individualizmit dhe kritikën e autoritetit institucional. Romani ka lënë një gjurmë të pashlyeshme në diskutimet rreth shëndetit mendor dhe trajtimit të shoqërisë ndaj të sëmurëve mendorë. Revista “Time” e përfshiu romanin në

listën e saj “100 romanet më të mira në gjuhën angleze nga 1923 deri në 2005”. Në vitin 2003 libri u rendit në sondazhin e BBC-së “The Big Read” për 200 “romanet më të dashura” në Mbretërinë e Bashkuar. Romani i parë i jashtëzakonshëm i Ken Keizi -t është një portretizimi i plotë dhe i singertë i kufijve midis mendjes së shëndoshë dhe çmendurisë.

Nisja

I nisur që në vitin 1962 me Kirk Douglas, filmit iu deshën 13 vjet për t’u zhvilluar. Xhirimet më në fund filluan në janar 1975 dhe zgjatën tre muaj, në vendndodhje në Salem, Oregon dhe zonën përreth. Producentët e xhiruan filmin në Spitalin Shtetëror të Oregonit, një spital aktual psikiatrik, i cili është edhe mjedisi i romanit. Spitali është ende në funksion, megjithëse ndërtesat origjinale në film janë prishur. Filmi u publikua më 19 nëntor 1975. Nëpër informacionet e botuara për filmin thuhet se aktoret ishin shprehur se ishte e vështirë për të krijuar ngjarjen. Mbi shtatëdhjetë të burgosur të Spitalit Shtetëror të Oregonit u bënë shtesa të përdorura gjatë gjithë filmit. Kast i jetoi në spital për të qenë në gjendje të merrte “ndjesinë” e të qenit në një institucion mendor. Si Luis Fletçer ashtu edhe Xhek Nikëllson ishin dëshmitarë të një pacienti që po kalonte trajtimin e goditjes elektrike. Shumë prej ansambllit kishin këshilltarë që rrinin pranë për t’i ndihmuar ata të përpunonin ditët e tyre “të çmendura”. Roli i Shefit që interpretohet nga Uill Sampson, - ishte i pamundur për t’u luajtur, por regjisori gjeti një rojtar parku që i përshtatej në mënyrë të përkryer përshkrimit të personazhit. “One Flew Over the Cuckoo’s Nest” u vlerësua nga kritikët dhe audienca si një nga filmat më të mirë të realizuar ndonjëherë. Është i dyti që fiton të pesë çmimet kryesore të Akademisë - Filmi më i mirë, Aktori më i Mirë, Aktorja më e

Mirë, Regjisori dhe Skenari. Për më tepër, One Flew Over the Cuckoo’s Nest u rendit në vendin e 33 në listën e përditësuar të 100 vjetëve... 100 filmave të Institutit Amerikan të Filmit në 2007.

Përmbledhja

Randëll MekMërfi, një njeri i gjallë dhe rebele, transferohet nga një burg në një spital psikiatrik për t’u vlerësuar. Ai përpigjet të shmangë punën e rëndë në burg duke pretenduar çrregullime mendore. Por spitali psikiatrik, i udhëhequr nga e ashpra dhe kontrolluesja infermiere Raçd, rezulton të jetë një mjedis shtypës dhe i dehumanizuar. MekMërfi krijon një lidhje të veçantë me pacientët, duke i frymëzuar ata të sfidojnë autoritetin dhe të rikuperojnë ndjenjën e dinjitetit dhe lirisë. Nëpërmjet aventurave dhe lojërave, ai u mëson pacientëve që të guxojnë dhe të ëndërrojnë jashtë mureve të spitalit. Filmi paraqet konfliktin mes shpirtit të lirë të MekMërfi dhe strukturave represive të institucionit psikiatrik. MekMërfi bëhet simbol i guximit dhe shpresës për pacientët, ndërsa infermierja Ratçd përfaqëson shtypjen dhe sistemin. Filmi sfidon idenë e çmendurisë, duke treguar se shpesh ajo është një formë rebelimi kundër një sistemi të pandjeshëm. Pas përpjekjeve të tij të vazhdueshme për të sfiduar Raçd, MekMërfi përfundon i nënshtruar ndaj një lobotomie, - që shkencërisht do të thotë: prerje e lidhjeve mes dhe nga korteksi prefrontal, me pjesën e brendshme të lobeve frontal të trurit. Por liria e tij shpirtërore frymëzon shefin Bromden, një pacient që ai kishte ndihmuar të rigjente forcën e tij, për t’u arratisur nga spitali duke kaluar murin, duke simbolizuar triumfin e shpirtit mbi represionin. Filmi është një histori prekëse, tragjike dhe frymëzuese, që ka fituar pesë çmimet kryesore Oscar dhe mbetet një nga filmat më të vlerësuar të të gjitha kohërave.

NUMRI I ARDHSHËM MË 15 SHKURT

HEJZA

30 Janar, 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:
Drian Shala - Shalë

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000